

ISSN 1857-6443  
9 771857 644006

## Java kulturore në Nju Jork

Shkupi rikthen  
vlerat e harruara

Fq.20



## GJYQËSORI NË MAQEDONI

Më pak gjykata,  
por më efikase

Fq.4



Rritja e  
pagave të  
mjekëve

Ekonomistët  
skeptikë

Fq.6



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3408 · E hënë, 9 korrik 2018

18°C | 23°C

15 DEN



KOHA për  
sport

Fq.12-15

### EDITORIAL

Platforma e  
pambaruar e  
shqiptarëve të  
Maqedonisë



Vetëm me shqiptarë të motivuar, Maqedonia mund të funksionojë si shtet normal, kurse të gjitha tendencat tjera që e kthejnë situatën në kohën e konflikteve e mosmarrëveshjeve, mund ta rrezikojnë të ardhmen e saj.

Fq.2

### RAJON

Kosova  
jounike rreth  
dialogut

Fq.16

### KRONIKË

Kush është  
gruaja që vdiq  
në Matkë?

Një vajzë e re ka humbur jetën ditën e djeshme, teksa është rrëzuar në kanionin e Matkës në Maqedoni. Mësohet se e reja është me origjinë nga Kosova. Ajo quhet Mirjeta Curri. E reja ishte shtatzënë dhe ka humbur jetën bashkë me foshnjën që mbante brenda vetes. Gjithash-tu, Mirjeta është nënë e një djali tjetër të vogël. Nuk ka detaje më të hollësishme në lidhje me këtë ngjarje të rëndë.

Fq.9



## NË LONDËR DISKUTOHET E ARDHMJA E BALLKANIT PERËNDIMOR NË FOKUS: SIGURIA KOLEKTIVE DHE VLERAT EUROPIANE



Duke folur gjatë vizitës së saj në Maqedonis, kryeministrja britanike Theresa May tha: "Vitin tjetër, Britania e Madhe do largohet nga Bashkimi Europian, por nuk po lëmë Europën. Ne do të vazhdojmë të punojmë me aleatët tanë për të mbrojtur sigurinë tonë kolektive dhe për të mbrojtur vlerat europiane, që aq shumë janë të nevojshme në Maqedoni dhe në pjesën më të gjerë të Ballkanit Perëndimor"

Fq.3

## Tre fëmijë nxirren nga shpella në Tajlandë

Ekipi i zhytësve ka arritur që të nxjerrë tre fëmijë nga shpella në Tajlandë, raportojnë mediat botërore.

Ekipet e shpëtimit vendosën të avancin operacinin e rrezikshëm të dielën sepse ujërat që e kishin përmblytur shpellën po shtoheshin.

Ekipet e shpëtimit hynë në shpellë në orën 10 me atë lokale (5 të mëngjesit),

ndërkohë që në hyrjen e saj kanë mbetur vetëm ekipet e zhytjes, mjekët dhe forcat e sigurisë.

Djemtë ishin duke eksploruar shpellën më 23 qershor, kur u detyruan të mbeteshin aty të bllokuar si pasojë e vërshimit të ujërave brenda saj. Tashmë, 13 zhytës të huaj dhe 5 nga Marina e Tajlandës janë përfshirë në këtë mision të vështirë.



## EDITORIAL

# PLATFORMA E PAMBARUAR E SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË



Emin AZEMI

E drejta e rajonizimit territorial dhe e decentralizimit të plotë sipas standardeve integruese të BE-së, do të duhej të jenë prioriteti i betejës politike të shqiptarëve të Maqedonisë, ndërkohë që paralelisht me këtë duhet sforcuar përpjekjet për fuqizimin e statusit shtetformues në të gjitha nivelet e pushtetit, kurse gjuha shqipe, një projekt ende i papërfunduar, duhet të jetë testi i parë i gatishmërisë për koegzistencë etnike, politike ekonomike në mes të shqiptarëve, maqedonasve e të tjerëve.

Nëse marrëveshjet me fqinjët - me bullgarët dhe grekët, Maqedonisë ia rikthyen favorët e humbura që sjell fqinjësia e mirë, dhe sidomos kompromisi i arritur me Athinën, tani do të duhej të punohet në stabilizimin e brendshëm, duke konsoliduar, edhe më tej, marrëdhëniet ndëretnike, dhe duke i dhënë zgjedhje europiane çështjeve të hapura, sidomos avancimit politik dhe ekonomik të shqiptarëve. Vetëm me shqiptarë të motivuar, Maqedonia mund të funksionojë si shtet normal, kurse të gjitha tendencat tjera që e kthejnë situatën në kohën e konflikteve e mosmarrëveshjeve, mund ta rezikojnë të ardhmen e saj. Pra, edhe referendumi që pritet të mbahet në fillim të tetorit, duhet të jetë njëherësh edhe një projekt i përbashkët i ridefinimit të statusit politik e institucional të shqiptarëve, dhe shoqëria maqedonase duhet ta ketë kuptuar tash më se cilat janë shtyllat e stabilitetit të shtetit të përbashkët.

Konstruktiviteti i dëshmuar në procesin e negociave me Greqinë, e nxjerr faktorin politik shqiptar (pushtet e opozitë) më të fuqishëm në përpjekjet për të përkthyer këtë konstruktivitet në favore të një aksioni politik me dimensione të riformatimit të gjendjes së shqiptarëve.

Në fazën kur Maqedonia ndodhet një vit para fillimit të negociatave për anëtarësim me BE, dhe në prag të referendumit, shqiptarët si faktor politik e ekonomik, duhet të ngrejë nisma që bazohen në Rezolutën "Mbi kartën për qeverisjen me shumë nivele në Europë" ("Charter for Multilevel Governance in Europa". Rezol-V-012), miratuar nga Komiteti i Rajoneve të Bashkimit Europian (KRBE) në sesionin plenar të tij më 2-3 prill 2014. Në këtë dokument, KRBE u bën thirrje autoriteteve publike të të gjitha niveleve të qeverisjes (lokale, kombëtare dhe europiane) për të përdorur dhe për të promovuar qeverisjen me shumë nivele (MAPL) në reformat e tyre të ardhshme. Qysh në nenin 1 të kësaj karte të thuhet: "Duke pasur parasysh se shumë kompetenca dhe përgjegjësi janë të përbashkëta në mes të niveleve të ndryshme të qeverisjes në Bashkimin Europian, ne shohim nevojën për të punuar së bashku e në partneritet, për të arritur kohezion më të madh ekonomik, social dhe territorial në Europë. I vetëm asnjë nuk mund të përballë me sfidat me të cilat po ndeshemi..."

Pra, qeverisja me shumë nivele është modeli më i avancuar dhe më funksional qeverisës në vendet e BE-së, ndërkohë që reformat në zhvillim, në këto vende (si Franca, Italia, Gjermania etj.), synojnë jo

heqjen dorë prej këtij modeli, por pakësimin e numrit të njërive për të rritur efciensën dhe ulur shpenzimet. Këtë model duhet ta ndjekë edhe Maqedonia, kurse shqiptarët duhet të jenë promotorët kryesorë të tij. Pra, tendenca duhet të jetë rajonizimi, jo vetëm brenda-territorial por edhe përtej-kufitar, çka nënkupton marrëveshjet ndërkufitare e ndërrajonale, duke krijuar një "multipartneritet", që bashkon kulturat, traditat, universitetet e deri tek OJF-të në platforma dhe struktura të përbashkëta ose të bashkuara. Në këtë përpjekje, thuhet në kartën e Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Europian "...ne respektojmë plotësisht legjitimitetin dhe përgjegjësinë e çdo niveli dhe parimin e bashkëpunimit të sinqertë".

Përparësia e ndarjes në rajone të Maqedonisë, ku adminstrimi do të ndiqte modele mjaft të përparuar decentralizese europiane, është në ngritjen e urave të bashkëpunimit me vende të Bashkimit Europian që kanë rregullim të ngjashëm administrativ e etnik si të Maqedonisë.

Dokumenti "Karta për qeverisjen me shumë nivele në Europë", do të duhej të jetë në vëmendjen e gjithë deputetëve dhe ministrave shqiptarë, që do të shërbente si model në ridizajnimin e qeverisjes vendore në Maqedoni, ku shqiptarët do të ngritnin kapacitetet e tyre institucionale e ekonomike dhe në bashkëpunim me subjekte të ndryshme në diasporë por edhe me komuna të ndryshme në Kosovë e Shqipëri, do të mund të krijonin një "komonvelt shqiptar", në kuadër të bashkëpunimit rajonal pa cënuar sovranitetin e shteteve.

E drejta e rajonizimit territorial dhe e decentralizimit të plotë sipas standardeve integruese të BE-së, do të duhej të jenë prioriteti i betejës politike të shqiptarëve të Maqedonisë, ndërkohë që paralelisht me këtë duhet sforcuar përpjekjet për fuqizimin e statusit shtetformues në të gjitha nivelet e pushtetit, kurse gjuha shqipe, një projekt ende i papërfunduar, duhet të jetë testi i parë i gatishmërisë për koegzistencë etnike, politike ekonomike në mes të shqiptarëve, maqedonasve e të tjerëve.

Të bashkëqeverisës, nuk është asgjë tjetër pos shkëmbim projektesh që të bëjnë atë (bashkëqeverisjen) servis sa më funksional për qytetarët. Zaevi dhe Ahmeti duhet ta bëjnë këtë, sepse nuk besojmë se marrëveshjet e brendshme janë më të vështira se ato të jashtmet, kurse referendumi i vështitës është pikërisht momenti i ridizajnit të qëndrimeve për një shtet që nuk do të jetë servis vetëm i një etnie.

## Beteja per Teatrin

"Sot më pak se kurre kemi nevojë për dhunë, incidente e shfaqje barbarie. Kemi nisur një proteste qytetare, padyshim politike, por jo partiake. Anëtarët e të gjitha partive janë të mirepritur te na bashkohen, por askush nuk ka të drejte te na shmange nga fokusi levizjen: Beteja për Teatrin dhe Ligjin çshte beteje per Demokracine!

Sot do të jemi para Kuvendit per t'i thene atyre qe kane ndermend te shkelin sot Kushtetuten se ata nuk jane deputetet tane, se nje Kuvend qe shkel hapur Kushtetuten nuk eshte me Kuvendi yne. Nese kjo ndodh sot, deputetet e opozites nuk kane ç'i duan me mandatet.

Le te vijne të gjithë ne Teatrin Kombetar e le ta bejme aty Kuvendin e vertete!

Jo gurë, jo grushta, jo zjarr! As ndaj policise, as ndaj provokatoreve!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, regjisori, Kastriot Çipi



## Montuesit e "Monstrës"

"Rasti Monstra është shumë më i thellë dhe me i ndërlikuar se sa paraqitet në mediat e paguara nga të involvuarit në këtë rast. Prokuroria Speciale është duke punuar nga themeli për ta sqaruar këtë rast. Fajtor më i madh është ish prokurori Marko Zverlevski që gjithë rastin e drejtoi në kahje tjetër. Gjithashtu dhe gjykatësi Vladimir Tufekxhiç i cili shumë mirë i nje vrasësit e vërtetë. Lereni Zoran Zaevin, krejt çfarë kishte për rastin Monstra i dorëzoi në Prokurorinë Speciale, duhet pasur vëmendje në rolin që kanë luajtur Trajko Veljanovski dhe ish she i allfave Ivica Ançevski-Puki. Këto dy janë çelsi i këtij rasti", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari kontrovers, Zoran Bozhinovski.



## Humor i akademikut popullor Hafuz Onuzi.

"Hafuzi, prej fshatit Nange, edhe pse me dy klasë shkollë ka refleksë të çuditshme ndaj komunitetit, sidomos ne Kukes se ketu e zhvillon aktivitetin e vet. I qetë, i edukueshëm, ai shfaqet befasues me humorin e vet të natyrshëm sa, duket se po futet në rreshtin e humoristave ma të dallueshëm në Kukës. Di permendesh me qindra numra telefoni dhe targa makinash...

1. Hafuzi shkon me ble byrekë; ai si shiste, i jep një byrek të ngrohtë e një t'ftohtë. Hafuzi ia kthen byrekun e ftohtë dhe i thotë: - Merre mbrapsht ket t'ftohtin se ma ke dhanë për Hafuz.
2. Nji përgjegjës firme i thotë Hafuzit: - A po vjen në punë roje nate? - Jo, - I thotë Hafuzi, - un tutem ditën e ti do me m'futë roje nate!
3. Njani i thotë Hafuzit: - O Hafuz, merre filanin në telefon e thuej se po t'kërkon filani se asht n'darsëm e mue po m'vjen randë. - S'mund e marr, - i thotë Hafuzi, - se edhe darsma ka protokoll, anipse jam fort shok me filanin.
4. I thotë njani Hafuzit: - Ty edhe me t'martue nuk ndryshon. - Veç m'martojni, - i thotë Hafuzi, - e kqyrni qysh po ndryshoj!
5. I thonë Hafuzit: - O Hafuz, pse bje në Kukës për ditë? - Nji ditë mos me ra n'Kukës, - thotë Hafuzi, - bahem budall krejt", ka përshkruar aktualitetin e sotëm në një status në Facebook, shkrimtari Petrit Palushi



Duke folur gjatë vizitës së saj në Maqedonis, kryeministrja britanike Theresa May tha: "Vitin tjetër, Britania e Madhe do largohet nga Bashkimi Europian, por nuk po lëmë Europën. Ne do të vazhdojmë të punojmë me aleatët tanë për të mbrojtur sigurinë tonë kolektive dhe për të mbrojtur vlerat europiane, që aq shumë janë të nevojshme në Maqedoni dhe në pjesën më të gjerë të Ballkanit Perëndimor"

# NË LONDËR DISKUTOHET E ARDHMJA E BALLKANIT PERËNDIMOR NË FOKUS: SIGURIA KOLEKTIVE DHE VLERAT EUROPIANE



Londër, 8 korrik - Disa deputetët britanikë, pjesë e Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Ulët të parlamentit anglez, i kërkojnë kryeministres May të marrë në dorë integrimin e Ballkanit Perëndimor, për të ndaluar influencën ruse.

Në Samitin e Londrës, i cili do të mbahet në kuadër të procesit të Berlinit më 9 dhe 10 korrik, në "Chatham House", të organizuar nga Instituti Mbretëror Britanik për Çështje Ndërkombëtare, pritet të diskutohen tema të rëndësishme për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor. Tema qendrore i këtij Samiti do të jetë, "Përtej Berlinit: Çfarë do të sjellë dekada e ardhshme për Ballkanin Perëndimor?"

Në këtë rast, folësit do të jenë zyrtarë të nivelit të lartë të BE-së, si dhe ekspertë nga Europa dhe rajoni, ndërsa tema kryesore do të jetë e ardhmja e Procesit të Berlinit dhe ndikimi i aktorëve jashtë BE-së, Rusia, Turqia, SHBA, në rajonin e Ballkanit. Deputetët britanikë kërkojnë, që kryeministrja e tyre, Theresa May të mbajë një qëndrim pozitiv, kundrejt këtyre vendeve. Por afrimi i Ballkanit Perëndimor, kërkon edhe një luftë të madhe kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, raportojnë mediat britanike.

Theresa May duhet të luajë ro-

lin udhëheqës në pranimin në Bashkimin Europian të vendeve të Ballkanit pas Brexit, paralajmërojnë deputetët. Theresa May është nxitur të luajë një rol udhëheqës në ofertën e pranimit në Bashkimin Europian, të të ashtuquajturve, gjatë vende të Ballkanit Perëndimor, përpara një samiti kyç në Londër javën e ardhshme.

Komiteti i Punëve të Jashtme (FAC) i bëri thirrje Kryeministres të ndihmojë vendet e Ballkanit në kërkesat e tyre për anëtarësimin në BE dhe i kërkoi qeverisë të zhvillojë një plan veprimi "të besueshëm dhe të pavarur", 10-vjeçar për marrëdhëniet e tij me kombet ballkanike, në kohën e presionit të vazhdueshëm nga Rusia. Deputeti konservator Tom Tugendhat, kryetar i FAC, e komentoi këtë çështje, duke deklaruar: "Ballkani Perëndimor ka bërë një rrugë të gjatë që nga vitet 1990, kur rajoni u përfshi nga dhuna".

Por Ballkani Perëndimor, duhet të bëjë më shumë nëse ata duhet të kualifikohen për anëtarësim në Bashkimin Europian. "Kundërshtarët nga disa vende anëtarë botës do të dëmtojnë interesat e tyre dhe ato të shteteve fqinje të Bashkimit Europian. Mbretëria e Bashkuar ka një rol në mbështetjen e tyre edhe pas

largimit nga BE-ja", -tha ai. Udhëheqësit e Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë Veriore, Bosnjes dhe Hercegovinës, Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi, do të takohen me politikanët britanikë, duke përfshirë Theresa May dhe Angela Merkel, në Londër javën e ardhshme, për të diskutuar çështjet kryesore, përfshirë edhe pranimin në Bashkimin Europian.

Komiteti gjithashtu paralajmëroi se pranimi i gjatë vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian, mund të jetë "i gjatë dhe i avashtë për shkak të hezitimit të BE-së për të pranuar anëtarë të rinj". Ai kërkoi gjithashtu që Mbretëria e Bashkuar të krijojë një "grup të fuqishëm angazhimesh që mund të bëjnë një ndryshim real" në rajon në samitin e pestë vjetor të ardhshëm të Ballkanit Perëndimor, i cili do të fillojë të hënën. Zonja May tha se samiti do të trajtojë çështjet që përfshijnë stabilitetin ekonomik, krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe do të krijojë bashkëpunim politik mbi mosmarrëveshjet në vazhdim, në këtë rajon.

Duke folur gjatë vizitës së saj në Republikën e Maqedonisë Veriore, ajo tha: "Vitin tjetër, Britania e Madhe do largohet nga Bashkimi

Europian, por nuk po lëmë Europën. Ne do të vazhdojmë të punojmë me aleatët tanë për të mbrojtur sigurinë tonë kolektive dhe për të mbrojtur vlerat europiane, që aq shumë janë të nevojshme në Maqedoni dhe në pjesën më të gjerë të Ballkanit Perëndimor"-përfundoi deputeti konservator, Tom Tugendhat.

Në panelin e parë të dedikuar për të ardhmen e procesit të Berlinit, fjalimet hyrëse do të mbahen nga Johannes Hahn, Komisioneri Europian për Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë dhe Nikola Dimitrov, Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Panelistët do të shkëmbejnë mendime se si procesi i Berlinit ka përparuar që nga Samiti i parë deri më sot dhe ku ata shohin të ardhmen e kësaj iniciative, cilat janë arritjet konkrete dhe nëse ka ndonjë dështim të procesit. Ata gjithashtu do të diskutojnë se si BE-ja mund të përmirësojë komunikimin me qytetarët dhe elitat politike të Ballkanit Perëndimor, raportojnë mediat britanike.

Diskutimi do të ndiqet nga Christian Danielsson, Drejtori i Përgjithshëm i Komisionit Europian për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Zoran Nechev, Shefi i Qendrës për Integrimin në BE. Paneli do të moderohet nga profesori Richard Wittman i "Chatham House". Në panelin e dytë, të dedikuar për ndikimin e aktorëve të tretë në Ballkanin Perëndimor, fjalimet hyrëse do të jepen nga Catherine Ashton, këshilltari e lartë e "Chatham House" dhe ish-Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Europian për Punë të Jashtme dhe Sigurinë, e cila gjithashtu ka vepruar si ndërmjetës në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës.



## Ndryshojnë rregullat për lëvizjen në Schengen

Parlamenti Evropian ka miratuar një plan për të verifikuar udhëtarët, të cilëve nuk iu duhet viza për të hyrë në zonën Schengen.

Sipas planit të miratuar nga ligjvënësit evropianë më 5 korrik, udhëtarët nga 60 vende që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian, duke përfshirë Gjeorgjinë, Moldavinë, Ukrainën dhe shumicën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, do të jenë pjesë e një procesi verifikues para se të arrijnë në kufirin e Schengenit, duke përdorur Sistemin informativ dhe Autorizues të Udhëtimit në Evropë.

Sipas këtij plani synohet të 'identifikohen kriminelët, terroristët dhe kushdo që përbën rrezik para se të arrijnë në BE', thuhet në deklaratë.

Propozimi duhet të miratohet edhe zyrtarisht nga shtetet anëtare të BE-së, në mënyrë që ky sistem të zbatohet nga viti 2021, ka njoftuar BE-ja. Plotësimi i një aplikacioni pritet të zgjasë afër 20 minuta dhe do të kushtojë shtatë euro, ndërsa i njëjti do të jetë falas për fëmijët nën moshën 18 vjeçare.

Biloku ka thënë se sistemi evropian është i ngjashëm me Sistemin Elektronik të Shteteve të Bashkuara për Autorizim të Udhëtimit.

## Ministri Bekteshi premtoi Zonë të Lirë Ekonomike në Likovë

Likovë, 8 korrik - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ai i Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor Sadulla Duraku dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës Arbër Ademi, të shoqëruar nga sekretarë shtetëror, deputetët e zonës dhe funksionarë tjerë sot kanë zhvilluar një vizitë pune në Komunën e Likovës. Delegacioni i Qeverisë ka realizuar takim me kreun e komunës së Likovës Erkan Arifi me të cilën kanë biseduar për projektet që realizohen dhe do të realizohen në bashkëpunim me pushtetin qendror.

Ministri Bekteshi gjatë vizitës në Likovë deklaroi se së shpejti do të hapet Zona e Lirë Ekonomike, duke shtuar se investitorët do të mund të investojnë kapitalin e tyre.

"E shfrytëzoj rastin që kryetarin e Komunës e njoftova rreth hapjes së zonës ekonomike në Likovë dhe nëpërmjet medimeve dua të njoftoj qytetarët e kësaj komune dhe gjithë rrethit se ne si Ministri e Ekonomisë në bashkëpunim me kadastrën me drejtorin e zonave të lira ekonomike jemi duke punuar fuqishëm që së shpejti duhet të vizitohet komunën e Likovës ku do të fillojnë punimet për hapjen e zonës së lirë ekonomike", theksoi Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi. Ai me këtë rast njoftoi se të gjitha komunat të vizitohen dhe do të jepen sugjerime deri te qeveritarët shqiptarë për hallet dhe dertet në atë vendbanim, transmeton gazeta KOHA.

Publicitet

## KONKURS

Gazeta KOHA shpallë konkurs për:

- dy redaktorë (me përvojë pune)
- katër gazetarë (me përvojë pune)

**Kushtet:** Kandidatët të kenë të mbaruar arsimin sipëror, si dhe përvojë në redaktim dhe në raportim nga terreni. Përparësi do të kenë kandidatët, të cilët, përpos gjuhës shqipe, zotërojnë edhe ndonjë gjuhë tjetër.

Të interesuarit duhet që CV-të e tyre t'i dërgojnë në e-mail adresën: [marketing@koha.com.mk](mailto:marketing@koha.com.mk).

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjat deri të mërkurën (11 Korrik).

REFORMIMIT TË SISTEMI GJYQËSOR NË MAQEDONI

# MË PAK GJYKATA, POR MË EFIKASE

Miratimi i ndryshimeve të fundit të Ligjit për gjykata, si një hap drejt reformimit të sistemit gjyqësor nuk është realizuar në formën e duhur. Për të pasur një sistem organizativ më funksional dhe më produktiv në gjykata e Maqedonisë, gjithsesi duhet zvogëlimi i numrit të gjykatave ekzistuese



stemi gjyqësor doemos është ndryshimi i nenit 28 të Ligjit për gjykata, i cili me plotësimin e fundit nuk iu nënshtrua ndryshimeve. Për momentin në gjykata tona ekziston një pabarazi e madhe sa i përket numrin të lëndëve që duhet proceduar. Duke e pasur parasysh se territori i Maqedonisë relativisht është i vogël, nuk rrezikohet e drejta e qytetarëve për qasje të drejtpërdrejtë deri te drejtësia. Ekzistimi i një numri të madh të gjykatave në vetë ngërthen implikimi negative financiare ndaj buxhetit të gjyqësorit. Kështu që numri më i vogël i gjykatave nënkupton edhe përcjellje më e thjeshtë dhe harmonizim të praktikës gjyqësore", thotë, gjykatësja Dimovska.


Qëndrimin e shumë ekspertëve se sistemi gjyqësor në vend duhet të ketë gjykata të posaçme tregtare e ndan edhe gjykatësja Antoaneta Dimovska. Ajo vlerëson se zgjidhja e shpejtë e kontesteve treg-

tare dhe barazimit të praktikës gjyqësore në këtë sferë mundet të arrihet vetëm përmes formimit të gjykatave tregtare. Ndonëse në Gjykatën Civile të Shkupit, ku edhe punon gjykatësja Dimovska, dhe gjykatat tjera ekzistojnë sektor për çështje tregtare, megjithatë ajo është e mendimit se duhet të bëhet analizë e vendimeve që i miratojnë këto gjykates dhe gjykatësit tjerë që procedojnë lëndë të llojeve të ndryshme. Analiza e saj e publikuar nga Instituti për politike evropiane dhe disa shoqata tjera jo qeveritare që nga afër e monitorojnë procesin e reformave në drejtësi, përmban vërejtje dhe rekomandime për ndryshimin e një varg nenes të Ligjit për gjykata.

"Neni 42 i Ligji për gjykatë është problematike nga disa aspekte. Mbase reformat në sistemi gjyqësor të ne më shpesh bëhen për shkak të mënyrës së zgjedhjes dhe emërimit të gjykatave dhe mungesës së

respektit të çfarëdo lloj kriterëve përmes të cilëve do të zgjidheshin kandidatët më të mirë, vlerësoj se gjatë ndryshimit të ligji në fjalë duhet ti kushtohet rëndësi rregullimit të neneve që e sqarojnë procedurën e avancimit të gjykatësve në gjykata më të larta. Në këtë drejtim duhet të bëhet analizë e detajuar e mënyrës se si gjykatësit në vend janë avancuar gjatë 10 viteve të fundit, të shqyrtohet kualiteti i tyre në të gjitha instancat. Po ashtu duhet detajisht të kontrollohet kualiteti i gjykatësve në gjykata themelore dhe në këtë mënyrë do të gjendet formula e duhur e zgjedhjes së gjykatësve nga gjykata themelore tek ato të Apelit dhe deri te Gjykata Supreme e Maqedonisë", shprehet gjykatësja, Dimovska.

Paknaqësinë e tyre për plotësimin e Ligjit për gjykata, kohë më parë e shprehi edhe Shoqata e gjykatësve të Maqedonisë. Këshilli drejtues i kësaj shoqate, duke e përshëndetur përkushtimin e Qeverisë për reformat e nisura në gjyqësor, tha se ndryshimet e miratuar në Kuvend për Ligjin për gjykata, nuk janë në korrelacion me strategjinë për reforma të cilën e miratoi vetë kjo Qeveri. Nga atje i bënë thirrje deputetëve që në plan të parë gjatë miratimit të këtyre ndryshimeve ti kenë parasysh interesat e gjykatësve, respektivisht krijimit të vendimeve stabile përmes të cilëve do të garantohet pavarësia gjyqësore e cila është bazë për sigurimin e drejtësisë efektive dhe kualitative.



## Zaev: Kemi perspektiva bashkëpunimi ekonomik me Kinën

I kemi hapur perspektivat për përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik me Republikën Popullore të Kinës dhe duam të bashkëpunojmë në projekte të cilat na sjellin zhvillim në infrastrukturë dhe ekonomi të vendit. Këtë e tha të dielen kryeministri Zoran Zaev në takim me kryetarin e Qeverisë së RP Kinës, Li Keqiang në kuadër të Samitit të 7-të të shefave të qeverisë nga procesi i bashkëpunimit të RP Kinës me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (16+1), çka u mbajtë dje në Sofje.

Shefi i Qeverisë së Maqedonisë vlerësoi ndihmën e rëndësishme që jep qeveria kineze në heshtimin e ndërimit të rrugëve magjistrale Kërçovë-Ohër dhe Milladinovc-Shtip. Kryeministri i RP të Kinës tha se, Kina edhe më tej do të vazhdojë që të mbështes Maqedoninë dhe tha se rritja e bashkëpunimit është shumë e rëndësishme, sepse vendet janë të orientuar drejt zhvillimit ekonomik çka duhet të sjell përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve.

Koha Omer XHAFFERI

Shkupi, 8 korrik—Me ndryshimet e Ligjit për gjykata (prill 2018), nuk u arrit qëllimi i vërtet i reformimit të sistemit gjyqësor në Maqedoni, i cili do t'ju krijojë qytetarëve mundësi që të kenë gjykime të drejta dhe transparente para gjykatave të pavarura. Gjykatësja, Antoaneta Dimovska, duke i vlerësuar ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykatë, në një analizë juridike, thotë se reformat qenësore në gjyqësor tek duhet të fillojnë.

Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave, siç thekson gjykatësja Dimovska, në masë të madhe varen nga integriteti i gjykatësve, megjithatë mënyrë e organizimit të sistemit gjyqësor dhe mënyrë e funksionimit të tij paraqesin faktor të rëndësishëm në rrugën reformimit të gjyqësorit.

"Për të funksionuar siç duhet si-

Nuk mjafton vetëm të mbarosh një shkollë, që të mund të sigurosh vendin e punës. Më tepër sesa për diploma tregu i punës ka nevojë për kuadro të aftë, që me shkathtësi dhe kompetenca ti kryejnë punët që i kërkohen nga kompania dhe sipërmarrësit

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 8 korrik—Rritja e kërkesave të tregut të punës për kuadro të profileve që nxjerrin shkollat teknike dhe elektroteknike, ka bërë që shkollat e mesme të teknikës të zgjojnë interesimi më të madh të nxënësve. E paralelisht kësaj, po punohet dhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin të kushteve të mësimin dhe pajisjes me laboratorë dhe mjetet adekuate. Të para nga ky këndvështrim,

## SHKOLLAT DHE TREGU I PUNËS

# VETËM DIPLOMA, PA SHKATHTËSI NUK VLEN

duket se përtej atraktivës shkollimi profesional teknik dhe elektroteknik do të shndërrohet në të shkollimi me vlerë të së ardhmes. Nga shkolla e Mesme Elektroteknike "Vllado Tesevki" në Shkup, vërejnë se në krijimin e politikave arsimore duhet ti kushtohet vëmendje më e madhe aftësimin të kuadrove me shkathtësi dhe kompetenca profesionale.

Programet mësimore, sipas Biljana Gligorovës, drejtoreshës së "Vllado Tesevski, janë shumë të mira. Madje, kjo thotë se është përshtypja edhe e ekspertëve nga shtete tjera të rajonit. Mirëpo, problemi, sipas saj është realizimi i atyre programeve në kontekstin e aftësimin të kuadrove me shkathtësi të duhura. "Shkollat teknike dhe elektroteknike janë përafërsisht të njëjta në të gjitha shtetet e rajonit. Kanë programe shumë të mira, kushtet gjithashtu

të mira. Mirëpo, në të gjitha këto shtete duhet të përmirësohet komponenti e pajisjes së kuadrove me shkathtësi profesionale. Kjo është pika e dobët në të cilën ngësim të gjithë", shprehet drejtoresha. Është shumë e rëndësishme që kjo komponentë të forcohet sa më parë. Sepse, nëse shkollat e mesme të teknikës dhe elektroteknikës vazhdojnë të nxjerrin kuadro që nuk mund ti kryejnë shërbimet të cilat i duhen tregut të punës, pra të mos kenë kompetencën profesionale (me të cilën duhet të pajisen, çdo herë duke u bazuar në programet përkatëse mësimore) nuk është çudi të zbehet edhe interesimi i nxënës për këtë lloj shkollimi. Për momentin interesimi i nxënësve është i kënaqshëm. Nëse deri para pesë viteve, në shkollat e teknikës dhe elektroteknikës, mesazhi arrihet të formoheshin paralele edhe atë

me nga 13 nxënës në klasë, tani si rezultat i interesimit të shtuar formohen paralelet me 30 e më shumë nxënës në klasë. Kushtet për realizimin e këtij lloj shkollimi profesional, i cili është tepër i kushtueshëm, sipas Gligorovës janë gjithashtu të mira. "Sigurisht se nuk mund të ecim në të njëjtin hap me zhvillimet teknologjike që ndodhin në botë, por mendohe mi që të përmirësojmë çdo herë e më shumë kushte e mësimin duke sofistikuar mjete e punës", sqaron ajo, ndërsa thotë se për këtë qëllim shfrytëzohen edhe fondet e projekteve të ndryshme që ndan Bashkimi Evropian, si dhe përmes pjesëmarrjes së shkollave nga më tepër shtete nëpër projekte të përbashkëta.

Sfida e radhës për këta shkolla do të jetë edhe zbatimi i programeve të dyfishta mësimore, të cilat do të kenë shumë pika takimi mes

shkollimit dhe praktikës. Vetëm diploma, pa shkathtësi profesionale, nuk vlen. Madje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MAMSH) paralajmërojnë se në krijimi i politikave arsimore, në kuadër të reformave arsimore do të fokusohen pikërisht në këtë drejtim. Ky përcaktim, sikurse është dakorduar javën që shkoi në Konferencën Rajonale të Berlinit, ku është caktuar të jetë një prej prioritetëve të radhës në sistemet arsimore në shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ministrat e të gjitha këtyre shteteve e diskutuan pikërisht çështjen e programeve të dyfishta në arsimin profesional, në të cilin do të inkuadrohen drejtpërdrejtë edhe kompanitë dhe sipërmarrësit vendor. Për këtë është shumë e rëndësishme që shkollat të nxjerrin kuadro të aftë për t'ju përgjigjur nevojave të tregut të punës.

**Festivali "Këngë Jeho" vazhdon të jetë një aktivitet i vetëorganizuar dhe vetëfinancuar nga dashamirë të kulturës. Ky festival është themeluar në vitin 1991 dhe vazhdon të ngelë jashtë ombrellës institucionale, edhe pas shumë premtimeve në vitet e kaluara**

# NË STRUGË U MBAJT FESTIVALI "KËNGË JEHO"



Shkup, SHKA "Bajram Shabani", Kumanovë dhe si përfundim do të performojnë AKV "Emin Duraku" nga Shkupi. Festivali "Këngë Jeho" vazhdon të jetë një aktivitet i vetëorganizuar dhe vetëfinancuar nga dashamirë të kulturës. Ky festival është themeluar në vitin 1991 vazhdon të ngelet jashtë ombrellës institucionale, edhe pas shumë premtimeve në vitet e kaluara. Pas hapjes ceremoniale të festivalit, në skenë u ngjit SHKA "Migjeni", e më pas, SHKA "Shpresa" Veleshtë, SHKA "Sazet e Frengoves" Frëngovë, SHKA "Shqiponja" Saraj, Shkup, SHKA "Xheladin Zeqiri" Tetovë, dhe AKV "Kemajl Azizi" Viti, Kosovë.

Në natën e dytë (07.07.2018) performoi SHKA "Rrezet e Strugës" Strugë, ansambli "Folk Alb" Tiranë, SHKA "Jahi Hasani" Cegan, Gostivar; Qendra Kulturore "Kacaniku" Kacanik, dhe ansambli "Dance Plus" Elbasan.

Kurse nata e fundit, të dielën, u përmyll me AKV "Ibe Palikuqi" Shkup, Ansambli "Skenderbeu" Korçë, SHKA "Drita e Dervenit" Shkup, SHKA "Bajram Shabani", Kumanovë dhe AKV "Emin Duraku" nga Shkupi.

kulturore botërore. Dhe tani, pa humbur shumë kohë, u uroj të gjithë pjesëmarrësve qëndrim mbresëlënës në Strugën mahnitëse, ndërthurur me këngë dhe valle të bukura, me besim dhe shpresë se në zemër do e ruajnë kujtimin për bukurinë e pafund të Strugës dhe Drinit të Zi, ndërsa mysafirëve dhe qytetarëve të Strugës u dëshiroj dëgjim dhe ndjekje të këndshme të të tre netëve të festivalit dhe me këtë rast - e shpall të hapur Festivalin tradicional të 27-të të këngëve të përpunuara dhe stilizuara me dëshirë që të jetojë dhe përjetojë edhe shumë kretime, tha Xha-

feri. Në natën e parë performuan SHKA "Migjeni", e më pas, SHKA "Shpresa" Veleshtë, SHKA "Sazet e Frengoves" Frëngovë, SHKA "Shqiponja" Sarajit të Shkupit, SHKA "Xheladin Zeqiri" Tetovë, dhe AKV "Kemajl Azizi" nga Vitia e Kosovës. Sonte në natën e dytë (07.07.2018) performojnë SHKA "Rrezet e Strugës" Strugë, ansambli "Folk Alb" Tiranë, SHKA "Jahi Hasani" Cegan, Gostivar; Qendra Kulturore "Kacaniku" Kacanik, dhe ansambli "Dance Plus" Elbasan. Nata e fundit është përmyllur me performancat e AKV "Ibe Palikuqi" Shkup, Ansambli "Skenderbeu" Shkup, Ansambli "Skenderbeu" Korçë, SHKA "Drita e Dervenit"

Në Strugë të premtën në mbrëmje filloi festivali tradicional i këngëve dhe valleve popullore "Këngë Jeho". Në këtë festival edhe sivjet do të ketë laramani kulturash dhe vallesh tradicionale të trojeve shqiptare, edhe atë do të marrin pjesë rreth pesëmbëdhjetë ansamble dhe shoqata kulturo-artistike nga Elbasani, Korça, Kaçaniku, Tetova e të tjera.

Hapja e festivalit u bë nga kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi dhe ministri i Kulturës, Asaf Ademi.

"Këtë vit, jam krenar edhe për faktin se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, është mbështetës i këtij evenimenti kulturor i cili është vlerë e shtuar në ofertën kulturore verore të këtij qyteti i cili frymon dhe jeton me këngët, folklorin dhe vallet që janë kategori civilizuese universale, respektivisht janë pjesë e trashëgimisë

## VOZITJA E SHPEJTË, FATALE PËR VOZITËSIT

# RRUGËT E POLLOGUT, ARENË E AKSIDENTEVE

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 8 korrik - Në pjesën e parë të këtij si shkak më i shpeshtë i aksidenteve në trafik të ndodhura në rajonin e Tetovës është vozitja e shpejtë, gjegjësisht mospërshtatje e shpejtë sipas kushteve në rrugë. Kështu thonë nga policia e Tetovës e cila në një raport të detajuar tregon për papërgjegjshmëri nga ana e drejtuesve të automjeteve. "Gati se një e treta nga numri i përgjithshëm i 379 aksidenteve, gjegjësisht 113 aksidente kanë ndodhur si rezultat i mospërshtatjes së shpejtësisë, 74 aksidente për shkak të kryerjes së veprimeve të paregullta në rrugë, përderisa 28 aksident janë shkakuar nga kafshët në të shumtën e rasteve qentë ende, më së shumti në autostradën Costivar-Tetovë Shkup. Gjithashtu vendet ku më së shpeshti ndodhin aksidentet janë rrugët nëpër vendbanime edhe atë 263 aksidente", thotë zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë Fatmir Rexhepi. Sipas raportit gjashtëmuor të policisë së Tetovës në periudhën për të cilën bëhet fjalë janë regjistruar 60 dalje nga rruga, në 51 aksidente pjesmarrës kanë qenë edhe vetu-



ra të parkuara, në 16 aksidente motoçikletat, në 10 aksidente biçikletat si dhe në 38 aksidente këmbësorët. Më të shpeshta edhe gjatë këtij viti janë aksidentet nëpër rrugët e Tetovës dhe atë 191 aksidente, ku në rend të parë janë bulevardet e "Ilindenit", "Vidoje Smilevski Bato", "Blagoja Toska" rruga 29 nëntori ndërsa ende e rrezikshme është rruga rajonale Tetovë-Pirok me 77 aksidente. Në ndërkohë qershori i këtij viti është regjistruar pa viktima në krahasim me qershorin e vitit të kaluar. "Në muajin qershor të këtij viti, në rajonin më të gjërë të Tetovës, gjithsej janë të regjistruara 59 aksidente trafiku, ku në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar ka pasur 2 aksidente më pak. Nga aksidentet e ndodhura gjatë qershorit të këtij viti, pjesa më e madhe janë nëpër vendbanime edhe atë 46 aksidente dhe 13

aksidente në rrugë të hapura. Në këto aksidente nuk ka pasur asnjë viktim, në krahasim me vitin e kaluar ku në një aksident ka patur të regjistruar një viktimë. Dy aksidentet kanë përfunduar me dy persona me lëndime të rënda trupora, 31 aksidente me 65 persona të lënduar lehtë derisa në 26 aksidente janë shkakuar vetëm dëme materiale, të cilat llogaritet rreth 3 milion denarë", tha zëdhënësi Rexhepi. Ndërkohë gjatë gjashtë muajve të kaluar të këtij viti, në rajonin më të gjërë të Tetovës, janë zbuluar 8773 kundërvajtje në trafik. Për shkak të kundërvajtjeve të konstatuara, nga pjestarët e policisë, nga Sektorit për Punë të Brendshme Tetovë, në këtë periudhë nga trafiku janë larguar, 463 vetura si dhe 1182 vozitës. Numri më i madh i veturave të larguara nga trafiku edhe atë 379 vetura kanë qenë pa regjistrim ose

për skadim të regjistrimit, kurse 82 vetura kanë pasur lloje të ndryshme të paregullsisë teknike. Në mes të vozitësve të larguar nga trafiku përsëri më të shumtë në numër janë vozitësit që kanë drejtuar veturat pa leje për vozitje edhe atë 597 vozitës 462 vozitës fillestarë ndërsa gjatë kësaj periudhe 72 vozitës kanë drejtuar automjetet në gjendje të alkoolizuar. Këto dhe kundërvajtje tjera, në gjysëmvetorin e parë të këtij viti rumbullaksohen me 4584 fletëpagesa të detyrueshme për kundërvajtje dhe 2688 fletëpagesa për kundërvajtje, 1096 vozitës kanë regjistruar pika negative, kurse 179 nga kundërvajtësit për kohësisht u është marrë leja për vozitje, ndërsa 37 vozitësve u është marrë për kohësisht edhe vetura. Përndryshe, në këto gjashtë muaj si kundërvajtje mw e shpeshtw sërisht paraqitet shpejtësia e papërshtatshme sipas kushteve në rrugë, gjegjësisht vozitje më e shpejtë nga shpejtësia maksimale e lejuar, që wshtw edhe shkakare numwr njw e aksidenteve në trafik të cilat dukshëm janë në ritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pohojnw nga policia e Tetovës.

## KRONIKË

### "Blagoja Toska", shpronësimi afër epilogut

Tetovë, 8 korrik - Rreth dy javë më parë me rrënimin e dy objekteve në afërsi të spitalit të Tetovës të cilat paraprakisht ishin shpronësuar filluan punimet në drejtim të hapjes së bulevardit "Blagoja Toska". Nga ndërmarrja për menaxhimin me tokë ndërtimore dhe rrugë theksuan se punët në drejtim të hapjes së këtij bulevardi që është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Tetovës do të vazhdojë në javët në vijim dhe se qëllimi kryesor është të arrihet deri te shkolla e mesme tekstile, në anën tjetër të lumit Shkumbin. Në bazë të planit për hapjen e bulevardit "Blagoja Toska" deri te spitali klinik është hapur rruga dhe janë kompensuar banorët që kishin shtëpi dhe e bllokun hapjen e këtij bulevardi ndërsa deri në fund të këtij viti synohet që të arrihet marrëveshje edhe me banorët tjerë që përfundimisht të mbyllën çështjet pronësore-juridike dhe të vazhdohet me fazat tjera. Kryetarja e komunës së Tetovës Teuta Arifi një javë më parë gjatë inspeksionit të punimeve për hapjen e rrugës në bllokun katër të Lagjes Drenovec në lidhje me shpronësimin e pronave në Bulevardin "Blagoja Toska" deklaroi se 80% e trasës deri tek shkolla tekstile tanimë është përfunduar. Përndryshe për hapjen e këtij bulevardi për vitin 2018 janë ndarë rreth 180 mijë euro mjete buxhetore, dhe hapja e të njëjtit dukshëm do të ndikonte në lehtësimin e komunikacionit të stërngarkuar në pjesën qendrore të qytetit. Ky bulevard ishte premtim edhe i kryetarëve të mëparshëm të komunës së Tetovës por edhe kryetares aktuale Teuta Arifit si në mandatin e saj të parë poashtu edhe në marrjen e mandatit të dytë.

### Defekti në ujësjellës, shumë amvisëri pa ujë

Tetovë, 8 korrik - Një defekt në gypin kryesor të ujësjellësit të Tetovës ka lënë pa ujë një pjesë të madhe të qytetit të Tetovës, gjegjësisht banorët që kanë jetojnë në rrugën Cvetan Dimov, përndryshe në pjesën ku ndodhet edhe Stacioni Policor në Tetovë. Nga NPK-ja e Tetovës kanë konfirmuar se në këtë lagje ka patur një defekt në gypin kryesor. Me këtë rast uji është ndëprerë dhe mbrëmë kanë filluar punët për sanimin e defektit. Sipas informacioneve të njësisë së ujësjellësit nga 29 qershori në rrjetin e ujësjellësit ka 500 litra ujë në sekondë dhe kjo është e mjaftueshme por defektet janë ata që shkaktojnë problem më të mëdha. Nga kjo ndërmarrje nuk presin që të ketë probleme me furnizimin me ujë të pijshëm gjatë muajve të ardhshëm. Nga Ndërmarrja Publike Komunale Tetova-Tetovë kanë apeluar që uji përdo-ret në mënyrë racionale në periudhën e verës me qëllim që të mos ketë probleme.

Stimulimi përmes mjeteve financiare nuk është i vetmi motiv, por punëtorët si mjekët edhe të tjerët kërkojnë edhe kushte të tjera si dinjiteti i tyre, perspektiva, promovimi i tyre dhe shumë faktorë të tjerë, që ndikojnë te ata që të mbeten në vendin e tyre

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 8 korrik - Në programin e punës së qeverisë, parashihen që pagat themelore të të gjithë punëtorëve shëndetësor të dyfishohen deri në vitin 2020. Kjo rritje do të përfshijë specialistët në shëndetësinë terciare, për të cilët parashihet rritje graduale e pagës, duke startuar nga 100.000 denarë minimumi, përkatësisht 1.600 euro. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, ka paralajmëruar se Institucionet shëndetësore publike duhet t'u rritet imazhi patjetër dhe për t'u shpërblyer stafi shëndetësor duhet të marrin shumë plotësuese të parave.

Përpos mjekëve specialistë, edhe për mjekët që punojnë në ndërrimin e natës tash më është rritur paga për 20 përqind, në varësi të drejtimit dhe institucionin publik shëndetësor ku punojnë. Por sipas Ministrisë së Shëndetësisë, priten edhe masa të tjera motivuese për stafin mjekësor, por edhe për vetë pacientët. Kështu, nga 1 janari 2019, përpos që do të bëhet mjekimi pa pagesë për qytetarët do të

RRITJA E PAGAVE TË MJEKËVE SPECIALIST

# EKONOMISTËT SKEPTIKË



përfshihet dhe rroga, respektivisht të ardhurat neto të mjekëve specialistë, do të arrijnë shumën e lartpërmendur.

Por, paralajmërimin për rritjen e pagave, ekonomistët shohin me skepticizëm, sepse, sipas tyre, rroga nuk është i vetmi stimulues në punë, por janë edhe faktorë të tjerë.

Profesorit Universitar Nasir Selimi, për gazetën "Koha", thotë se nëse pas buxhetit vjetor që ka miratuar qeveria, nuk janë paraparë mjetet, atëherë është e vështirë të gjenden të ardhurat që do t'i mbulojnë pagat e mjekëve specialist që parasheh kjo qeveri. Prandaj, ai mendon se kjo nuk duket aspak serioze ose ndryshe shihet si masë populiste që nuk ka mbështetje reale.

Duke marrë parasysh se një numër i madh i mjekëve dhe njerëzve të shkolluar këtu ikin nga vendi, synimi për rritjen e pagave edhe mund të jetë një veprim i mirë, nënvizon Selimi, dhe shton se kjo nevojë nuk duhet të parashihet vetëm në shëndetësi, por edhe në fushat e tjera, për rritje të pagave, si inxhinierët, programerët, e të tjera, profesione këto shumë atraktive për Perëndimin.

Stimulimi përmes mjeteve financiare nuk është i vetmi motiv, por punëtorët si mjekët edhe të tjerët kërkojnë edhe kushte të tjera si dinjiteti i tyre, perspektiva, promovimi i tyre dhe shumë faktorë të tjerë, që ndikojnë te ata që të mbeten në vendin e tyre. Pozita e mjekëve,

por dhe të profesioneve të tjera, duhet të jetë më e mirë dhe më e vlerësuar në shoqëri.

Sipas analistit ekonomik Fatmir Bytyçi, ristrukturimi i shpenzimeve buxhetore dhe shfrytëzimi racional i burimeve mund të lejojë që në Maqedoni të ketë paga adekuate për personelin në sektorin e shëndetësisë, sidomos për numrin e madh të punëtorëve shëndetësorë të dëbuar jashtë vendit. Bytyçi thotë se paga është një mënyrë e duhur për të motivuar punëtorët për të qëndruar në Maqedoni dhe që të ketë një sistem solid të kujdesit shëndetësor për qytetarët. Ajo më shumë mund të shihet në drejtim të segmentit social dhe ofrimit të shërbimeve. Ai shton se në Maqedoni

edhe me këtë buxhet që kemi këtë vit, dhe me atë në vitet e ardhshme, në qoftë se në mënyrë adekuate strukturohen kostot, mund të gjendet burime për financimin e një kategorie të këtillë të pagave, siç është nënvizuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në aspektin e pagave, doktor Nikolla Panovski thotë se procesi për rritjen e pagave të specialistëve duhet të jetë gradual dhe duhet të gjenden fonde për sigurimin e pagave të mjekëve, sepse tani për tani mungojnë shumë gjëra në shëndetësi, por më shumë ka mungesë të mjekëve të specializuara.

Strategjia për të shpëtuar shëndetësinë nga kolapsi, sidomos pas largimit të një numri të madh të stafit mjekësor në vendet perendimore, do të ishte e paplotë pa një skanim të plotë të gjendjes financiare në këtë sektor. Kjo edhe për faktin se në shëndetësi ka ende borxhe, dhe këtë e ka konfirmuar edhe ministri Filipçe, i cili ka thënë se me fondet shtesë nga buxheti do të jetë Ministria e Shëndetësisë në gjendje për të kapërcyer sfidat në rrugën drejt ndërtimit të një sistemi modern shëndetësor. Ai paralajmëroi se do të ketë investime të mëtejshme nga buxheti dhe se shuma duhet të rritet për më shumë cilësi në shëndetësi, përmirësim të infrastrukturës, nivel më i lartë i pagave të punëtorëve dhe pajisje të reja nëpër spitale.

## NË LIQENIN E TRESKËS ENDE ËSHTË E NDALUAR LARJA

"E vetmja pengesë reale që kemi, jo e vetmja mirëpo më reale, është se ne nuk kemi konfirmim nga institucionet përkatëse, që uji në liqenin e madh të shfrytëzohet për not, gjegjësisht për larje", tha Blerim Bexheti – kryetar i komunës së Sarajit.

Liqeni Treska ende nuk është lëshuar zyrtarisht në përdorim nga komuna. Ende po priten rezultatet e analizave nga Instituti për Shëndet Publik, për nivelin e pastërtisë së ujit. Në këtë tabelë shkruan "Ndalohej larja në liqen". Mirëpo, fëmijët të shumtë kanë shkuar me ose pa prindërit e tyre dhe po bëjnë not në të. Tani për tani, liqeni nuk është i gati për tu shfrytëzuar, përveç pishinës së fëmijëve. Këtë e konfirmoi vetë kryetari i Komunës së Sarajit, Blerim Bexheti, raporton TV21.

Ai tha se ende nuk e dijnë nëse uji në liqen është i përshtatshëm për larje. Ndërkaq, Bexheti, përsë-



ri lëshoi ankesë në adresë të Ministrisë së Ekonomisë, për kërkesën e parashtruar. Ai tha se kjo çështje po e stagnon komunën në planet që ka për këtë liqen.

"Komuna e Sarajit, pas vonesave që na imponoi Ministria e Ekonomisë, realisht duke patur parasysh se ne kemi një ide tjetër, për zhvillim të hovshëm të liqenit, ne

kemi vazhduar investimet që ajo hapësirë të shfrytëzohet konform dedikimit. E vetmja pengesë reale që kemi, jo e vetmja mirëpo më reale, është se ne nuk kemi konfirmim nga institucionet përkatëse, që uji në liqenin e madh të shfrytëzohet për not, gjegjësisht për larje", tha Blerim Bexheti – kryetar i komunës së Sarajit.

Qytetarët nuk hezitojnë të shkojnë. Ndonëse këtu nuk ka asnjë shpëtimtar ose ndihmës. Disa thanë se uji është i pastër sa duhet, të tjerë thanë se ka barish-ta dhe papastërti, mirëpo me kërkesë të fëmijëve, ata shkojnë aty për rekreacion.

"Me familje, me nipër, të gjithë jemi këtu. Kemi ardhur shpesh

herë. Mirë duket, vetëm duhet të pastrohet pak liqeni, është shumë me kullosa, me barishte dhe kajde, nuk është i pastruar mirë. Ndalohej mirëpo fëmijët nuk pyesin, të na çoshë thonë. I solla me makinë deri këtu. Mundet me qenë e rrezikshme por s'kemi çfarë bëjmë, patjetër t'i sjellim fëmijët", u shpreh Hasan Saliu – qytetar.

"S'besoj asnjëherë, sepse ky ujë është i pastër. Që 30 vite jam këtu, çdo herë lahem dhe s'ka ndodhur asnjëherë asnjë sëmundje, asgjë", tha Muharrem Nashiti – qytetar.

Edhe pse nuk është bërë lëshimi ose hapja zyrtare e liqenit Treska, parkingu paguhet. Nëse u ndodh diçka qytetarëve gjatë shfrytëzimit të liqenit, kryetari i komunës tha se kjo nuk është përgjegjësi e tyre. Ai as nuk na dha një datë të mundshme se kur qytetarët përfundimisht, pa hamendj mund të shkojnë për not në Liqenin Treska. Analizat e ujit po bëhen që nga muaji maj.



## BUJQËSIA E MAQEDONISË KA NEVOJË PËR INOVACIONE DHE DIGJITALIZIM

FAO-s për Evropën dhe Azinë Qendrore. Në intervistë për MIA-n, Rakhmanin thotë se Maqedonia është në rrugën e duhur dhe FAO është e gatshme ta përkrah, por, nevojitet edhe shumë punë.

Sipas tij, duhet të zgjidhet problemi me sipërfaqet e ndara, ndër- sa nevojitet edhe transformim sa më i shpejtë ndaj sistemeve të qëndrueshme për ushqim.

"Në epokën e digjitalizuar, afaristët e vegjël dhe fermerët familj-

larë në Maqedoni kanë nevojë për inovacion të vazhdueshëm, e për këtë u nevojitet përkrahje më e mirë përmes shërbimeve të përforuara, inkluzive dhe pluraliste këshilldhënëse", tha Rakhmanin.

Lidhur me konkurrencën në tregun evropian, që posaçërisht do të shprehet pas hyrjes eventuale të Maqedonisë në BE, thotë se prodhimet nga nënsektorët e punës kanë mundësi më të mira, si dhe prodhimet me karakter lokale, posaçëri-

sht ato organike.

Për subvencionet dhe arsyeshmërinë e tyre, thekson se është pozitive ajo që vendet nga rajoni financiarisht e përkrahin rritjen bujqësore dhe zhvillimin rural, duke i marrë parasysh aspektet sociale. Intervistën me rastin e nënshkrimit të programit kornizë të FAO-s për Maqedoninë për periudhën 2018-2020 të caktuar për 11 korrik, MIA do ta publikojë në tërësi gjatë ditëve të ardhshme.



## Turqia, 1.6 miliardë dollarë nga eksporti i lajthive

Turqia në dhjetë muajt e sezonit të eksporteve, ka shitur në tregun ndërkombëtar rreth 255.000 ton lajthi, me çka ka realizuar një përfitim prej 1.6 miliardë dollarë, raporton AA. Vëllimi i eksporteve nga periudha e shtatorit të vitit 2017 deri në qershor 2018, ka shënuar një rritje me 25.3 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, bëri të ditur Unioni i eksportuesve të lajthive. Përkundër rritjes së eksportit, nuk kanë kënaqur të hyrat nga malli i shitur, nga shkaku i rënies së vlerës së lajthive për 3.5 për qind, bën të ditur Unioni. Rreth 75 për qind e eksportit të lajthive ka shkuar në tregun e Bashkimit Evropian (BE), duke sjellë një përfitim prej 1.2 miliardë dollarë. Gjatë tërësë së sezonit eksportues, shtator 2016 - gusht 2017, Turqia ka eksportuar 236.000 ton lajthi me një total të përfitimit me 1.88 miliardë dollarë. Ndryshe, Turqia është eksportuesi më i madh i lajthive në botë.

## Rizgjojen minierat

Industria minerale është para një hovi të ri prej investimeve të reja, me rreth 25 milionë euro në sektorin e përpunimit, me dy linja të reja nga AlbChrome në Bulqizë dhe Tete Albania në Spaç, që pritet të rrisin dukshëm vlerën e eksporteve në fund të këtij viti dhe gjatë 2019. Rritja e çmimeve të mineraleve në tregjet ndërkombëtare dhe së fundmi kromit, ka riaktivizuar investime të reja në nxjerrje. Po vihet në punë miniera e kromit në Vlahën të Kukësit, me një investim 10 milionë euro nga kompania turke

Ekin Maden Ticaret dhe Beralb riaktivizon edhe një herë vendburimet e bakrit pas një "pushimi" dyvjeçar.

Shqipëria ka një nëntokë të pasur me minerale të kromit, bakrit dhe hekur-nivelit, por në këto 30 vite të tranzicionit, teknologjia e vjetruar dhe koniunktura e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, herë në favor dhe herë në disfavor, e ka lënë zhvillimin e sektorit nën potencial. Për vite me radhë, mineralet shqiptare janë eksportuar siç janë nxjerrë nga toka, pa mundur të kryejnë as përpunimet fille-



stare, duke humbur kështu vlerën e shtuar në eksporte nga shitja në tregjet ndërkombëtare.

or duket se fitimet e ekonomisë shqiptare nga mineralet janë para një perspektive të mirë, për shkak të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe investimeve të reja në sektor. Sipas in-

deksit tremujor të Bankës Botërore, çmimet e metaleve parashikohen të rriten për 9% në vitin 2018, për shkak të rritjes së mëtejshme të kërkesës. Banka Botërore nuk ishte optimiste për çmimet e kromit, por zhvillimet e fundit i kanë çuar për lart çmimet në bursa për ferrokromin. / Monitor

Publicitet



Republika e Maqedonisë  
Ministria e Financave

MFRM.PE.750.347/1



MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave në bazë të nenit 22 paragrafi 1, alinea 2 dhe alinea 6, paragrafi 3, paragrafi 5 dhe paragrafi 8 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), neni 22 paragrafi 1 pika 1, neni 23, neni 24, neni 25, neni 26 dhe neni 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18) dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Ministrinë e Financave, publikon:

### SHPLLJE NUMËR 1/2018 PËR PUNËSIM NË MINISTRINË E FINANCAVE

Ministria e Financave publikon shpallje për punësim të 6 (gjashtë) personave edhe atë:

I. Në afat kohor të caktuar, deri në përfundimin e mandatit të ministrit të financave, 2 (dy) persona në këto vende të punës:

**1. Këshilltar i posaçëm për çështje që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare financiare, menaxhimin me borxhin publik, financimin qendror dhe lidhje të marrëveshjeve dhe menaxhim me mjetet nga Instrumenti i Ndhmës së Para Aderimit – IPA – (1 realizues)**

**Kualifikime të nevojshme:**

- Së paku 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar shkallën VII/1 shkencat organizative dhe menaxhimi (menaxhment)
- Së paku 2 vite përvojë pune në profesion;
- Njohjen e gjuhës angleze;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premtën
- Paga neto 36.800,00 denarë

**2. Këshilltar i posaçëm për marrëdhënie me publikun dhe komunikim (1 realizues)**

**Kualifikime të nevojshme:**

- Së paku 240 kredi sipas sistemit ECTS ose të mbaruar shkallën VII/1 në shkencat ekonomike;
- Punë me projekte nga sfera e mediave dhe prodhimit audio-vizual;
- Njohjen e gjuhës angleze;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

- Orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor 40 orë - nga e hëna deri në të premtën;
- Paga neto 33.000,00 denarë

II. Në kohë të caktuar, për shkak të zmadhimit të përkohshëm të punës, për aq sa ka nevojë institucioni, por jo më gjatë se një vit, 4 (katër) persona në pozicionet e mëposhtme:

**3. Korrier, në Njësinë për punë të përgjithshme, Sektori për çështje juridike ..... (3 realizues)**

**Kualifikime të nevojshme:**

- Arsimit fillor ose të mesëm;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premtën;
- Paga neto 12.014,00 denarë.

**4. Shofer, në Njësinë për punë të përgjithshme, Sektori për çështje juridike..... (1 realizues)**

**Kualifikimet e nevojshme:**

- Arsimit të mesëm;
- Patentë shoferi për kategorinë B;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Orari ditor i punës ndërmjet orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi ndërmjet orës 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premtën;
- Paga neto 15.655,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të cilat kërkohen për vendin e punës për të cilin aplikojnë, përkatësisht: biografi të shkurtër – CV detyrimisht me kontaktin e telefonit dhe adresën; fotokopje të vërtetimit të

nënshtetësisë; fotokopje nga dëshmia për nivelin e përfunduar të arsimit për vendin e punës që kërkohet; vërtetim nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i RM-së (FSPI) si dëshmi për përvojën e kërkuar të punës (periudhë e evidentuar në Agjencinë për punësim si stazh pune); fotokopje të patentë shoferit për kategorinë B, fotokopje të dëshmisë për njohjen e gjuhës angleze.

Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në zarf të mbyllur në këtë adresë:

**Ministria e Financave**  
**rr. Dame Gruev nr. 12, 1000 Shkup**  
**(me emërim "për shpallje për punësim")**

Në zarf të shënohet numri i shpalljes dhe vendi i punës për të cilën aplikon, me vërejtje: "Mos hap".

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tre (3) ditë pune duke llogaritur ditën e publikimit të shpalljes në gazetën ditore.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni me vonesë, i paplotësuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Pas selektimit të fletëparaqitjeve, kandidatët të cilët kanë dokumentacion të rregullt do të thirren në intervistë në hapësirat e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave do të kryejë përzgjedhjen në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Personi për kontakt:

Verica Stoilova – tel. 02/ 3255 619;  
[verica.stoilova@finance.gov.mk](mailto:verica.stoilova@finance.gov.mk)  
Liljana Stojanovska – tel. 02/ 3255 624;  
[liljana.janevska@finance.gov.mk](mailto:liljana.janevska@finance.gov.mk)



МАКЕДОНСКИ ШУМИ  
во партнерство со природата



Ул. "Петро Наров" Бр.128; 1000 Скопје; Р. Македонија  
Тел. ++389 (0)2 2581080 Факс. ++389 (0)2 2581824

Në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2013, 69/2013, 27/2014, 42/2014, 178/2014, 180/2014, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18), Vendimin e Këshillit drejtues të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup nr. 02-562/4 të datës 27.06.2018 dhe nenit 35 të Statutit të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup, Drejtori i NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup publikon

**SHPALLJE nr. 02/2018**  
PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS AFARISTE  
përmes ankandit elektronik

**1. LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

Lëndë e ankandit publik elektronik është dhënie me QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE – (për herë të parë) të NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup.  
Hapësirat afariste nga pasqyra tabelore jepen për periudhë prej 5 vjet me mundësi për vazhdim të marrëveshjes.

**2. TË DHËNA PËR MJETIN E PATUNDSHËM I CILI JEPET ME QIRA**

Nu mri ren dor	Numri i PK, KK dhe Lista pronësore	Objekti afarist Përshkrim, adresa	Sipërfaqja e brendshme e përgjithshme m <sup>2</sup>	Vlera e përgjithshme e vlerësuar e hapësirës afariste (në denarë)	Çmimi fillestar për qiranë mujore (në denarë, pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës 2% e vlerës së përgjithshme të vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha dhe data e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1.	PK 1059 KK Germijan LP 663	Adresa: Karaxha Ndërtesa 1 – hyrja 1 – 80m2 Ndërtesa 1 – hyrja 1 – 147 m2 Ndërtesa 2 - hyrja 1 – 10 m2	237 m2	2.045.349,00 den	10.227,00 den	40.907,00 den	10 ditë nga dita e shpalljes	23.07.2018 në ora 10.30

Qiraja paguhet në denarë.

Qiraja në marrëveshje për qira do të shprehet në neto shumë – pa TVSH. Tatimi i vlerës së shtuar shprehet në faturë të posaçme.

Qiramarrësi është i obliguar qiranë ta paguajë para kohe, më së voni në ditën e 5-të muajt , pavarësisht të pranimit të faturës. Për pagesë të vonuar të qirasë do të llogaritet interesi ligjor për vonesë.

Mos pagesa e 2 (dy) qirave të njëpasnjëshme mujore, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies në qira, paraqet bazë për aktivizimin e mjeteve për siguri dhe bazë për anulim të marrëveshjes nga ana e NP Pyjet e Maqedonisë Shkup.

**3. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE**

1. **Persona fizik:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Persona juridik:** personi lokal juridik, personi juridik në pronësi të përzier, person fizik në pronësi të përzier, person juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, persona të huaj juridik rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe persona juridik shtetas të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Objekti afarist jepet me qira dhe i njëjti mund të vizitohet çdo ditë pune prej ora 12.00 deri në ora 15.00 me paralajmërim paraprak dhe prezencë të përfaqësuesit nga NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup.

**4. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK:**

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrorin Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, e cila dërgohet përmes rrugës elektronike për secilin hapësirë afariste veç e veç dhe duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë, në pajtim me kushtet e Shpalljes, me shtojcat në vijim:

1. Fletëparaqitje të plotësuar dhe nënshkruar personalisht nga parashtruesi në të cilën janë dhënë të dhënat e përgjithshme të ofertuesit (emri, mbiemri, adresa e saktë, cilat dokumente dorëzohen me fletëparaqitjen), në pajtim me kushtet e Shpalljes;

2. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumë prej -----(2% e shumës së vlerësuar) me afat prej 60 ditë nga dita e ankandit publik ----(të shënohet numri rendor i pasqyrës tabelore dhe dresa se ku gjendet objekti afarist). Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

3. Deklaratë të vërtetuar në NOTER se në çfarëdo baze nuk ka të paguara obligime ndaj NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup

4. Vërtetim se nuk është hapur procedurë për falimentim ose likuidim.

5. Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar masë për siguri: ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

6. Dëshmi për identitet

- Për personat fizik certifikatë të shtetësisë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Për personat juridik gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, (nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj të dorëzohet dokument përkatës i ofertuesit është regjistruar të dhënë nga organi kompetent ose deklarata në noter të vërtetuar tek organi kompetent – me përkthim).

7. E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do ti dërgohen emri përdorues dhe shifra për qasje në internet faqen në të cilën do të realizohet ankandit publik elektronik;

Dokumentet me numrat rendor 1, 3, 4, 5 dhe 6 duhet të skanohen në një PDF dokument dhe i njëjti duhet të ngarkohet gjatë paraqitjes edhe atë në pjesën "Deklarata".

Garancia bankare (dokumenti me numër rendor 2) duhet të skanohet në PDF dokument dhe të ngarkohet gjatë paraqitjes edhe atë në pjesën "Garancia bankare".

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

Krahas ngarkimit të këtyre dokumenteve përmes formës elektronike, patjetër dokumentet me numër rendor 2 (Garancia bankare – në origjinal) dhe dokumentet me numër rendor 1,3,4,5 dhe 6 – (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) të dorëzohen edhe deri në NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, në rr. Pero Nakov nr. 128 Shkup (MZT), më së voni deri në ditën e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjes.

**8. AFATET**

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrohen më së voni në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes, gjegjësisht duke filluar prej më 09.07.2018 deri më 18.07.2018 deri në ora 23,59 përmes formës elektronike në internet adresën [www.deloven-prostor.mk](http://www.deloven-prostor.mk).

Ankandit publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim [www.deloven-prostor.mk](http://www.deloven-prostor.mk)

Ankandit publik fillon në internet faqen me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar për qira mujore të objektit afarist dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve, për secilin objekt veç e veç.

**VËREJTJE:**

1. Personi fizik, subjekti juridik dhe themeluesi i subjektit juridik, i cili në çfarëdo baze ka pagesa të porealizuara ndaj NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, nuk mund të merr cilësinë e qiramarrësit të NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup.

**PROCEDURA**

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni vërteton kompletimin e dokumentacionit në pajtim me kushtet e shpalljes, sipas së cilës informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.

2. Parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në afat prej 3 ditëve nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes u dërgon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar u dërgon lajmërim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

3. Parashtruesit e fletëparaqitjeve të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar për pjesëmarrje në ankandin publik në pajtim me shpalljen, në ditën e realizimit të ankandit publik regjistrohen në internet faqen e shënuar në shpallje me emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, pas së cilës kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.

4. Ankandit publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

5. Ankandit publik do të mbahet edhe në qoftë se pas shpalljes është paraqitur edhe vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në shpallje.

6. Ankandit publik fillon me prezantimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minuta e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandit publik mund të llogaritet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës nëse në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afati përfundimtar për përfundimtar të ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të ketë ofertë të re të dhënë.

7. Ankandit publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minuta e para të ankandit publik nuk pranohet oferta, gjegjësisht, nuk është dhënë çmim më i lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar i hapësirës afariste ulet për 2% pas së cilës pjesëmarrësit në ankandin publik sërish kanë mundësi të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste.

8. Nëse me kalimin e dy minutave të fundit të pesë minutave të dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimtar të ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë të re.

9. Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga çmimi i përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste gjatë ankandit mund të bëhet më së shumti deri në 30% nga vlera e përcaktuar e tregut të hapësirës afariste, pavarësisht se sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik.

10. Pas përfundimit të ankandit publik, sistemi elektronik vet gjenerohet (përpilon) procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet deri tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik në mënyrë elektronike.

11. Nëse bëhet fjalë për publikim për herë të dytë, shumta e përgjithshme e vlerësuar e qirasë mujore të hapësirës afariste mund të ulet më së shumti deri në 30% nëse në ankandin publik paraqitet vetëm një pjesëmarrës i interesuar, gjegjësisht deri në 50% nëse paraqiten dy ose më shumë pjesëmarrës.

12. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri tek Komisioni, e cila vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës.

13. Për ofertues më të volitshëm llogaritet pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ka ofruar çmim të fundit më të lartë të përgjithshëm, e cila paraqet çmim më të lartë të qirasë së hapësirës afariste.

14. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të procedurës për ankand publik duhet të sigurojë depozitë të të hollave ose garanci bankare për sigurimin e obligimeve në shumë prej 3 (tre) qirave mujore, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do ti shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose për dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

15. Tatimi i vlerës së shtuar për shumën e qirasë mujore bien në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

16. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në momentin e lidhjes së Marrëveshjes për qira.

17. Marrëveshja për qira të hapësirës afariste lidhet për kohë të caktuar për 5 (pesë) vjet në gjendje të parë me mundësi për vazhdim dhe solemnizohet në Noter me harxhime të ofertuesit më të volitshëm dhe i njëjti do të ketë cilësinë e dokumentit ekzekutiv.

18. Nëse me faj (ndërprerje, anulim ose mënyrë tjetër) të qiramarrësit vjen deri tek ndërprerje e kësaj Marrëveshje para kalimit të afatit për të cilin është lidhur, qiramarrësi është i obliguar në afat prej 8 ditëve të ndërprerjes së Marrëveshjes ti paguajë qiradhënësit penale për ndërprerje të parakohshme të Marrëveshjes me kompensim të dëmit në shumë prej 3 (tre) qirave mujore.

Informatat më të detajuara mund të merren në selinë e NP Pyjet e Maqedonisë – Shkup, rr. Pero Nakov nr. 128 Shkup.

**Personat për kontakt:**

Llazar Llazarov tel. 071/229-468

[Lazar.lazarov@mkdsumi.com.mk](mailto:Lazar.lazarov@mkdsumi.com.mk)

Vera Dimitrieska tel. 070/318-987

[Vera.dimitrieska@mkdsumi.com.mk](mailto:Vera.dimitrieska@mkdsumi.com.mk)

Komisioni për realizimin e procedurës për dhënie me qira të hapësirës afariste përmes ankandit publik elektronik

# E qëlloi babai me topuz në kokë kur po flinte

Një 41-vjeçar ka ndërruar jetë në Spitalin e Traumës në Tiranë, tri ditë pasi u dhunua barbarisht nga babai i tij. Ngjarja tragjike ndodhi në fshatin Gjericaj të Durrësit. Viktima Agron Tema u dërgua fillimisht në Spitalin Rajonal të Durrësit të hënën në mëngjes, por prej andej u përcjell për në Tiranë për ndihmë më të specializuar, për shkak se gjendja e tij paraqitej e rëndë. Pavarësisht ndihmës së mjekëve, 41-vjeçari ndërroi jetë mesditën e së enjtes, transmeton syri.net.

I ati, Xhavit Tema, ndodhet prej tri ditësh në ambientet e paraburgimit në Durrës. 70-vjeçari, gjatë marrjes në pyetje nuk ka shfaqur aspak pendesë për krimin, ndërsa ka dhënë disa versione mbi shkakun e dhunës ndaj të birit.

Ngjarja e rëndë ndodhi gjatë natës së 2 korrikut në fshatin Gjericaj. I moshuari u arrestua në kushitet e flagrancës, pas denoncimit të bërë për dhunë në familje. Përveç djalit, viktimë e agresionit të 70-



vjeçarit ishte dhe Jolanda Tema, 24 vjeçe, nusja e djalit të vogël të të moshuarit, që jeton në emigracion. Policia bën të ditur se Xhavit Tema në banesën e përbashkët ka goditur djalin e tij me shkop topuz, që përdoret zakonisht për shtypjen e ullinjve, ndërsa ky i fundit ishte në gjumë.

Goditja në koka i ka shkaktuar Agron Temës dëme të rënda. Ndërsa më pas ka tentuar të njëjtën gjë dhe me nusen e djalit të tjetër, Jolandën, duke e goditur në trup

ndërsa po flinte në shtrat. Kjo e fundit mori dëmtime të lehta dhe ishte ajo që bëri denoncimin në Polici për atë që kishte ndodhur.

Me anë të dy njoftimeve, Policia e Durrësit sqaron: "Më datë 02.07.2018, u arrestua në flagrancë shtetasi Xh.T., vjeç 70, banues në fshatin Gjericaj, pasi ka goditur me sende të forta djalin dhe nusen e djalit A.T., dhe J.T., vjeç 41 e 24. A.T. ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve, J.T., pa probleme për jetën",- tha Policia në komunikatën

paraprake, ndërsa njofton se, "Në vijim të komunikatës që bën fjalë për veprën penale "Dhuna në familje", më datë 05.07.2018, ka ndërruar jetë në spital shtetasi A.T., vjeç 41, banues në Gjericaj, Durrës".

Pritet që Prokuroria të ndryshojë akuzën ndaj 70- vjeçarit në "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", tani që djali i tij ndërroi jetë pas dhunës së pësuar. Buri me policore thanë se të hënën e 2 korrikut, në kulmin e një sherri, 70-vjeçari dhunoi në banesë djalin dhe nusen e djalit tjetër të tij, 24 vjeçe, duke i goditur me sende të forta. Ata u transportuan në spital, por tri ditë më vonë 41- vjeçari humbi jetën.

Ndërsa e reja mësohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Buri nga grupi hetimor thanë për gazetën Panorama se 70-vjeçari dyshohet të ketë probleme psikologjike. Ai nuk ka shfaqur pendesë për vrasjen e të birit dhe jep deklarata kontradiktore për motivin e ngjarjes.

## Shkup, 13-vjeçarja mbytet në gropën me ujë

Një vajzë 13-vjeçare është mbytur në Komunën Ilinden, në një gropë të mbushur me ujë ku po ndërtohej objekti. Tragjedia ka ndodhur në rrugën nr. 2 në vendin Biglla në lagjen Ilinden. Ekipi i njësitit të zjarrfikësve i Qytetit të Shkupit është nisur drejt kantierit, por ndërkohë banorët e kanë nxjerrë trupin e vajzës e cila, me siguri duke luajtur, ka rënë në ujë dhe është ngulftatur. Ekipi mjekësor ka konstatuar vdekjen. Sipas deklaratave nga banorët të Ilindenit, vajza 13-vjeçare ka hyrë në gropën me ujë që ta nxjerrë vëllanë e saj dhe një fëmijë tjetër të cilët kanë rënë në gropë. Banorët kërkojnë përgjegjësi nga firma që e ka ndërtuar objektin se pse vendi nuk ka qenë i siguar.



## Babait vret djalin dhe vajzën

Një ngjarje e rëndë tronditi të enjten veriu e Sidneit në Australi, aty ku një baba vrau dy fëmijët e tij adoleshentë, në një akt që policia e cilësoi si sulm të planifikuar. 15-vjeçari Jack dhe 13-vjeçarja Jennifer Edwards u gjetën në vranë në shtëpinë e tyre në Hull Road, në West Pennant Hills. Ata u qëlluan për vdekje mbrëmjen e së enjtes nga babai i tyre John Edwards. Rreth 12 orë më vonë, ai u gjet i vranë në shtëpinë e tij në Normanhurst.

Policia beson se 68-vjeçari u vetëvra pas krimit. Hetuesit e besojnë se vrasjet ishin të paramenduara dhe të planifikuara më parë nga Edwards.

Ai kishte qenë në një betejë ligjore për kujdestarinë e fëmijëve gjatë dy viteve të fundit me ish-bashkëshorten e tij, nënën e dy fëmijëve.

Megjithatë hetimet për të zbardhur plotësisht shkaqet që çuan babain t'i merrte jetën dy fëmijëve të tij vijojnë./tvklan.al

## Gruaja shtatzënë humb jetën në Kanionin e Matkës

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Kanionin e Matkës. Të shtunën rreth orës 16-të një shqiptare e re nga Kosova i është afruar lumit Treska për t'i larë duart, mirëpo fati i keq ka qëlluar që të rrëshqasë në ujë.

Një qytetar në orën 16:55 ka lajmëruar përmes telefonit në Njësinë për informacion dhe komandë në Shkup, se në ujërat e Treskës në Saraj, në afërsi të një objektit hotelierik, është vërejtur një person

grua, e cila po kërkonte ndihmë. "Nga ana e qytetarëve gruaja është nxjerrë në breg dhe sipas njoftimeve të qytetarëve, ende ka pasur shenja jete. Por, kur ka arritur Ndihma e Shpejtë, mjeku ka konstatuar vdekjen e saj", kumton MPB.

Prokurori Publik dhe një ekip nga SPB Shkup kanë kryer hetim në vendin e ngjarjes, ndërsa me urdhër të Prokurorit Publik trupi i pajetë është dërguar për autopsi në Institutin për mjekësi ligjore.



## Plumba dhe gjak në Dhërmi

Një konflikt mes disa pushuesve për pak sa nuk është kthyer në tragjedi në bregdetin e Dhërmit. Fillimisht, disa persona kanë debatuar me fjalë mes tyre dhe më pas janë përdorur armët. Fatmirësisht në këtë ngjarje nuk raportohet për persona të plagosur me plumba, por disa të rinj mësohet se kanë pësuar lëndime të lehta nga thyerja e xhamave nga të shtënat. Ngjarja e rëndë ndodhi gjatë orëve të mbrëmjes së një nate më parë.

Sipas të dhënave paraprake, bëhet me dije se është qëlluar me armë në ajër brenda një lokali të njohur. Të rinjtë janë larguar me vrap nga vendngjarja ndërkohë policia është vënë në kërkim të tyre. Nuk dihen ende motivet e konfliktit por dyshimet paraprake flasin për një sherr për motive banale. P

ersona të shumtë kanë qenë dëshmitarë të asaj që ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të së dieles në një lokal nate në Dhërmi. Ndonëse policia e Vlorës në komunikatën zyrtare pohoi se nga të shtënat me armë zjarri në diskon 'Havana' në Dhërmi nuk pati njerëz të lënduar, dëshmitarët në vendngjarje kanë



pohuar se kanë parë tmerr me sy.

Një dëshmitar në vendngjarje ka rrëfyer për JOQ.al se njerëzit veç plumbave që mund të kishin marrë nga të shtënat e armës, u lënduan edhe në tentativë e sipër për të dalë nga klubi i natës. "Isha i pranishëm tek ngjarja në Dhërmi. Ishte super kaos dhe pamë njerëz duke vrapuar, të lyer në gjak nga përpjekjet për të dalë nga Havana. Pamë dhe më vonë personin që qëlloi me armë, duke u përpjekur të fshihej. Unë po kaloja aty dhe në një moment u dëgjua një krismë, njerëz që bërtisnin dhe që po shpërndareshin. Pas asaj vazhduan diku tek 6 krisma të tjera. Pamë një çift francez që kishin prerë këmbët

me xhama, njerëz duke vrapuar. Më vonë u grumbulluan afër një vile. Vajtëm për të parë se çfarë po ndodhte. Pamë personin me armë në dorë që po përpiquej të fshihej. Kemi qenë rreth 20 çuna dhe u shpërndamë" ka thënë dëshmitari. I pyetur në lidhje me arsyet e kësaj ngjarje, djali thotë se nuk i di me saktësi, por në zonë flitet se bëhet fjalë për konflikte të vjetra, për një debat që agravoji dhe pati këto pasojë, ndërsa autori, i cili ishte vetëm një dhe jo disa, dyshohet të jetë me origjinë nga Laçi. "Besohet se kanë qenë konflikte të vjetra... Personi që qëlloi ka qenë laçjan me sa dëgjova... Më vonë unë u ngjita te terraca e hotelit dhe ndo-

qa veprimet që aty lart. Pamë që policia shoqëroi disa persona"- tha ai.

Sa i takon ambulancës dhe dhënies së ndihmës së parë, dëshmitari tregon se ishte lajmëruar një mjekë e njohur në Dhërmi.

"Ambulanca erdhi sepse njoftova një mjekë që e njoh në Drimadhe, por nuk e lejova të shkonte në vendngjarje pa mbërritur policia, sepse zona nuk ishte e sigurt. Mendohet që ka edhe të vdekur. Numri i të plagosurve nga përpjekjet për të dalë mund të jetë i lartë. Ai ka qenë një sherr masiv që ka kaluar në një nivel tjetër, sepse pash disa çuna që ishin nixirë nga fytyra ishte gjë e gabuar për turizmin, sepse klientët e hotelit e konsideruan si një akt terrorist"-shprehet dëshmitari.

Njoftimi i policisë për ngjarjen: "Në Dhërmi nuk ka ngjarje të rëndë kriminale. Nuk ka asnjë të lënduar asnjë të plagosur asnjë viktimë. Ka ndodhur një konflikt në një lokal. Një person ka qëlluar me arme në ajër. Policia ka ndërhyrë menjëherë ku ka bere te mundur kapjen dhe shoqërimin e autorit të dyshuar. Grupi hetimor është duke punuar për dokumentimin e plote të ngjarjes".

# Axhendat personale e jo publike të Presidenti të Maqedonisë



Nga  
Delvina KËRLUKU

A mund të kemi guxim të kritikojmë një demokraci nën kthetrat e diktaturës? Shpesh e parashtrij këtë pyetje, e s'gjej fundin e përgjigjes! Ata që tërbohen ndaj një kritike do të thotë se e kuptojnë se e meritojnë. Kritikën që i drejtohen Presidentit të Shtetit (Gjorgje Ivanov) janë aq të zëshme, por nuk përfillen nga ai, as edhe nga këshilltarët e tij, veçmas atij shqiptar, që i mungon guximi. Kur dihet se çdo shqiptar duhet të mendojë për realizimin e interesave shqiptare dhe çfarë duhet të parandalojnë në raport me këto interesa. Kam dëgjuar e lexuar kritikën ndaj Presidentit nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, nga profesorë, politikanë e shumë të tjerë, që Presidenti e ka detyrë kushtetuese t'i nënshkruajë ligjet dhe marrëveshjet, të cilat i miraton dhe i ratifikon Parlamenti. Por, që të refuzohet kritika edhe nga ndërkombëtarët, respektivisht pjesëmarrësit në negociatat e ndryshme të ngjarjeve në Maqedoni, pjesëmarrës edhe të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, kjo duhet të zgjojë Presidentin dhe ekipin e tij.

Ditë më parë isha pjesë e promovimit të librit "Peacemakers", të autorit James Pardew, në Shkup. Autori ka qenë dëshmitar i ngjarjeve dramatike dhe të luftërave në një pjesë të Evropës, duke qenë pjesëtar i diplomacisë amerikane në procesin e paqeruajtës në Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni. Pardew e pohoi se ligji i gjuhës është miratuar nga parlamenti, por hodhi kritikën në drejtim të Presidentit se nuk duhet të ketë shkak që ta refuzojë nënshkrimin e tij. Po ashtu, edhe për refuzimin e marrëveshjes mes Shkupit dhe Athinës.

E vërteta edhe sipas ndërkombëtarëve është një 'armë' e tmerrshme sulmi ndaj Presidentit Ivanov. Njerëzit serioz, si Presidenti, nuk kanë nevojë për gjethë (fiku) që të mbulojnë të vërtetën lakuriqe. Në vend se të interpretojmë vlerat tona, ne përpiqemi të kapërcejmë pengesat e një njeriu që shpreh qëndrime dhe interpretime personale. Të gjithë brezat e rinj të vendit tonë kanë kërkuar dhe kërkojnë të bëjnë interpretimin se cilat janë vlerat tona që na karakterizojnë dhe na dallojnë nga vendet e tjera të rajonit. Interesa që janë në dobi jo vetëm në teatrin e brendshëm por edhe në arenën ndërkombëtare. Përcjellja e këtyre interesave kërkon përpjekje maksimale për krijimin e një klime të favorshme brenda dhe

jashtë vendit. Sepse vlerat ndërtojnë harmoni brenda shoqërisë tonë dhe të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit me vendet e tjera. Dhe pikërisht institucioni i Presidentit të Republikës, si autoritet kryesor që shërben si simbol i bashkimit të shoqërisë, do të duhej të jetë pikë referuese në përcaktimin dhe artikullimin e interesave të qytetarëve, mbështetur mbi legjitimitetin dhe baraspeshën që ofron procesi i njohjes dhe respektimit të këtij autoriteti. Jam njohur edhe më herët me termin e kryetarit të shtetit, pikërisht në lëndën "Mbrotja", (në fakultetin tim të dytë Pedagogji) se Presidenti i Republikës është drejtuesi i një prej institucioneve më të rëndësishme kushtetuese të vendit; Presidenti i Republikës është Kreu i Shtetit; Presidenti i Republikës përcjell në mënyrë zyrtare politikën e jashtme të shtetit që miratohet nga Kuvendi i Maqedonisë dhe zbatohet nga qeveria, por është zëri i Presidentit të Republikës që, në bazë të Kushtetutës, që e paraqet këtë politikë të jashtme të shtetit; Presidenti i Republikës është një aktor i rëndësishëm në përbërjen e institucioneve të larta të vendit, siç janë: Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Natyrisht, këtë e bën në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin. Presidenti i Republikës është zgjedhur për një mandat pe-

sëvjeçar. Presidenti i Republikës i ka të përcaktuara qartazi detyrat, të drejtat dhe detyrimet e tij në Kushtetutën e vendit. Nëse Presidenti i Republikës do të veprojë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës, pa dyshim, mban përgjegjësinë e tij institucionale dhe ligjore. Besoj se duhet të vazhdojë të ofrojë Presidenti i Republikës, bashkëpunimin, mbi të gjitha, mirëbesimi midis institucioneve të vendit. Kjo është në bazën e themelimit të punës së vetë institucionit në mënyrë individuale, por edhe në mënyrë kolektive si mënyrë bashkëpunuese sepse institucionet vërtet kanë pozicionet e tyre të veçanta, por fundja, të gjitha janë prodhim i shoqërisë, dhe në shërbim të tyre dhe të shtetit, prandaj duhet të funksionojnë në harmoni me qëllim që të komplementojnë njëri-tjetrin në përbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara. Në çastin që funksioni, detyra dhe përgjegjësia janë të qarta për tu ushtruar, dhe këtë besim disa vite ia kemi dhënë z. Ivanov, ato duhet të nënshtrohen në çastin më të parë të mundshëm. Ushtrimi i detyrave kushtetuese duhet të lidhet me detyrimet kushtetuese dhe kriteret ligjore e jo me interesat personale. Presidenti i Republikës nëse ka qëndrimin strikt, kjo reflekton tek opinionin publik. Kjo nuk do të thotë që Presidenti të bëjë

**Presidenti i sotshëm, por edhe ai i së nesërme duhet të dijë që, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve (Kuvendit) është një element i rëndësishëm për funksionimin e tyre, për imazhin e vendit edhe për përbushjen e detyrave të gjithsecilit.**



të paqenën, gjithsesi, janë institucionet ato që e ndihmojnë Presidentin e Republikës. Presidenti i Republikës duhet ti ndjek të gjitha hapat ligjore dhe kushtetuese që e lidhin atë me një detyrë kaq të rëndësishme. Supozojmë se ka arsye kushtetuese që të refuzojë Ligjin për gjuhën (shqipe) ose marrëveshjen Shkup - Athinë... Atëherë me arsye kushtetuese mund të refuzojë për të dekretuar ndonjë emër të caktuar si bie fjala posti (këshilltar) mbi ministrat e vendit, që është në dëm të ministrave shqiptar. Kemi parë që një President i Republikës, të mbajë anë nga kalimi i shtetit nga e djathta në të majtë ose e kundërta. Por, ne të gjithë e dimë se Presidenti i Republikës, nuk mund të dalë jashtë tagrit të tij kushtetues. Siç edhe është detyra e tij kushtetuese, që fillon me thirrjen e Kuvendit, me dekretimin e Kryeministrit, të qeverisë, betimin e ministrave dhe në një vijë me këta shtytjen e institucioneve të pavarura, për të përbushur detyrat e tyre me të njejtin përgjegjësi si në çdo vend, në kohë normale të qeverisjes. Presidenti i sotshëm, por edhe ai i së nesërme duhet të dijë që, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve (Kuvendit) është një element i rëndësishëm për funksionimin e tyre, për imazhin e vendit edhe për përbushjen e detyrave të gjithsecilit.

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaška lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e preme 6 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# REGJISTRIMET E POPULLSISË

Nga  
Rami VELIU



Në hapsirën e ish Jugosllavis, janë kryer dy regjistrime të para LDB-re edhe atë 1921 dhe 1931, i treti me rradhë është dashur të kryhet në vitin 1941, për shkak të LDB, ky regjistrim nuk u krye. Pas Luftës së Dytë Botërore u kryen këta regjistrime: 1948, 1953 dhe pastaj me rrdhë: 1961, 1971, 1981 dhe 1991 (1994) dhe pas m'vetësimit të Maqedonis, regjistrimi vijues u krye në vitin 2002.

Në vitin 2011 regjistrimi i dytë me rradhë dështoi! Fajin për dështimin e këtij regjistrimi, si çdo herë i'a hodhën shqiptarëve. Pra, gati dy dekada nuk është zhvilluar asnjë regjistrim. Së fundmi ESHS doli me vendim se regjistrimi vijues do të mbahet më vitin 2020. Siç e theksuam më lartë, shihet se çdo regjistrim mbahet në cdo 10 vjetë. Ky është minimumi i regjistrimit të popullsis në vend. Po ja që kaluan gati 20 vjetë, pa mos u zhvilluar asnjë regjistrim. Përndryshe, regjistrimet kanë rëndësi të madhe për një vend. Regjistrimet kanë rëndësi edhe për zhvillimin – planifikimin e të mirave materiale, si dhe politike në përgjithësi.

Flitet se regjistrimi i vitit 2020 do të dallohet nga regjistrimet e kaluara. Pos, regjistrimit në teren do të shfrytëzohen edhe të dhëna tjera si të regjistrimit të nënshtetësis, librit të amzës, etj. Si risi në këtë regjistrim do të jetë, se nuk do ketë graf për etnitete dhe se të gjithë do të regjistrohen si qytetarë dhe me këtë do të jenë shtet qytetar. Pra, nuk do të theksohet as numri dhe as përqindja e etnitetëve.

Në të gjithë regjistrimet e deritanishme kanë qenë të theksuar

edhe etnitetet, si dhe përqindja e etnitetëve. Këtë e theksoi edhe Z. Zaev si dhe drejtatori i ESHS. Bile u tërhiqet vërejtja edhe partive politike që mos të përzihen në regjistrim. Të hedhim një sy se si zhvillohen këta regjistrime në vende tjera të Evropës, po edhe botës.

Në Zvicrën shumëkombëtare, kështu janë të paraqituranumri dhe përqindja kombëtare. Në Zvicër popullsis autoktone u takojn katër grupe gjuhësore, si: gjermane 61.7%, franceze 19.2%, italian 7.6%, retoroman 0.6% ("Derzhava Sveta", botimi i tret, Zagreb 2005 f.188 -189). Si rast tjetër, do ta marrim Belgjikën ku jetojnë: flaman 58%, valon 33%, si dhe gjerman 66.000, ose 0.6%. Në Amerikën Veriore, do ta theksojm Kanadën, e cila e banuar është me anglez dhe francez. Përndryshe, në Kanada jetojnë 9.970.610 banor. Pjesën më të madhe të popullsis e përbëjnë anglezët dhe francezët. Sipas strukturës kombëtare, gjendja është siç vijon: sipas gjuhëve që flasin, anglez ka 59%, dhe asaj franceze 23%. Sipas regjistrimit të popullsis që u bë në vitin 1996 si gjuhë antare u vënda edhe gjuha hinduse dhe eskiyeze (186.000), kineze (716.000), italiane (485.000), gjermane (450.000), etj. Po aty f.531. E till është gje dja edhe ne shtetet tjera të botës. Marë më përgjithësi, e pamundur është të theksohet popullsia, pa mosnu përmendur me të edhe përqindja e popullsis.

Të theksojm se popullsia ndërthet në vete edhe struktura tjera të popullsis, si:

1. Strukturën kombëtare
2. Strukturën sipas gjinis

3. Strukturën sipas arsimimit
4. Strukturën sipas inkuadrimit
5. Strukturën sipas profesionit
6. Strukturën sipas grup-moshës
7. Strukturën sipas konfeksionit
8. Strukturën sipas: natalitetit, mortalitetit, shtimit natyror etj.

Pa mos e theksuar numrin dhe përqindjen e strukturave që theksuam më lartë, këto struktura do të jenë jo të plota dhe të pa kuptimta. Se numri me këtë edhe përqindja e strukturave të theksuara më lartë, nuk kanë të bëjnë fare me politikën. Statistika nuk është politike, por ajo është shkencë e cilën merret statistika dhe antropogjeografia. Politikanët, janë ata që i japin ngjyrë politike.

Të flasim për popullsinë dhe të mos theksohet numri, kjo është e pakapshme për logjikën e njeriut. Si mund të flasim për strukturën, sipas inkuadrimit, pa mos e theksuar edhe numrin me të dhe përqindjen e etnitetëve. Në këtë rast nuk do të theksohet se prej 500 policëve janë pranuar vetëm 7 shqiptarë, ose prej 200 policëve nuk është pranuar asnjë shqiptar. A nuk do të jetë kjo një shprehje në të dhënat e parashtrura. Ky nuk është regjistrim dhe me këtë kanë shkelur komventën ndërkombëtare, ku ndër të tjera parashihen edhe të inkuadruarit e etnitetëve të atij shteti, apo qëllimisht i ket te dhënës, sipas struktues kombëtare. Dhe pa këtë do te themi janë pranuar 500 qytetarë policë, janë pranuar vetëm 7 shqiptarë, ose vetëm 1,4% dhe në ata 200 policë nuk është pranuar asnjë shqiptar ose 0.0%. Nuk do të dihet as numri dhe as përqindja e etnitetëve tjera që jetojnë në Maqedoni.

**Gjatë regjistrimeve të zhvilluara deri më sot, dukshëm është manipuluar me numrin e etnitetëve, me theks të veçant me numrin e shqiptarëve. Gjithë është tentuar që numrin e shqiptarëve ta zvoglojnë dhe të maqedonaseve ta rrisin, në mënyre që të jenë shumicë absolute.**



Gjatë regjistrimeve të zhvilluara deri më sot, thënë më qartë, dukshëm është manipuluar me numrin e etnitetëve, me theks të veçant me numrin e shqiptarëve. Gjithë është tentuar që numrin e shqiptarëve ta zvoglojnë dhe të maqedonaseve ta rrisin, në mënyre që të jenë shumicë absolute. Për një manipulim të thënë ka një morrit të dhënash, por po i theksojmë disa prej tyre: Sipas të dhënave zyrtare te vitit 2002, gjendja e popullsis, sipas kombësive është si vijon:

(Gjithësej numrin i popullsis në përqindje):

-Gjithësej	: 2,022,547	100%
-Maqedon	: 1,297,971	64,2%
-Shqipëtar	: 509,083	25,5%
-Turq	: 77,959	23,9%
-Rom	: 53,879	2,7%
-Serb	: 35,939	1,8%
-Boshnjak	: 17,018	0,8%
-Vlleh	: 9,695	0,5%
-Të tjerë	: 20,993	1,0%

Se këto të dhëna nuk janë të realta, doti demontojm me të dhënat e BBC – së. Nga kjo e dhënë do të shihet se me të dhenat e etnitetëve dukshëm është manipuluar. Ja se si duken te dhenat e BBC- se:

ETNITET	NUMRI	PERQINDJA
Maqedon	920,000	40,0
Shqipëtar	880,000	38,3
Rom	220,000	9,6
Serb	160,000	7,0
Turq	60.000	2,6
Të tjerë	60,000	2,6
Gjithësej	22,300,000	100%

Ndërkaq CIA e Amerikës vërtetonë se në Maqedoni, jetojnë afër 1 milion shqiptarë. Këta të dhëna theksova se mos të thuhet së janë të dhëna "QARSHIE", apo kuluarëve. Ka më shumë të dhëna tjera që demantojnë të dhënat zyrtare. Mu për atë pritet një regjistrim më i realt, ku do të dihet saktësisht, se sa janë të dhënat e realta, për numrin e popullsis Maqedonis, sipas strukturave kombëtare.

Për ndryshe në qoftë se vazhdon me avazin e vjetër nuk kemi bërë asgjë. Me rëndësi është të theksojmë se deri më tash, nuk ka patur graf të vecantë për etnitetin bullgar. Gjatë vizitës të një burr shteti bullgar në Maqedoni, ai do të deklaronte: Tashmë është e ditur se në Maqedoni jetojnë 200,000 bullgar. Duke i marr parasysh të gjitha këta të dhëna që i theksuam më lartë, mund të themi se harata demografike e Maqedonis, sipas këtij regjistrimi dukshëm do të ndryshojë. Kuptohet në qoftë se do të bëhet një regjistrim i realt...

## Fernandinjo kërcënohet me vdekje

Mesfushori i kombëtares së Brazilit, Fernandinjo si dhe familjarët e tij, kanë rënë pre e fyerjeve raciste dhe kërcënimeve pas autogolit që lojtari shkaktoi në ndeshjen çerekfinale të Kupës së Botës ndaj Belgjikës. Në atë sfidë Brazili u mund 2-1 dhe u eliminua nga Botërori, por autogoli ka lënë pasojë te futbollisti që luan me Manchester Sitin, duke e quajtur "majmun", ndërsa në disa raste nuk kanë munguar kërcënimet me vdekje. Të kërcënuar janë edhe familjarët e tij në Brazil e Angli, pasi bashkëshortja e tij Rosa Glauca është fyer në faqen e saj zyrtare "Instagram", madje edhe është kërcënuar. Kjo situatë është përsëritur edhe me nënën e Fernandinjo, që është detyruar të mbyllë faqen e saj zyrtare për shkak të komenteve raciste. Policia braziliane ka nisur një hetim pasi ka qenë vetë futbollisti që ka kërkuar ndihmën e forcave të rëndit për të evituar probleme të mëtejshme.



## Duam finalen për të bërë anglezët krenarë

Harry Kin nuk arriti të shënojë në sfidën ndaj Suedisë, por bëri një punë të jashtëzakonshme në shërbim të skuadrës. Kapiteni i "tre luanëve" nisje më mbrapa, duke tërhequr Granqvist nga mbrojtja suedeze dhe duke ndihmuar Sterling të gjejë hapësira në thellësi. Në përfundim të sfidës Kin vlerësoi paraqitjen e skuadrës deri në këtë pikë, ndërsa nuk e fshehu se e mendojnë shpesh edhe finalen. "Jemi një grup djemsh që kemi ardhur këtu për të luajtur me krenari dhe për të bërë të lumtur një popull të tërë. Grupi është sekret i suksesit tonë dhe besoj shumë se do të mbërrijmë në finale", deklaroi Kin. Sulmuesi i Totenhemit mban shiritin e kapitenit të përfaqësuesja e drejtuar nga Gareth Sautgejt dhe deri tani është gola-shënuesi më i mirë i Botërorit, me 6 gola. Ndërkohë, kur jemi te gara për golshënuesin më të mirë edhe ndjekësi i tij më i afërt i Kin, Romelu Lukaku, nuk e gjeti rrjetën në fitoren e Belgjikës ndaj Brazilit, duke mbetur në kuotën e katër golave. Nuk mund të përjashtohen përfundimisht nga gara francezët Grizmann dhe Mbappe, që kanë realizuar nga 3 gola secili, ndërsa për Modriç, Hazard apo Stones, që e kanë gjetur nga 2 herë rrugën e rrjetës, mundësia për të shënuar 4 apo më shumë gola në dy takimet e mbetura, është një mision i pamundur. Duket qartë që për "Këpucë e Artë" do të duheshin Harri Kin dhe Romelu Lukaku, dy sulmues shumë të rëndësishëm të Premier Ligë, që do të mund të përplasen me njëri-tjetrin në fushën e blertë vetëm në takimin e fundit.

"Jemi në gjysmëfinale dhe po shijojmë këtë fitore, ashtu sikurse shijojmë edhe kualifikimin mes 4 skuadrave më të mira në botë. Kemi kohë mjaftueshëm për t'u përgatitur ndaj Anglisë, do të jetë një tjetër sfidë e vështirë për t'u përballuar", ka thënë pas fitores ndaj Rusisë mesfushori kroat Modriç

Kroacia ia ka dalë për herë të dytë në histori, që të mbërrijë mes 4 skuadrave më të mira, teksa siguroi gjysmëfinalen falë triumfit me 11-metërsha përballë Rusisë organizatore të Kupës së Botës. 120 minutat përfunduan në barazim 2-2, ndërsa penalltitë u buzëqeshën edhe njëherë kroatëve, që arritën të realizojnë 4 herë, kundrejt 3 të rusëve. Vendi organizator i jep fund kështu aventurës në këtë Kupë Bote, ndërsa ajo që do të mbahet mend për ta, është vetëm eliminimi i Spanjës në fazën e 1/8-ave. Pas përfundimit të ndeshjes festa tek futbollistët kroat ka qenë e madhe, ndërsa emocionet e këtij sukcesi të madh i rrëfeu kapiteni Luka Modriç. "Për ne ishte një tjetër ndeshje me shumë emocione, me intensitet të lartë. Nuk ishte e lehtë, pasi luanim kundër vendit



## DUAM TË SHKRUAJMË HISTORINË

### KITAROVIÇ FESTON ME FUTBOLLISTËT NË DHOMAT E ZHVESHJES

Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar Kitaroviç, është shndërruar në një tifoze ultrase e përfaqësueses së saj në "Rusi 2018". Gjatë takimit çerekfinal ndaj Rusisë, Kitaroviç u shfaq në krah të kryeministrit rus Medvedev, me të



cilin shkëmbeu urime për çdo gol të shënuar nga skuadrat respektive, ndërsa pas kualifikimit të Kroacisë me 11-metërsha, Kitaroviç shkopi të festonte në dhomat e zhveshjes bashkë me tifozët.

organizator dhe presioni ishte i madh, por ia dolëm mbanë", u shpreh Luka Modriç, kapiteni i kombëtares kroate, gjysmëfinaliste e Kupës së Botës "Rusi 2018". Më tej, lojtari i Real Madridit tha: "Nuk luajtëm mirë, ashtu sikurse kishim parashikuar, sidomos në pjesën e parë, por në 45 minutat e dyta ritmi ynë ishte më i lartë, duke treguar karakter dhe e kontrolluam lojën", shtoi më tej ai. Modriç dhe Kroacia e tij përsëritën, të paktën deri më tani, suksesin e 20 viteve më parë, duke konfirmuar se një tjetër brez i artë ka ardhur. "Jemi në gjysmëfinale dhe po shijojmë këtë fitore, ashtu sikurse shijojmë edhe kualifikimin mes 4 skuadrave më të mira në

botë. Kemi kohë mjaftueshëm për t'u përgatitur ndaj Anglisë, do të jetë një tjetër sfidë e vështirë për t'u përballuar", ka deklaruar pas fitores me penallti ndaj Rusisë mesfushori kroat Modriç.

Ndërkohë, në gjysmëfinale, që do të luhet 11 korrikun e ardhshëm në orën 20:00, kroatët do të përballen me Anglinë.

## Bëmë mrekullinë, tani na duan në të gjithë Rusinë

Trajneri i kombëtares ruse të futbollit Stanislav Çerçesov ka bërë që zemrat e miliona rusëve të jenë në ankth deri në momentin e fundit të çerekfinaleve, teksa penalltitë nxorën jashtë Botërorit vendin organizator, që u eliminua nga Kroacia. "Para fillimit të turneut jemi kritikuar nga të gjithë. Por më besoni, u rritëm gjatë turneut, besuam te forcat tona dhe tani i gjithë vendi na do. Ne realizuam diçka të jashtëzakonshme dhe më pak fat mund



të kishim shkuar më tej", tha Çerçesov. "Patëm shumë besim te

puna jonë, te grupi që kemi krijuar dhe mund të tregojmë

këto vlera edhe në të ardhmen. E gjithë Rusia është e dashuruar me ne dhe ju premtojmë se do të vazhdojmë në këtë rrugë edhe në të ardhmen. Falënderoj të gjithë skuadrën për atë që dha në fushë, të gjithë fansat që ashtu si ne janë të mërzhitur sot, por që përgjatë këtij Botërori na kanë qëndruar pranë", u shpreh Stanislav Çerçesov, që shpresei se ndaj Kroacisë do të përsëriste mrekullinë që bëri edhe ndaj Spanjës, kur pat fituar me penallti.



## E vështirë të kthehem të luaj pas asaj që ndodhi

Eliminimi i Brazilit nga Kupa e Botës "Rusi 2018" ka zhgënjyer të gjithë fansat e kombëtares "Selecao", që edhe pse ishte favoritja kryesore për ta fituar këtë eveniment, tashmë do ta shohë pjesën e mbetur të Botërorit nga shtëpia. Protagonisti më i shumëpritur i këtij ekipi ishte sulmuesi Nejmar, që më shumë se për go-

lat e realizuara do të mbahet mend për skenat e tij në fushën e lojës, ku rrëzohej thuasje pas çdo kontakti. Në një postim në faqen e tij zyrtare "Instagram", sulmuesi i PSZH-së shprehet: "Mund të them se ky është momenti më i trishtueshëm i karrierës time. Dhimbja pas eliminimit është shumë e madhe, pasi ne e dimë

se i kishim të gjitha mundësitë për t'u kualifikuar dhe për të shkuar më tej, për të bërë historinë. Por nuk ishte dita jonë. Është e vështirë të gesh forcën për të luajtur sërish futboll, por e di që Zoti do të më ndihmojë të jem sërish i fortë për t'u përballur sërish me këdo", tha Nejmar. Më tej, sulmuesi brazilian shton: "Dua të

falënderoj Zotin edhe pse u mundëm, pasi e di që rruga jote është shumë herë më e mirë se e imja. Jam i lumtur që isha pjesë e kombëtares së Brazilit, jam krenar për gjithçka bëmë në Botëror. E lamë në mes ëndrrën tonë, por ajo ëndërr nuk është shuar as nga mendja dhe as nga zemra jonë", deklaroi Nejmar.

I FYER DHE KEQTRAJTUAR, BABAI KËSHILLON OZILIN

## LARGOHU NGA KOMBËTARJA



### Vida rrezikon përjashtimin, këndoji himn kundër Rusisë

Domagoj Vida u shndërrua hero me golin ndaj Rusisë në kohën shtesë ndaj Rusisë. Por, në përfundim të ndeshjes mbrojtësi i Beshiktashit ia dedikoi fitoren ndaj Rusisë një shteti që ka probleme politike me këta të fundit, Ukrainës, për këtë ai rrezikon të përjashtohet për ndeshjet e ardhshme. Vida ka postuar një video në "Youtube", ku së bashku me agjentin kroat Ognjen Vukojeviç lëshojnë thirrje "Lavdi për Ukrainën", ky është një himn që këndohet nga ushtarët ukrainas dhe çështja nacionaliste e Ukrainës që është kundër pretendimeve territoriale ruse në vend. Vukojeviç, i cili ka luajtur 55 ndeshje si mesfushor shkatërrues me Kroacinë lëshoi deklaratën në video: "Kjo fitore është për Dinamo Kievin dhe Ukrainën".

Videoja ka shkaktuar zemërim në Rusi, me rrjetet televizive që tregojnë fotot e ngjarjes në fjalë dhe janë dukshëm të inatosur. Mediat në Angli raportojnë se FIFA ka nisur një hetim pas publikimit të pamjeve. "FIFA po përpunon raporte të ndryshme të ndeshjes në fjalë, si dhe dëshmi të mundshme në lidhje me çështjen e përmendur", ka thënë një zyrtar i FIFA për "Sun Sport". Në rast se Vida shpallet fajtor, sipas kodit disiplinor të FIFA-, neni 54 thotë: "Kushdo që provokon publikun e gjerë gjatë një ndeshjeje do të pezullohet për dy ndeshje dhe do të sanksionohet me një gjobë minimale prej 5,000 franga". Për vetë rastin në fjalë ka reaguar edhe vetë lojtari, i cili tha: "Kjo fitore është për Kroacinë. Nuk ka vend për politikë. Kjo është një shaka. Kam miq që kur isha te Dinamo Kiev, nuk kisha ndërmend gjë tjetër në ato fjalë", ka shpjeguar më tej mbrojtësi.



Mesfushori i Arsenal, Mesut Ozil ka mbetur i zhgënjyer dhe i fyer nga trajtimi që i kanë bërë këtë verë në kombëtaren e Gjermanisë, lajm që konfirmohet nga babai i tij, Mustafa Ozil. Madje ky i fundit shprehet se i ka këshilluar djalin të tij që të mos luajë më me kombëtaren e Gjermanisë në të ardhmen. Kritikat karshi Mesut Ozil kanë ardhur para fillimit të Botërorit,

kur ai dhe shoku i tij i kombëtares Olkaj Gundogan takuan presidentin e Turqisë, Taip Erdogan, për shkak të origjinës së tyre, duke i dhuruar edhe një fanellë. Jo vetëm kaq, por edhe fansat e Gjermanisë e kanë ofenduar para miqësorës që Gjermania humbi me Austrinë para Botërorit. "Nëse do të isha në vendin e tij, do të thosha "mjaft më". Mesut është fyer dhe

zhgënjyer para Botërorit, në ndeshjen miqësore ndaj Austrisë. Askush nuk i doli në mbrojtje edhe pse ka 9 vjet që luan me fanellën e Gjermanisë. Njerëzit gjithnjë shprehen se nëse Gjermania fiton kjo është meritë e grupit, por nëse humbet kjo ndodh për faj të Ozil. Kjo është e turpshme", u shpreh Mustafa Ozil. "Mesut ka qenë një shembull gjatë gjithë këtyre viteve,

"Nëse do të isha në vendin e tij, do të thosha "mjaft më". Mesut është fyer dhe zhgënjyer para Botërorit, në ndeshjen miqësore ndaj Austrisë. Askush nuk i doli në mbrojtje edhe pse ka 9 vjet që luan me fanellën e Gjermanisë. Njerëzit gjithnjë shprehen se nëse Gjermania fiton kjo është meritë e grupit, por nëse humbet kjo ndodh për faj të Ozil. Kjo është e turpshme", u shpreh Mustafa

ndaj po krijohet një situatë absurd. Ai e do Gjermaninë dhe e ka treguar gjithnjë këtë gjë, ndaj nuk është e ndershme ky trajtim që po i bëhet. Nuk është hera e parë që Mesut del në fotografi me Erdogan, por politika nuk ka përse të përzihet në çështjet private të lojtarit. Ne nuk jemi marrë asnjëherë me politikë, Mesut është një sportist dhe futbollit nuk ka të bëjë me politikë", tha Mustafa Ozil, që këshilloi djalin 29-vjeçar të mos luajë më me kombëtaren gjermane.

### Grabitet komentatori i BBC-së në Moskë



Ka rezultuar një aventurë jo shumë e mirë prania e një komentatori britanik të BBC në Moskë.

Në fillim u drogua dhe më pas u grabit nga taksisti. Për momentin ende nuk bëhet publik emri i tij,

por gjithçka ka ndodhur pasi ka kërkuar një taksist nga qendra e Moskës, pikërisht pranë teatrit "Bolshoi". Aty, shoferi i ka ofruar një filxhan kafe. "Pasi ka pirë kafënë shtetasi britanik është zgjuar disa orë më vonë në periferi, pa celularin e tij dhe pa kartat e portofolinit", shkruan një burim nga policia vendase për agjencinë Interfax". Më vonë është mësuar se nga karta e tij janë shpenzuar 500 sterlina, ndërkohë që shuma e të gjithë grabitjes shkon deri në 1000 sterlina.



### Benitez, kandidat për stolin e kombëtares së Spanjës

Trajneri i Njukasëll në Premier Ligë, Rafa Benitez, mund të jetë trajneri i ardhshëm i kombëtares së Spanjës në futboll. Sipas mediave britanike, trajneri 58-vjeçar është i pari në listën e kandidatëve për të zëvendësuar Fernando Hierro në stolin e Spanjës, ndërkohë që 48 orë para fillimit të Botërorit "Rusi 2018" u shkarkua trajneri Julien Lopetegui, që firmosi me Real Madrid. Hierro zuri përkohësisht vendin e Lopetegui, por duket se nuk shkëlqeu në këtë detyrë, pasi Spanja u eliminua menjëherë pas fazës së grupeve në Botëror, ndaj iberikët po mendojnë të sjellin një trajner me përvojë. Njukasëll ende nuk ka rinovuar kontratën me Rafa Benitez (skadon në verë të 2019-ës), që kërkon më shumë siguri dhe një merkato të fortë, por këto duken të vështira për t'u realizuar. Ai ka përvojë të madhe në arenën ndërkombëtare, ka drejtuar skuadra më të mëdha në Evropë dhe mund të jetë kandidati i duhur për stolin e Spanjës. Për stolin e Spanjës përfillet se mund të jetë kandidat edhe Luis Enrique, por duket se ish-trajneri i Barcelonës preferon një skuadër klubi.

### FIFA FTESË FEDERATËS SË TAJLANDËS

### Shpëtoni fëmijët, të shohin finalen në "Luzhniki"!

FIFA merr një vendim të rëndësishëm simbolik në kuadër të përpjekjeve për të shpëtuar futbollistët e një skuadre të rinjsh në Tajlandë, që bashkë me trajnerin është bllokuar në një shpellë, si rrjedhojë e shirave të rrëmbyeshëm që kanë bllokuar daljen. Qeveria e futbollit botëror i ka dërguar një letër Federatës së Futbollit të Tajlandës në të cilën shpreh keqardhje të thellë dhe mbështetje për familjet e futbollistëve të rinj dhe trajnerit të tyre të cilët janë bllokuar në veri të vendit. Në letrën me nënshkrimin e presidentit Xhanni Infantino shkruhet se FIFA dëshiron t'i ftojë fëmijët dhe trajnerin e tyre në finalen e Botërorit në Rusi, nëse shpëtohen deri në



atë ditë. Më tej shtohet se prania e fëmijëve dhe trajnerit në finale "pa dyshim do të jetë një moment fantastik i bashkimit dhe festimit". Fëmijët, të cilët u bllokuan në shpellën e përmytur nga 23 qershori,

kanë kërkuar nga pjesëtarët e ekipit të shpëtimit, të cilët kujdesen për ta, që t'i informojnë për zhvillimet në Botëror. Finalja e Botërorit do të luhet më 15 korrik në stadiumin "Luzhniki" të Moskës.



## Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

### Institucioni publik për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir

IPSHFFV Manastir  
nr. \_\_\_\_\_  
rr. "Mladinski Brigadi" nr. 2  
7000 Manastir  
Republika e Maqedonisë  
Tel dhe Faks: 047/253-339  
047/254-339  
e-mail: judomzadocinija@yahoo.com  
juddmd-bt@mtsp.gov.mk

Në bazë të nenit 20-g paragrafi 1 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/2016 dhe 35/18), Rregullores për elementet e domosdoshme të shpalljeve publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe të fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së Regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna jo të vërteta gjatë punësimit në sektorin publik nr. 34/15, Planit vjetor për punësim për vitin 2018 nr. 01-264/6 të datës 18.09.2017, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IP Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir nr. 01-324/1 të datës 18.05.2015, nr. 01-678/2 të datës 27.10.2015, nr. 01-1/1 të datës 02.01.2018, 01-234/2 të datës 02.04.2018 dhe 01-328/2 të datës 04.06.2018 dhe pëlqimeve për punësim nr. 18-1396/2 të datës 20.02.2018, nr. 18-1396/4 të datës 20.05.2018 dhe nr. 18-6369/2 të datës 12.06.2018 nga Ministria e financave IP Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 01/2018

##### Për punësim për kohë të pacaktuar të 6 (gjashtë) realizues

Institucioni Publik Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar të 6 (gjashtë) realizuesve në vendet e punës në vijim:

1. Një realizues në vendin e punës **Psikolog – person për preventivë dhe menaxhim me gjendje krize**, titulli i vendit të punës Nëpunës profesional në IMS me shifër të vendit të punës SOZ0303A06003 në Shërbimin për veprimtari sociale, edukativo-pedagogjike dhe psikologjike.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 – Psikologji, pa ose me së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Neto pagesa prej 23.197,00 denarë. Orari i punës prej ora 7.30 deri në ora 15.30 (e hënë – e premte), 40 orë gjatë një jave.

2. Një realizues në vendin e punës **Punëtor i diplomuar social**, titulli i vendit të punës Nëpunës profesional në IMS me shifër të vendit të punës SOZ0303A06001 në Shërbimin për veprimtari sociale, edukativo-pedagogjike dhe psikologjike.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 – Punë sociale dhe politikë sociale, pa ose me së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Neto pagesa prej 23.197,00 denarë. Orari i punës prej ora 7.30 deri në ora 15.30 (e hënë – e premte), 40 orë gjatë një jave.

3. Një realizues në vendin e punës **Defektolog**, titulli i vendit të punës Nëpunës profesional në IMS me shifër të vendit të punës SOZ0303A06008 në Shërbimin për akomodim, trajtim, ushqim dhe mbrojtje shëndetësore për shfrytëzuesit.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 – Defektologji, pa ose me së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Neto pagesa prej 23.197,00 denarë. Orari i punës prej ora 7.30 deri në ora 15.30 (e hënë – e premte), 40 orë gjatë një jave.

4. Dy realizues në vendin e punës **Motër medicinale**, titulli i vendit të punës Nëpunës ndihmës-profesional të nivelit të dytë me shifër të vendit të punës SOZ0303B02002 në Shërbimin për akomodim, trajtim, ushqim dhe mbrojtje shëndetësore për shfrytëzuesit.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtin e posaçme në vijim:

- Arsim të mesëm profesional – shkencat mjekësore

Neto pagesa prej 14.643,00 denarë. Orari i punës gjatë javës është me tre ndërrime edhe atë: ora 7.00- 14.00, ora 12.00-19.00 dhe ora 19.00-7.00, 40 orë gjatë një jave.

5. Një realizues në vendin e punës **Mirëmbajtës të higjienës III**, titulli i vendit të punës Nëpunës ndihmës-teknik (për mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve) të nivelit të tretë me shifër të vendit të punës SOZ0401A03004 në Shërbimin për punë administrative dhe ndihmës-teknike, Seksioni punë ndihmëse-teknike.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtin e posaçme në vijim:

- arsim fillor

Neto pagesa prej 12.008,00 denarë. Orari i punës gjatë javës është me dy ndërrime edhe atë: ora 7.00-15.00 dhe ora 12.00-20.00, 40 orë gjatë një jave.

Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim të institucionit për vitin 2018, punësimet janë paraparë për: maqedonas/e 6.

Kandidatët duhet të parashtrojnë:

- Fletëparaqitje që duhet të përmbajë: të dhëna për kandidatin (emër dhe mbiemër, numër amë të qytetarit, datën dhe vendin e lindjes, adresa dhe vendi i banimit, adresa elektronike e kandidatit, kontakt telefoni, përkatësi etnike), si dhe letër të shkurtër motivimi; biografi të shkurtër; deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme për vendin e punës me shënimin e PO/JO për secilin kusht veç e ve; deklaratë për përmbushje të kushteve të posaçme për vendin e punës me shënimin e PO/JO për secilin kusht veç e ve;
- certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- vërtetim nga mjeku amë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- dëshmi për arsimin e mbaruar;
- vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (nëse kërkohet për vendin e punës).

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentacionin shoqëruar si dëshmi për përmbushje të kushteve për punësim (në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter) është 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet të përmbushin në momentin e paraqitjes.

Kandidatët e interesuar, fletëparaqitjen me dokumentacionin shoqëruar duhet ta parashtrojnë në formë letre në arkivin e IP Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir ose përmes postës në adresën: Institucioni Publik Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir në rr. "Mladinski Brigadi" nr. 2, Manastir. Kandidatët obligohen që në zarf të shënojnë numrin rendor të vendit të punës për të cilin aplikojnë, me vërejtje: "Mos hap".

Dokumentacioni i parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohet. Nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Procedura për përzgjedhje do të realizohet në dy faza edhe atë:

- kontrollim të fletëparaqitjeve dhe dëshmiave dhe
- intervistë.

Institucioni Publik  
Shtëpia për foshnje dhe fëmijë të vegjël – Manastir  
UD Drejtor  
Sonja Iljevskva

Në bazë të nenit 101 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), nenit 15 të Statutit të IP Qendra për punë sociale Resnjë nr. 01-325/1 të datës 24.06.2015 dhe Vendimit nr. 01-288/1 të datës 06.07.2018, Këshilli drejtues i IP QPS Resnjë publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE nr. 04-289/1

##### Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra për punë sociale Resnjë

- Kandidatët e interesuar krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
  - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
  - Te kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla e VII/1 e përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, të profileve arsimore në vijim: punëtor i diplomuar social, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog;
  - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - Të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune pas diplomimit;
  - Të parashtrojnë program të përgatitur për udhëheqje të institucionit.
  - Posedim të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
    - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
    - IELTS – së paku 6 pikë,
    - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
    - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
    - BULATS – së paku 60 pikë ose
    - APTIS – së paku niveli B2

VËREJTJE: Kandidati i cili do të zgjidhet për Drejtor deri më 01.09.2018 obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

Drejtori i cili nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati.

Neto pagesa është 26.900,00 denarë.

- Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpallje duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
  - Certifikatë të shtetësisë;
  - Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës sipëror – certifikatë ose diplomë;
  - Certifikatë/Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - Vërtetim për përvojë të punës pas diplomimit;
  - Program për udhëheqje të Institucionit.
  - Posedim të certifikatës përkatëse të pranuar ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se 5 vjet, me vërejtje: Kandidati i cili do të zgjidhet për Drejtor deri më 01.09.2018 obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

Drejtori i cili nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati.

- Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.
- Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh.
- Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin IP QPS Resnjë ose përmes postës në adresën: IP Qendra për punë sociale Resnjë, me seli në rr. "Leninova" nr. 66A Resnjë.

Këshilli drejtues i IP Qendra për punë sociale Resnjë

Në bazë të nenit 101 të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), nenit 22 paragrafi 1.2 të Ligjit të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16), UD Drejtor i IP Qendra për punë sociale Resnjë publikon:

#### Shpallje publike nr. 04-290/1

Për punësim të 3 (tre) realizues për kohë të pacaktuar në IP Qendra për punë sociale Resnjë IP Qendra për punë sociale Resnjë publikon shpallje për punësim të 3 (tre) realizues për kohë të pacaktuar në vendet e punës në vijim:

1. **Punëtor i diplomuar social** – nëpunës profesional i nivelit të gjashtë edhe atë 2 (dy) realizues.

Kandidatët e interesuar krahas kushteve të përcaktuara me ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla e VII / 1 e arsimit të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik – drejtimi punë sociale dhe politikë sociale;
- Me ose pa përvojë pune;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Të jenë shtetas të RM;
- Të kenë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Orari javor i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, orët e punës – 40.

Neto pagesa - 22.500 denarë.

Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi për arsim të mbaruar sipëror – certifikatë ose diplomë;
- Certifikatë se nuk është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë e mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për themelimin të marrëdhënies së punës;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;

2. **Mirëmbajtës të higjienës** – person ndihmës teknik (për mirëmbajtje të objekteve) të nivelit të tretë – 1 (një) realizues.

Kandidatët e interesuar krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të kenë të mbaruar arsimin fillor;
- Të jenë shtetas të RM;
- Me ose pa përvojë pune;
- Të kenë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Orari javor i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, orët e punës – 40.

Neto pagesa - 11.000 denarë.

Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi për arsim të mbaruar fillor;
- Certifikatë se nuk është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë e mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për themelimin të marrëdhënies së punës;

Dokumentet duhet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme gjegjësisht shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Zgjedhja do të realizohet brenda afatit ligjor pas përzgjedhjes së realizuar.

Dokumentet e parashtruar pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ta parashtrojnë në adresën në vijim: IP Qendra për punë sociale Resnjë rr. "Leninova" nr. 66A Resnjë (me shenjë për Shpallje publike). Kontakt telefoni 047/452-552. IP Qendra për punë sociale Resnjë.

UMBIAJTTURNIRI "KARATE1 YOUTH LEAGUE" NË UMAG TË KROACISË

## ABDURAHIMI FITON MEDALJEN E ARIT, OSMANI TË BRONZTËN

Dy karateistët shqiptar në këtë turnir të fuqishëm treguan cilësi në të gjitha luftërat dhe me plot meritë arritën të fitojnë medaljen e arit, respektivisht të bronzit

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 8 korrik - Javën e kaluar në Umag të Kroacisë, u zhvillua turniri i njohur botëror "Karate 1 Youth League", ndërsa mori pjesë edhe Klubi i Karatesë "Fati" edhe atë me dy garues, Adrijan Mahmudi (-67 kg) dhe Doan Osmani (75 kg) si dhe Abdurahim Idrizi (-55kg) nga radhët e KK "Makpetrol". Përkishtë Idrizi arriti suksesin më të madh, duke e fituar medaljen e arit. Karateisti shkupjan në finale arriti të mund karateistin nga Rusia Maksim Krasnov me 7-2. Para se të arrijn deri te ky sukses i madh, Idrizi arriti katër fitore, Luka Toma nga Gjermania, Mirnes Agović nga BeH, Maksim

Padolskin nga Bjellorusia dhe Nikita Filipov nga Ukraina. Ndryshe, suksesin e radhës në këtë turnir të fuqishëm e arriti karateisti i KK "Fati", Doan Osmani, i cili arriti që të plasohet në vendin e tretë dhe të fitojë medaljen e bronzit, duke treguar cilësi në të gjitha luftërat, gjithsej katër. Ndeshjen e parë e fitoi ndaj garuesit nga Zvicra me rezultatin 7-0, të dytën me 4-3 munda karateistin rus, kurse në të tretën humbi pas një pakujdesie nga garuesi boshnjak me 1-3. Në repasazh Osmani arriti të fitojë garuesin nga Skocia me 2-0, derisa për vendin e tretë u ndesh me karateistin serb, të cilin e mundi me rezultatin minimal 1-0. Pas këtij suksesi, për ga-

zetën KOHA, ka folur vetë Doan Osmani. Ai thotë se në këtë turnir është nisur që të fitojë medaljen e arit, por në fund është dashur të pajtohet me medaljen e bronzit. "Sa i përket rezultatit, në këtë garë jam nisur për të rrëmbyer vetëm vendin e parë, por fatkeqësisht nga disa gabime nuk arrita të shkoj deri në finale, por përsëri pa medalje nuk u ktheva", pohon Osmani. Rrugëtimi deri te ky sukses, Osmani thotë se nuk ka qenë i lehtë dhe se çdo luftë ka pasur vlerën dhe rëndësinë e vet. "Çdo luftë e ka vlerën dhe rëndësinë e vet dhe normal jo çdo garues apo kundërshtar nuk është i njëjtë, poashtu dallon edhe taktika e sistemit i luftës. Nga luftërat që i kisha, do



ta kisha veçuar luftën e dytë kundër kundërshtarit rus, për arsye se para pesë muajve, i njëjti më mundi në Kampionatin Evropian në Soçi të Rusisë, kështu që kjo ishte një hakmarrje për atë disfatë e cila sinqerisht nuk ka qenë e real duke marr parasysh se ai u ndihmua nga referët", vazhdoi më tej Doani. Pas këtij suksesi, karateisti i KK "Fati",

do të përgatitet për kampionatin shtetëror për senior. "Pas këtij turniri, në muajin shtator më pret Kampionati shtetëror për senior dhe e kam patjetër të dal kampion për të siguruar Kampionatin Botëror në Madrid", përfundoi Osmani, i cili për suksesin e fundit falënderoi edhe trajnerin e KK "Fati" Arlind Huseini.



### BOKSI NËZI

#### Përplasja fatale i merr jetën shqiptarit

Një ngjarje e rëndë të dielën ka ndodhur në Kroaci, ku bokseri shqiptar është përfshirë në një aksident me pasojë vdekjen e tij. Bëhet fjalë për Valentin Kajtazin, i cili kishte kohë që stërvitej me klubin e tij në Kroaci. Ai kishte një eksperiencë 27-vjeçare në këtë sport. Ende nuk ka detaje për ngjarjen e rëndë, ku mbet i vdekur bokseri Kajtazi. Lajmi është bërë i ditur nga vetë klubi, i cili ka njoftuar ngjarjen e trishtuar përmes një deklarate të trajnerit të klubit ku stërvitej. "Çfarë të themi, kur në këtë mëngjes morëm lajmin e trishtuar, të gjithë në klub jemi në gjendje shoku. Valentini ishte shembull, ai ishte fillestar por në sajë të këmbënguljes së tij ai u bë një konkurrent dhe luftoi më së miri. Ky lajm na ka goditur. Valentini ishte djalë i mirë, pozitiv dhe shumë i vlefshëm, e pabesueshme që ka ikur", tha ai.

### Me biçikleta nga Shkupi në Stamboll për dëshmorët e 15 korrikut

Shkup, 8 korrik - Tre çiklistët nga Maqedonia do të lëvizin pedalet në përkujtim të dëshmorëve të 15 Korrikut dhe Abdullah Tayyip Olçok, duke nisur nga kryeqyteti i Maqedonisë, Shkupi, deri në Stamboll, raporton "Anadolu Agency", transmeton gazeta KOHA. Çiklistët profesionistë Daim Muharem, Levent Rifat dhe Bekim Kalisi të cilët u nisën nga shtëpia e familjes Olçok në Shkup, synojnë të arrijnë në Stamboll me biçikletat e tyre duke udhëtuar nga Greqia. 13 vjeçari Daim Muharem nga Gostivari, në deklaratën e tij tregoi se që dy vite është duke u marrë me këtë si profesion dhe se ka fituar vendin e parë në Maqedoni U-15



në kategorinë individuale kundër kohës. Ai tha se natën e 15 korrikut nuk kanë fjetur deri në mëngjes dhe se babai i tij është gjendur në Stamboll. Muharem tha se ideja iu ka kujtuar si borxh ndaj dëshmorëve të 15 Korrikut dhe Abdullah Tayyip Olçok. "Një

mbrëmje ishim duke biseduar me babanë dhe më janë kujtuar dëshmorët e 15 Korrikut. I tregova se në nder të atyre dëshiroj të lëviz pedalet dhe babai im më mbështeti", tha Muharem. Ndërsa Levent Rifat nga Ohri, i cili ka fituar disa herë vendin e parë në

Maqedoni, tha se kanë vendosur që të lëvizin pedalet për Abdullah Tayyip Olçok dhe të gjithë dëshmorët e 15 Korrikut, nga Shkupi deri në Stamboll. "Më pyeti nëse mund të bëjmë diçka të tillë dhe unë i tregova se dëshiroj të marrë pjesë dhe morën një vendim të tillë. Sot do të nisim të lëvizim pedalet nga Shkupi deri në Stamboll", tha Rifat duke treguar se ideja ka ardhur nga Daimi të cilën e do si vëllain e tij. Ai ndër të tjera theksoi se vendi i parë i pushimit do të jetë në Dojran, në juglindje të Maqedonisë, ndërsa më pas në Greqi do të qëndrojnë dy ditë si dhe planifikojnë të lëvizin pedalet dy ditë në Turqi pas së cilës do të arrijnë në Stamboll.

### SUHEL MUHAREMI MERR KONTRATË PROFESIONALE NGA FC SHKUPI

#### I privilegjuar për këtë shans që më është dhënë

Shkup, 8 korrik - Skuadra e FC Shkupit ka rritur marrëveshje me futbollistin e ri dhe të talentuar, 16 vjeçarin Suhel Muharemi, duke i ofruar kontratë profesionale. Kështu talenti bardhekaltër që është tani më edhe pjesë e ekipit të seniorëve ka firmosur me klubin marrëveshje tre vjeçare. Lajmi u bë i ditur nga klubi bardhekaltër në faqen e saj zyrtare, sipas të cilëve stafi i trajnerëve dhe kryesia te Muaremi shohin një nga futbollistët me perspektivë të ekipit, ndërsa ai që nga sezoni i vitit të kaluar mbanë edhe numrin 9 në ekip. Menjëherë pasi ka firmosur



kontratën profesionale, për faqen e klubit ka folur vetë Muharemi. "E falënderoj kryesinë për besimin e dhënë, kjo është kontrata e ime e parë profesionale, andaj

unë si fëmijë i skuadrës së Shkupit ndjehem i privilegjuar për këtë shans që më është dhënë. Nuk dua të flas asgjë më shumë, pasi shpresoj që atë që duhet bërë

është terreni i gjelbër. Për mua është nder i madh të jem pjesë e një skuadre ku bëjnë pjesë emra të mëdhenj të futbollit, andaj do ta shfrytëzojë çdo mundësi që të mësoj nga ta dhe të jap më të mirën për të gëzuar tifozët tanë", është shprehur Muharemi. Cekim, Muharemi është shënuesi i dytë me moshën më të re në gjithë historinë e Ligës së Parë të Maqedonisë, me golin që shënoi në një ndeshje të kampionatit vendor ndaj Pelisterit në sezonin që lamë pas. Talenti Muharemi, shënoi kur ishte saktësisht 16 vjeç e 2 muaj.

# KOSOVA JOUNIKE RRETH DIALOGUT

Marrëveshjet të cilat arrihen në kuadër të procesit të dialogut duhet të ratifikohen në Kuvend me dy të tretat e deputetëve, prandaj, konsensusi është i nevojshëm edhe për këtë. Në të kundërtën, kjo mund ta rëndoj procesin apo të ketë efekte negative për Kosovën nga ky process

Prishtinë, 8 korrik - Çështja e dialogut Kosovë-Serbi asnjëherë nuk ka dalë si pikë e rendit të ditës në Kuvend gjatë kësaj legjislature. Partitë opozitare po kundërshtojnë që dialogu të zhvillohet pa një platformë e cila del nga Kuvendi, por, deri më tani asnjë veprim që çështja të diskutohet në një seancë të Kuvendit. Madje, një seancë për dialogun po e kërkon edhe Instituti Demokratik i Kosovës i cili mbikëqyr punën e Kuvendit, transmeton Periskopi.net.

Qeveria njëherë pati dërguar një platformë për bisedimet Kosovë-Serbi dhe më pas e ka tërhequr. Si pasojë, Kuvendi që nga shtatori i vitit të shkuar nuk ka pasur debat të mirëfilltë për të ardhmen e dialogut. Kështu thotë Jeta Kra-



sniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës. KDI u ka bërë thirrje deputetëve që të thërrasin një seancë të jashtëzakonshme, por, Krasniqi thotë se opozita nuk është e unifikuar, shkruan televizioni publik.

"Ajo çfarë jemi duke parë është se nuk ka unifikim të partive politike. Ne shohim se edhe partitë të cilat janë në qeveri, nuk kanë të njëjtin qëndrim kundrejt dialogut Kosovë-Serbi. Tani të gjitha partitë politike janë duke ofruar platforma të ndryshme por ajo çfarë është duke munguar është që partitë politike të ulën dhe të bëjnë atë platformën e diskutimeve të palës kosovare në këto bisedime" ka thënë Krasniqi.

Por, e paunifikuar rreth dialo-

gut, del të jetë edhe vetë LDK-ja. "Presidenti nuk ka kompetenca kushtetuese dhe legjitimitet politik për të udhëhequr këtë proces" e ka përsëritur disa herë shefi i grupit parlamentar të LDK-së Avdullah Hoti. Kurse nënkryetari i LDK-së Lutfi Haziri, kërkonte të mos krijohet precedent i refuzimit të institucioneve. Ndryshe nga LDK-ja, përfaqësues të Partisë Social Demokratike thonë se në parim janë pajtuar edhe me përfaqësues të partive tjera që Kuvendi të jetë institucioni nga i cili nis dhe diskutohet dialogu. Visar Ymeri nga PSD thotë se kjo parti po punon që kjo ide të jetësohet.

"Ne do të tentojmë dhe do të angazhohemi natyrisht si parti so-

cial-demokrate që t'i takojmë edhe në takime bilaterale, pra përfaqësues të PSD-së dhe përfaqësues të partive, në mënyrë që ta diskutojmë këtë tekst e cilat janë ato vërejtje e ndryshime që duhet të pësojë kjo ide e ky mekanizëm në mënyrë që kjo pastaj të shndërrohet në vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës" tha Ymeri.

Sidoqoftë, marrëveshjet të cilat arrihen në kuadër të procesit të dialogut duhet të ratifikohen në Kuvend me dy të tretat e deputetëve, prandaj, konsensusi është i nevojshëm edhe për këtë. Në të kundërtën, kjo mund ta rëndoj procesin apo të ketë efekte negative për Kosovën nga ky proces, thonë analistët.



## Përçarje edhe në Serbi për dialogun

Presidentët e Kosovës dhe të Serbisë po kontestohen në dy shtetet për udhëheqjen e dialogut. Opozitat e të dyjave vendeve po i cilësojnë Thaçin e Vuçiqin si persona jounifikues për të udhëhequr me negociatat.

Përderisa Thaçi po merr përkrahje nga Haradinaj në Kosovë, një gjë të tillë po e bën edhe kryeministria serbe për Vuçiqin.

Ana Bërnabiq gjatë një Samiti në Sofjet deklaroi se procesi i dialogut deri më tani ka qenë tërësisht transparent, transmeton lajmi.net.

Ajo vlerëson Vuçiqin si një njeri të guximshëm, dhe ideal për të vazhduar bisedimet.

"Dialogu është tërësisht transparent. Ne do ta mbajmë presidenti në këtë dialog sepse ai ka marrë guximin ta drejtojë këtë proces të rëndësishëm dhe tregoi gjithashtu synimet e veta që të mos e lë një konflikt për brazat e tjerë", the kryeministria serbe.

Duke folur për mundësinë që qeveria të hartojë një platformë për Kuvendin, ashtu siç ndodhi në Kosovë, Bërnabiq deklaroi se nuk është e nevojshme një gjë e tillë.

"Nuk kemi parë ndonjë nevojë që të bëjmë raport të veçantë. Ne jemi si ekip, dhe i takon përgjegjësia më e madhe presidentit", tha Ana Bërnabiq. Ndryshe, platformën e qeverisë së Kosovës për dialogun ende nuk e ka miratuar Parlamenti.

Kjo pasi partitë opozitare po kundërshtojnë ashpër udhëheqjen e negociatave nga Hashim Thaçi.

## Shqiptarët e Malit të Zi përplasen me drejtuesit e kishës serbe



Banorët e zonës së Anës së Malit por edhe më gjerë kanë penguar paraditen e së dielës fizikisht rrugëtimin e Amfilohijes për në Kalanë e Shasit. E gjithë kjo ndodhi pasi mitropoliti i kishës ortodokse serbe me numër të madh ndjekësish të tij, mbi 150 veta, me automjete tentuan të depërtojnë në mes të një gardhi fizik të banorëve. Në pamundësi

për të ecur, makinat kanë ndaluar dhe për një kohë të gjatë kishte diskutime mes Amfilohijes dhe banorëve. "Nuk jeni të mirë se ardhur në këtë mënyrë. Këto objekte janë tonat, ne i kemi ruajtur dhe ne do tu ruajmë", tha Amfilohije. Pas përplasjes të banorëve, policia lokale zhbllokoi rrugën për të kaluar ndjekësit e Kishës ortodokse serbe.

## GRUAJA QË ËSHTË BËRË FERRI I BOSNJES

### Vishet si infermiere e vjedh bebe në banesa

Merhunis Dedic, 28 vjeçe, e dyshuar për rrëmbimin e një fëmije nga banesën e çiftit Lejla dhe Kenan Ismailovski në Haxhic dje, u dorëzua në Prokurorinë e Kantonit të Sarajevës për rrëmbimin e fëmijës.

Të enjten, Dedic u paraqit në mënyrë të rrejshme si një infermiere dhe rrëmbeu një fëmijë nga banesa e çiftit Ismailovski. Ajo për fatë të mirë u gjet shumë shpejtë dhe djali është i gjallë dhe i kthyer tek prindërit e tij.

Pas kidnapimit u shtruan

shumë dyshime si si ka ardhur deri të kjo, por duket se kjo e kishte planifikuar që shumë kohë, transmeton gazetametro.net

Dediq kishte huazuar një makinë, kishte veshur mantel të bardhë dhe vendosni një maskë kirurgjikale dhe një stetoskop rreth qafës për të siguruar që të gjithë ishin infermiere pleqsh.

Kur ajo erdhi në rrugën Igman-ska, ajo pyeti vajzën që po luante ku gjendet hyrja me numër 19 dhe pasi vajza tregoi se ajo u nisë për të për apartament.

Ajo hyri kur ishte vetëm foshnja dhe teza. Si arsyetim ajo u nis për në banjo për të pastruar ujin të cilin e kishte derdhur me qëllim. Pastaj e ka mbyllur vajzën dhe ka ikur me fëmijën.

Gjatë kësaj kohe, nëna e fëmijës ishte në komunë për të lajmëruar fëmijën e posalindur, ndërsa babai ishte në punë. Fqinjët të cilët dëgjuan zhurmën kur teza e godite në derën e tualetit dhe kërkonte ndihmë.

Ajo u ndihmua nga fqinji i parë dhe e liroi, ku më pas u thirr nga



policia e cila reagoi shumë shpejt. Në aksion për të gjetur fëmijën janë nisur numëri i madh i oficerëve të policisë, një ekip i prokurorëve të prokurorive dhe Policisë Kufita-

re të BiH. Ajo u gjet nëpërmjet lokacionit të telefonit, ndërsa nga kamerat e sigurisë ajo është parë duke hyrë në hostelin "Ferijalac", nga aty policia e arrestoi.

# TAILANDË, NIS MISIONI PËR NXJERRJEN E DJEMVE NGA SHPELLA

Ekipe të shpëtimit kanë nisur misionin për të tërhequr 12 djem dhe trajnerin e tyre nga shpella ku ata gjenden të bllokuar prej mëse dy javësh, njoftoi BBC. Ekipe hynë në shpellë në ora 10:00 me orën lokale ose 3:00 GMT, tha shefi i operacionit, Narongsak Osottanakorn për gazetarët.

I gjithë eprsoneli i panevojshëm është larguar nga hyrja e shpellës, ku janë lënë vetëm ekipet e zhytjes, mjekët dhe forcat e sigurisë.

Djemtë po eksploronin shpellën më 23 qershor kur u ngelën brenda saj për shkak të ujit. 13 zhytës të huaj dhe pesë marins ta jlandezë si dhe janë përfshirë në misionin e shpëtimit.

Djemtë e parë mund të dalin rreth orës 21:00 me orën lokale ose 16:00 GMT të dielën, sipas zyrtarëve. Mendohet se operacioni mund të zgjasë disa ditë. Si fëmijët e bllokuar ashtu dhe familjet e tyre janë informuar për planin. Është e paqartë sesi do të zhvendosen djemtë, por duket se udhëtimi do të përfshijë disa zhytje dhe ecje në zonat ku uji i lejon. Ndërkohë, prindërit e 12 djemve të bllokuar brenda një shpelle në veri të Tajlandës kanë shkruar letër për fëmijët e tyre dhe për trajnerin i cili i ka çuar brenda, duke i thënë: "Të lutem mos e fajëso veten". Në një letër të shkruar nga nëna e një 14 vjeçari të ngujuar thuhet: "Për të gjithë fëmijët, ne nuk jemi të mllafosur me ju. Kujdeseni mirë për veten, mos harroni të mbuloheni me batanije kur moti është i ftohtë. Ne jemi të shqetësuar dhe ju do të dilni së shpejti nga shpella". Aty përmendet edhe trajneri i ekipit të futbollit. "Duam që ju



të dini se asnjë prindër nuk është i zemëruar me ju, prandaj mos u shqetësoni për këtë". Ndërkohë që evakuimi i 12 nxënësve të bllokuar në një shpellë të përmbytur në Tajlandë ka filluar dhe ata mund të dalin sonte, njoftoj sot komandanti i shpëtimit. Një ekip prej 18 personave filloj operacionin e tyre jashtëzakonisht të rrezikshëm në orën 10.00, pasi familjet e tyre janë njoftuar. Një ditë më parë, edhe djemtë tajlandezë të bllokuar në një shpellë për dy javë kanë shkruar letra për prindërit e tyre, duke thënë mos u shqetësoni ... ne të gjithë jemi të fortë. Shënimet e shkruara me dorë përfshijnë kërkesa për ushqim, përfshirë pulën e skuqur.

"Mësues, mos na jep shumë detyra shtëpie!" lexon një letër. Trajneri i ekipit gjithashtu i ofroi prindërve keqardhjen e tij në një letër të veçantë. Në letrën e tij, trajneri 25-vjeçar Ekkapol Chantawong siguroi prindërit duke thënë: "Të dashur prindërit e të gjithë fëmijëve, tani të gjithë janë mirë, ekipi i shpëtimit po na trajton mirë. Dhe unë

pretoj se do të kujdesem për fëmijët sa më mirë që mundem. Faleminderit për të gjithë që vijnë për të ndihmuar. Gjithashtu sinqerisht kërkoj falje prindërve të fëmijëve".

Arpakorn Yookongkaew nga ushtria tajlandeze i cili koordinon aktivitetet e kërkimit, tha në një konferencë për media se një ekip prej shtatë personash, përfshirë mjekë dhe infermierë, kanë arritur te vendi ku gjendet grupi që kishte humbur. Arpakorn tha se ekipi u ka ofruar fëmijëve ushqime lehtë të tretshme me vlera të larta energjetike dhe minerale të mjaftueshme.

"Jemi duke i vlerësuar alternativat se si mund t'i nxjerrim 12 fëmijët futbollistë dhe trajnerin e tyre. Në mesin e alternativave është t'i nxjerrim pasi t'u kemi dhënë trajnim në zhytje. Megjithatë, kjo duhet të bëhet përmes stërvitjeve pasi të arrihet siguri 100 për qind", tha Arpakorn. Guvernatori i provincës Chiang Rai Narongsak Osatanakorn tha se fëmijët kanë nisur ushtrimet për frymëmarrje me maska të zhytjes, por se ende nuk kanë fil-

luar me aktivitete të zhytjes. Siç njoftohet, madje edhe zhytësve profesionistë u janë dashur disa orë për të arritur te pika ku gjendet grupi për shkak të galerive të ngushta të ngelura nën ujërat e vërshimeve, ndërsa për evakuimin e fëmijëve në këtë mënyrë do të nevojitet përgatitje serioze. Ndërkaq, alternativa e pritjes së rënies së vetvetishme të nivelit të ujit është konsideruar jo-praktike, pasi në dy muajt e ardhshëm rajoni pritet të përfshihet nga sezoni i shirave monsun. Teksa janë duke u bërë përpjekje për zvogëlimin e nivelit të ujit përmes pompave të drenazhit, vazhdimi i reshjeve e ka vështirësuar këtë metodë. Ekipet e shpëtimit janë duke bërë edhe kërkime për gjetjen e zbrazëtirave të ajrit përmes të cilave do të mund të sigurohej dalje alternative nga shpella. Ndryshe, 12 fëmijët nga moshë 11 deri në 16 vjeçe dhe trajneri i tyre 25 vjeçar ishin zhdukur gjatë shetitjes në shpellën Tham Luang Nang Non më 23 qershor dhe u gjetën të gjallë pas nëntë ditëve kërkim nga ekipet e shpëtimit.



## Turqi, mbyllen edhe tri gazeta dhe një televizion

Autoritetet turke urdhëruan shkarkimin e më shumë se 18,500 punonjësve shtetëror, duke përfshirë zyrtarë të policisë, ushtarakë dhe akademikë, me një dekret të botuar të dielën. Gazeta Zyrtare tha se 18,632 persona u shkarkuan duke përfshirë 8,998 policë në dekretin emergjent për shkak të dyshimeve për lidhje me organizata terroriste dhe grupet që "veprojnë kundër sigurisë kombëtare". Gjithashtu u shkarkuan edhe 1.052 nëpunës civilë nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e lidhura me të, si dhe 649 nga xhandarmëria dhe 192 nga roja bregdetare.

Autoritetet gjithashtu shkarkuan 199 akademikë, sipas dekretit të ri, ndërsa 148 punonjës të shtetit nga ushtria dhe ministritë u rikthyen në detyrë.

Turqia ndodhet në një gjendje të jashtëzakonshme që nga korriku i vitit 2016, pas grushtit të dështuar të shtetit dhe kjo i ka shërbyer Presidentit Rexhep Tayp Erdogan për të kryer pastrime dhe burgime të gjera. Mbi 50 mijë njerëz janë nëpër burgje, dhe rreth 200 mijë të tjerë janë shkarkuar nga puna.

Qeveria ka premtuar se do të shfuqizojë gjendjen e jashtëzakonshme dhe periudha i shërben qeverisë të kryej pastrimet e fundit të zyrtarëve që nuk janë në shërbim të saj.


Emergjencia është rinovuar shtatë herë dhe periudha e fundit zyrtarisht pritet të përfundojë më 19 korrik.

Turqia akuzon predikuesin mysliman të SHBA Fethullah Gulen për orkestrimin e grushtit të tentuar. Shumica e të pushuarve nga emergjencat akuzohen për lidhje me Gulenin.

Gulen mohon fuqishëm lidhjet me grushtin e shtetit dhe këmbëngul që lëvizja e tij është një organizatë paqësore. Dekreti i së dielës mbyll 12 shoqata në të gjithë vendin, si dhe tre gazeta dhe një kanal televiziv. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut duke përfshirë Amnesty International i kanë konsideruar spastrimet si arbitrar./Ora News

## KINA FORCON LIDHJET ME EUROPËN LINDORE

Kina ka interes për një Europë të fortë, u shpreh kryeministri kinez, Li Keqiang në takimim e kryeministrave të vendeve të Europës Qendrore, Lindore e Juglindore që zhvillohet në Sofje, i njohur si takimi 16+1. Shoqëruar nga një sërë delegacionesh me sipërmarrës nga vende të ndryshme ka filluar në Sofje samiti i Europës Qendrore e Lindore me Kinën (07.07). Kryeministrat e vendeve të Europës Qendrore, Lindore e Juglindore takohen në konferencën e njohur, si takimi 16+1, bashkë me kryeministrin kinez, Li Keqiang. Në hapje të takimit, kryeministri kinez, Li Keqiang u shpreh, se Kina do të shohë një Europë të fortë dhe të hapur. Kjo është edhe në interesin e Kinës, tha ai. Ndërsa mikpritësi i takimit, kreu i qeverisë



bullgare, Boiko Borisov u shpreh se ky „format nuk ka qëllimin të ndajë, por të bashkojë Europën." Ai iu referua kështu kritikave të vazhdueshme nga BE, se një takim i tillë me Kinën minon unitetin e Bashkimit European. Kooperimi i Kinës me vendet europianolindore alarmon Bashkimin European. Diplomatat e Brukselit thonë se strategjia është „përçja e sundo". Në Bullgari Kina po

merr pjesë në ndërtimin e centralit atomik, Belene dhe ndërtimin e autostradave dhe linjave hekurudhore.

Ky takim renditet për Pekinin në projektin e Rrugës së Re të Mëndafshit, që synon të lidhë Kinën me Europën. Bëhet fjalë për bashkëpunim në infrastrukturë, ekonominë energjetike, teknologji, turizëm e kulturë. Kryeministri Keqiang theksoi në Sofje se Kina do të vazhdojë të

ndjekë politikën e tregjeve të hapura, kjo një ditë pasi Uashingtoni dhe Pekini vendosën tarifa doganore reciproke në vlerën e 34 bilionë dollarëve. Kryeministri kinez theksoi se Kina do të vazhdojë të mbajë të hapur derën për produkte të huaja, sepse tregtia e hapur siguron rritjen ekonomike globale.

Takimi 16+1 zhvillohet rregullisht nga viti 2012. Paralelisht me kërret nga politika, në Sofje kanë ardhur edhe 1000 biznesmenë nga vendet pjesëmarrëse si Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Lituania, Maqedonia, Serbia, Sllovakia e vende të tjera. Vendi mikpritës Bullgaria kishte ftuar si të ftuar nderi kancelaren gjermane, Angela Merkel, por ajo nuk merr pjesë./DW/

Platformat e internetit, kryesisht të bazuara jashtë Bashkimit Evropian, shpesh konkurrojnë në mënyrë të padrejtë me operatorët e BE-së, kryesisht për shkak të pozicioneve të tyre dominuese dhe shmangies së taksave. Këto janë probleme që kërkojnë një zgjidhje. Por metodat e propozuara në direktivën për të drejtën e autorit nuk do të zgjidhin asgjë; përkundrazi, është e qartë se do ta bëjnë copë internetin

Nga Thomas MARGONI

Reforma e të drejtës së autorit e propozuar nga Bashkimi Evropian është në një pikë vendimtare, pasi është duke u votuar nga Parlamenti Evropian. Qëllimi i Direktivës mbi të drejtat e autorit në tregun përbashkët digjital, përditësimi i parë i madh i legjislacionit në këtë fushë, që prej gati njëzet vjetëve, është që të modernizojë dhe përshtatë të drejtën e autorit në epokën digjitale. Por në tekst janë përfshirë disa dispozita shumë problematike, që janë miratuar kohët e fundit nga komisioni parlamentar për çështjet ligjore. Që do të thotë se propozimi i tanishëm, me të gjitha problemet e veta, ka shanse për t'u bërë ligj shumë shpejt, në varësi se si do të votojë përfundimisht Parlamenti Evropian më 5 korrik.

Paketa aktuale e reformës mbi të drejtën e autorit është shumëplanëshe, dhe disa janë ide padyshim të mira. Por direktiva të drejtave të autorit, në veçanti, ka gjeneruar shumë shqetësim - dhe protesta publike - për shkak të disa dispozitave të cilat do të ndikojnë dukshëm në jetën online të miliona qytetarëve, dhe jo domosdoshmërisht në një mënyrë të mirë. Dy nga këto dispozita kanë të bëjnë me të drejtat e botuesve dhe filtrin e detyrueshëm parandalues për përmbajtjen e ngarkuar në internet.

#### E DREJTA E BOTUESVE

Për të shpërblyer prodhuesit e përmbajtjes për fitimet e nxjerra nga platformat e rrjeteve sociale që ndajnë linket dhe titujt e artikujve të lajmeve, është propozuar e ashtuquajtura "link tax", e cila do të sillte platforma (si Facebook apo Twitter, por edhe shumë të tjera) pagesën e një leje për të përdorur artikuj dhe informacione (edhe pse një amendament i kohëve të



# LIRIA E INTERNETIT ËSHTË NË RREZIK



fundit duket se përjashton zbatueshmërinë për link-e autonome). Sipas ligjit aktual, artikujt tashmë janë subjekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit siç janë veprat letrare. Nëse dëshironi të ribotoni një artikull nga një gazetë apo revistë, keni nevojë për lejen e tyre. Kjo mbrojtje shtrihet edhe në titullin e artikullit, nëse është mjaftueshëm origjinal.

Megjithatë, faktet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me lajmet nuk janë mbrojtur kurrë nga e drejta e autorit. Nëse një buletin boton një artikull, titulli i të cilit është një përshkrim i thjeshtë i një ngjarjeje të tanishme - "Anglia kualifikohet për fazën eliminatorë të Kupës Botërore 2018" - kjo nuk është origjinale mjaftueshëm, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të autorit. Ky është një përshkrim i një ngjarjeje të tanishme, një fakt. Nuk ka kreativitet në të, në krahasim me titujt e veçantë ose origjinale që zakonisht gjenden në disa gazeta. Nëse artikujt e tillë do të mbroheshin, do të thoshte që asnjë faqe ose blog tjetër i lajmeve nuk do të mund të raportonte të njëjtën ngjarje, pa lejen e botuesit fillestar.

Prandaj është e qartë se pse

çdo përpjekje për të taksuar raportet faktike të lajmeve është e pakuptimtë. Nga pikëpamja ekonomike, e drejta e autorit lejon monopolin e një pune të veçantë krijuese. Duke lejuar që të drejtat e monopolit të shtrihen në ide, fakte ose të dhëna mbi lajmet aktuale, direktiva përbën një kufi të pajustificueshëm të së drejtës tonë themelore për lirinë e informimit: lirinë për të krijuar dhe dhënë informacione dhe lirinë për t'i marrë ato. Gjithashtu do të preken shumë të drejta të tjera, të tilla si liria e biznesit ose pronësia intelektuale e atyre që dëshirojnë të ripërdorin informacionin faktik, për të krijuar diçka origjinale. Ka prova të qarta dhe konsensus unanim mbi faktin që, kufizimi i fluksit të lirë të informacioneve në këtë mënyrë, do të ishte shkatërrimtar.

#### FILTRI PARANDALUES I DETYRUESHËM

Përcaktimi i kësaj dispozite si një "makinë censurimi" mund të duket një ekzagjerim, por është e padiskutueshme që propozimi synon ta bëjë të detyrueshëm për ofruesit e hostim-eve të faqeve të internetit, që të përdorin softuer filtrues i cili do të verifikojë se

përmbajtja e ngarkuar apo e hostuar është të ligjshme: për shembull, që nuk shfaqen në asnjë listë të materialit të mbrojtur nga të drejtat e autorit, të siguruar nga mbajtësit e të drejtave. Paradoksalisht, kjo mund të nënkuptojë, ndër të tjera, që nëse një qytetar i Bashkimit Evropian dëshiron të shprehë veten në internet, ai duhet t'i kërkojë leje një softueri të filtrimit të përmbajtjes, të zhvilluar nga një kompani me seli në Shtetet e Bashkuara.

#### LIGJI AKTUAL: NJOFTIMI DHE HEQJA

Sipas legjislacionit aktual, platformat - organizatat që formojnë infrastrukturën në internet përmes të cilave përdoruesit bashkëveprojnë, si YouTube, Facebook, Tëitter, Amazon, eBay ose Instagram - nuk janë përgjegjëse kur përdoruesit e tyre shkelin të drejtën e autorit, me kusht që ata nuk janë të vetëdijshëm për shkeljen dhe që sapo të informohen, veprojnë shpejt për ta larguar atë. Ky proces njihet globalisht si njoftim dhe heqje, edhe pse ka dallime në mes të juridiksioneve të ndryshme.

Ky kufizim i përgjegjësisë për



**Direktiva e propozuar për të drejtën e autorit do të zhvendoste një pjesë shumë më të madhe të përgjegjësisë dhe koston e shkeljes së të drejtave të autorit tek platformat, të cilat duhet të monitorojnë në mënyrë parandaluese atë që është ngarkuar në serverat e tyre. Kjo do të thotë që do të kenë nxitje të fortë për të qenë tepër kufizues në mënyrë që të shmangin përgjegjësinë dhe gjobën**

platformat zgjat vetëm derisa ato të jenë në dijeni të shkeljes materiale. Megjithatë, individit përgjegjës për ngarkimin e një kënge, videoje ose produkti copyright, mund të paditet sërish nga autorët ose më shpesh nga mbajtësit e të drejtave që kanë fituar të drejtën e autorit nga autorët, për shembull shoqëritë e komunikimit, botuesit dhe kompanitë e muzikës. Ky mekanizëm nuk është i përsosur dhe ka tërhequr tashmë kritika, se është shumë i njëanshëm, në favor të mbajtësve të të drejtës së autorit dhe platformave dhe duke harruar, si zakonisht, të drejtat e përdoruesve. Por të paktën ka garantuar deri tani një ekuilibër të caktuar midis mbrojtjes së investimeve në prodhimin e përmbajtjes krijuese, dhe promovimit të inovacionit nëpërmjet ndarjes së tij në internet, ose së paku një pjesë të tij. Me fjalë të tjera, kostoja e shkeljes së të drejtës së autorit është ndarë në mes tre aktorëve kryesorë: mbajtësit e të drejtave, platformat dhe përdoruesit. Dhënësit e të drejtave, siç janë botuesit apo kompanitë e komunikimit, informojnë platformat të tilla si YouTube ose Facebook për shkelje të përmbajtjes, platformat reagojnë dhe përdoruesit janë

të vetëdijshëm se janë përfundimisht përgjegjës për atë që bëjnë dhe thonë në internet.

#### PROPOZIMI: PROGRAME FILTRIMI AUTOMATIK

Direktiva e propozuar për të drejtën e autorit do të zhvendoste një pjesë shumë më të madhe të përgjegjësisë dhe kostos së shkeljes së të drejtave të autorit tek platformat, të cilat duhet të monitorojnë në mënyrë parandaluese atë që është ngarkuar në serverat e tyre. Kjo do të thotë që do të kenë nxitje të fortë për të qenë tepër kufizues në mënyrë që të shmangin përgjegjësinë dhe gjobën. Por në fund, edhe një herë, do të jenë përdoruesit dhe liria e fjalës që do të mbajnë peshën, sepse ata do të pengohen nga publikimi i videove, këngëve, imazheve dhe produkteve derivative - të tilla si paroditë, kritikën, diskutimet, lajmet apo hulumtimet, në rastet kur ato përfshijnë disa elemente të pambrojtura të një pune të mbrojtur. Edhe një herë, liria e shprehjes ose e fshehtësisë së një shtetasi britanik ose të Bashkimit Evropian nuk do të gjykohej nga një gjykatë në Mbretërinë e Bashkuar apo Bashkimin Evropian, por nga softueri i zhvilluar nga një kompani private amerikane.

Përtej hollësive ligjore, ndoshta pjesa më problematike e këtij propozimi ka të bëjë me një aspekt teknologjik: softueri filtrues që ligji do ta bënte të detyrueshëm, në thelb nuk ekziston. Nuk ka softuer të aftë për të raportuar në mënyrë të besueshme përdorimet problematike të materialit të mbrojtur nga përdorimet e lejuara (si kritikën, paroditë ose lajmet), dhe njohja e saktë e përmbajtjes është ende e pakët. Për shembull, disa leksione universitare ose dijetarë të njohur për të drejtën e autorit janë bllokuar për shkelje të të drejtës së autorit. Edhe kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të treguar sa sipërfaqësor dhe problematik është ky propozim. Ekzistojnë dëshmi të forta që tregojnë ndikimin negativ që kjo dispozitë do të kishte në të drejtat themelore - dhe e gjithë kjo sjell shumë dobi në aspektin e mbrojtjes shtesë për mbajtësit e të drejtave.

Është e vërtetë se shtypi i pavarur dhe mjetet e komunikimit, të domosdoshme për një demokraci funksionale janë nën një presion të madh financiar pasi lexuesit shkojnë në internet për përmbajtjen "e lirë". Po ashtu, platformat e internetit, kryesisht të bazuara jashtë Bashkimit Evropian, shpesh konkurrojnë në mënyrë të padrejtë me operatorët e BE-së, kryesisht për shkak të pozicioneve të tyre dominuese dhe shmangies së taksave. Këto janë probleme që kërkojnë një zgjidhje. Por metodat e propozuara në direktivën për të drejtën e autorit nuk do të zgjidhin asgjë; përkundrazi, është e qartë se do ta bëjnë copë internetin. (The Conversation)



# AMBICIA EUROPIANE E MACRONIT FILLON NË BALLKAN

Referendumi në Maqedoni këtë vjeshtë, dhe zgjedhjet në Bosnjë në muajin tetor, duhet të ndiqen nga afër, për shkak të rezultateve të tyre të mundshme negative. Pas një samiti në pritje të tensionuar të NATO-s, duke marrë parasysh pikëpamjet e Donald Trump mbi aleancën, nëse Europa dëshiron të bëhet një aktore e pavarur dhe e fuqishme, duke përfshirë si pikëpamjen ushtarake, por edhe ambicien e Macron, gjithçka fillon në Ballkan

Nga Loic TREGOURES

Këshilli European, arriti një marrëveshje për çeljen e bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë, që parashikohet të nisnin në qershorin e vitit 2019, nëse reformat vazhdojnë të japin rezultate konkrete. Komisioni European, Parlamenti European dhe shtetet e tjera anëtare përfshirë Greqinë, i dhanë dritën jeshile këtij procesi, pavarësisht nga qëndrimi fillestar negativ i shprehur nga Franca dhe Holanda.

Emmanuel Macron, paraqiti qasjen e Parisit mbi zgjerimin e unionit, në samitin BE-Ballkani Perëndimor në Sofje të Bullgarisë në muajin maj, duke deklaruar se nuk mund të ketë zgjerim, përpara një reformimi të vetë Bashkimit European. Ky veprim, mund të ketë qenë i lidhur me shqetësimet rreth partive populiste brenda vendit të tij. Por kjo ndërhyrje, ishte tejet kotradiktore me fjalimin e tij të mbajtur në Sorbonë vitin e kaluar, ku ai bëri një apel të fortë për një Europë të bashkuar dhe të udhëhequr nga një vizion i qartë, që nuk dorëzohet përballë forcave anti-europiane. Duket se preferenca e Parisit për vonimin e hapjes së bisedimeve me Shkupin dhe Tiranën, ka rënë "viktimë" si e mungesë të inkoherencës së pafat, ashtu edhe frikërave të politikës populiste në shtëpi.

Ajo që ndodhi midis vizionit në Sorbonë dhe "derës së përplasur në fytyrë" në Sofje, nuk ka të bëjë fare me vetë Ballkanin Perëndimor, veçanërisht duke pasur parasysh arritjet e shquara të Maqedonisë në vitin e fundit. Ajo ka të bëjë me partitë populiste franceze, dhe republikanët që e kanë kthyer zgjerimin e unionit në Bal-

lkan në një kauzë elektorale, përpara zgjedhjeve për në Parlamentin European në vitin 2019.

Megjithatë, zotimi për të bllokuar Maqedoninë dhe Shqipërinë, nuk ka gjasa të zhvendosë asnjë votë. Për më tepër, kjo strategji e ngushëllimit të partive populiste dhe të ekstremit të djathtë, nuk ka prodhuar asnjëherë efekte pozitive për partitë pro-europiane apo të qendrës së djathtë, që janë zbatueset e këtyre strategjive, qoftë disa dekada më parë, apo edhe sot. Përkundrazi, kjo qasje e fragmenton një qeveri, që e vendos të gjithë besueshmërinë e saj në ecjen përpara drejt BE dhe NATO. T'i thuash Shkupit se negociatat mund të hapen në qershorin e 2019-ës, pas referendumit që do të mbahet në Maqedoni mbi emrin e ardhshëm të vendit, është një reminiscencë e një formule popullore të përdorur në Ballkan: "Ne do të votojmë për opozitën, kur ajo të jetë ngjitur në pushtet!"

Në Sorbonë, Macron vuri theksin tek vlerat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, që ai beson se duhet të jenë në thelbin e një projekti të ri evropian. Në Ballkan ai vuri theksin tek zgjedhja strategjike e lidhjes së rajonit me BE, si dhe nënvizoi domosdoshmërinë për të respektuar kriteret e vendosura nga BE, dhe përmbu-

shur reformat demokratike.

Disa muaj më vonë në Sofje, Macron bëri një dallim të habitshëm midis një Europe sovraane dhe një Europe të bashkuar. Sovraniteti, do të thoshte se Ballkani duhet të ankorohet në BE për arsye historike dhe gjeopolitike. Megjithatë, uniteti nënkuptonte se nuk mund të ketë zgjerim përpara reformimit të unionit. Dhe ky është një argument shumë i diskutueshëm, duke pasur parasysh se procesi është së paku një dekadë i vjetër, ndaj ka pak justifikime në kërkesën e presidentit francez për të bllokuar hapjen formale të bisedimeve, që i hap rrugën një procesi të gjatë dhe të vështirë.

Përveç kësaj, sa i përket balancës ligjore dhe politike të BE-së dhe funksionimit të saj, Maqedonia apo Mali i Zi - vende me respektivisht më pak se 2 dhe më pak se 1 milion njerëz - vështirë se mund të krahasohen me Turqinë ose Rumaninë. A ka vërejtur dikush ndonjë ndryshim të rëndësishëm në balancën e brendshme, që kur Kroacia u bë anëtare e BE-së në vitin 2013?

Macron deklaroi gjithashtu se "nuk do të ishte serioze të hapet një proces i ri zgjerimi, pa kushte", duke shtuar se Komisioni ka vënë në dukje çështje specifike si korrupsioni dhe emigracioni, për të

cilat duhet bërë shumë më tepër. Por duhet të vihet në dukje, se asnjë proces zgjerimi nuk është hapur kurrë dhe nuk ka përfunduar pa kushte. Për më tepër, ai deklaroi se vendet që punojnë shumë, si Maqedonia, duhet të shpërblehen.

Nuk mund të merret e mirëqenë që zgjerimi të përputhet natyrshëm me dizajnin e Macron për një Europë më demokratike. Ka pasur shpresa, veçanërisht në lidhje me ndryshimet pozitive në Maqedoni, se politika e zgjerimit do të ishte më shumë e natyrës politike, e bazuar në vlera, së bashku me synimet e Macron për Europën, kundër ndikimit të regjimeve jo liberale, brenda dhe jashtë BE. Mjerisht, kjo nuk u materializua. Kështu, ajo që ende mungon është një politikë e zgjerimit, e hartuar sipas vizionit të vetë Macron mbi Europën, e prezantuar në Sorbonë, me qëllim që me fjalët e tij të tregojë se zgjerimi mund të shkojë krah për krah, me një ambicie të përtërirë europiane.

Ballkani është i vetmi rajon ku BE-ja ka fuqinë për të dizenuar një realitet të ri, por është gjithashtu rajoni ku Europa ka dështuar më shumë. Referendumi në Maqedoni këtë vjeshtë, dhe zgjedhjet në Bosnjë në muajin tetor, duhet të ndiqen nga afër, për shkak të rezultateve të tyre të mundshme negative. Pas një samiti në pritje të tensionuar të NATO-s, duke marrë parasysh pikëpamjet e Donald Trump mbi aleancën, nëse Europa dëshiron të bëhet një aktore e pavarur dhe e fuqishme, duke përfshirë si pikëpamjen ushtarake, por edhe ambicien e Macron, gjithçka fillon në Ballkan.

(Loic Tregoures është lektor mbi analizën e konfliktit në Institutin Katolik të Parisit)



JAVA KULTURORE SHQIPTARE NË NJU JORK

## SHKUPI RIKTHEN VLERAT E HARRUARA

Këshilli për Shënimin e 550-përvjetorit të Vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut–Maqedoni në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante në Shqipëri Vëllazërinë Ungjillore të Shqiptarëve në Amerikën e Veriut organizuan një sërë aktivitete në kuadër të javës Kulturore shqiptare në Nju Jork. Të gjitha këto ngjarje kulturore në SHBA, zhvillohen në shenjë të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni, nisi aktivitetin "Java kulturore shqiptare në SHBA", me promovimin e librit "Familjet katolike shqiptare në Shkup" të autorëve Skender Asani, Albert Ramaj dhe Natasha Didenko.

Aktiviteti u zhvillua në Qendrën Kulturore të Kishës Katolike Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në Hartsdale të Nju Jorkut, me praninë e një numri të madh të bashkatdhetarëve tanë.

Drejtori i Institutit dhe autor i librit, Skender Asani, tha se përmes këtyre dokumenteve dhe dëshmime historike, për herë të parë po del në shesh një histori e fjetur e shqiptarëve autoktonë të Shkupit. Sipas tij, përmes argumentimit shkencor përgënjeshtrohen historitë e pavërteta të enciklopedive sllave për Shkupin, si dhe grumbullohet një material i mirë për ta shkruar historinë e vërtetë të shqiptarëve të Shkupit me fakte të pamohueshme. Asani tha se përmes këtij libri, Shkupi argumentohet edhe si një kryeqendër shpirtërore e shqiptarëve në botë, e cila ka një vijueshmëri që nga periudha antike e deri në ditët e sotme.

Eventin e përshëndetën famullitari i Kishës Katolike "Zoja e Shkodrës", Dom Pjetër Popaj si dhe përfaqësuesi i Federatës Panshqiptare "Vatra", Marjan Cubi, të cilët u shprehën të impresionuar me volumnin e informacionit për shqiptarët katolikë të Shkupit, që u erdhin përmes këtij libri.

Rreth librit foli edhe autorja tjetër Natasha Didenko, e cila theksoi se këtë libër e ka punuar më tepër e shtyrë nga aspekti emocional, si një bijë e një katolikeje shqiptare, duke e parë se sa e rëndësishme është të shihet ecuria jetësore e një personaliteti në një rreth të caktuar familjar.



Pas promovimit u shfaq dhe filmi dokumentar kushtuar ipeshkvit të Shkupit, Pjetër Bogdani, një prodhim i Televizionit të Maqedonisë.

#### ASANI: "PO E RILIDHIM HISTORINË E FRAGMENTUAR SHQIPTARE"

Aktivitetet në kuadër të "Javës kulturore shqiptare në SHBA", vazhduan me promovimin e librave të botuara në bashkëpunim me Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante në Shqipëri dhe Vëllazërinë Ungjillore të Shqiptarëve në Amerikën e Veriut. Kështu, në Kishën Protestante Rumune "Maranatha", në kuadër të cilës funksionin edhe Kisha Protestante Shqiptare "Rruga e shpresës", u bë promovimi i pesë titujve të botuar në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Shqiptare dhe Protestante me seli në Tiranë.

Bëhet fjalë për librat "Skënderbeu në vendet nordike" nga autorët Xhevat Lloshi e Xhon Kuanrud, "Shkupi për Vitin e Skënderbeut (1468-2018)", "Jeta ime" – Sevasti Qiriazzi-Dako, "Gjerasimi – predikues, iluminist, rilindës" – Xhon Kuanrud, dhe "Pengu i kaçakëve" nga Gjerasim Qiriazzi.

Drejtori i Institutit Skender Asani, tha se bashkëpunimi mes dy institutëve ka bërë që sot të kemi para ne këto tituj shumë domethënës për shkencën dhe kulturën shqiptare. Ato do të jenë në funksion të sforsimit të identitetit shqiptar, atje ku e kishin lënë familja Qiriazzi, nga e cila kemi shkollën e parë shqipe, Kongresin e Manastirit dhe aleancën me SHBA-në.

Kurse, drejtori i Institutit të Studimeve Shqiptare dhe Protestante, David Hosafllak, theksoi rëndësinë e këtyre veprave në mesin e litera-

turës shqiptare, të cilat burimin e frymëzimit e kanë pikërisht te figura kombëtare shqiptare e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.

Edhe përfaqësuesi tjetër i IT-SHKSH-së, Sevda Demiri, foli për këto botime, të cilat sipas tij, e plotësojnë mozaikun e formësimit të identitetit shqiptar, përmes kontributit madhor të Qiriazëve të Manastirit.

Pastori i Kishës Protestante Shqiptare, Beni Pango, theksoi që diversiteti fetar në mesin e shqiptarëve duhet parë si një përparësi dhe mundësi më tepër për bashkim dhe përparim mes nesh.

Të martën aktivitetet VAZH-DUAN vazhdojnë në bashkëpunim me Qendrën Islame Shqiptare në Nju Jork dhe Nju Xhersi, me promovimin e disa titujve shkencor të Institutit.

#### SHKUPI DHE VATRA I BASHKON SHQIPTARËT NË NJU JORK

Java Kulturore Shqiptare në Nju Jork i përmbylli aktivitetet e shtunën me një tubim gjithpërfshirës në Federatën Panshqiptare "Vatra. Me këtë rast drejtori i Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Maqedoni, Dr. Skender Asani, mbajti edhe një fjalim rasti.

"Po ju drejtohem sot këtu jo vetëm për të prezantuar në emër të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, por edhe për të ndarë me ju tri gjëra që për neve, që kemi ardhur nga Shkupi, janë të rëndësishme, dhe që besoj se duhet të thuhet me këtë rast.

E para që kam dëshirë ta theksoj është se, ndonëse koincidence, më vjen shumë mirë që aktivitetet e Javës Kulturore Shqiptare në SHBA

po i përmbyllim te Vatra. Nuk kish-te si të bëhej më mirë. Pasi që kemi qenë në Kishën Katolike "Zoja e Shkodrës", pasi që kemi qenë në Kishën Baptiste Shqiptare, pasi që e kemi hapur një ekspozitë për familjet katolike shqiptare të Shkupit në Qendrën Kulturore të Maqedonisë, pasi që kemi qenë në një promovim në Qendrën Islame Amerikane-Shqiptare në Nju-Xhersi, më parë kemi qenë edhe në Boston në Kishën Ortodokse Shqiptare, përmbyllja e këtij cikli të aktiviteteve te Vatra e Konicës dhe Nolit është mënyra më e mirë për ta kremtuar këtë javë kulturore. Prandaj jam i ngazëllyer që jam sot këtu dhe që Vatra na ka pritur siç di të presë vetëm një vatër shqiptare.

Momenti i dytë që, në fakt, është vazhdim i kësaj që e fillova është se shqiptarët në SHBA kanë fat të madh që, përkundër dallimeve të ndryshme fetare e krahinore, gjejnë edhe një vatër shqiptare që është mbi të gjitha ato dallime. Vatra është metaforë e vargut të Pashko Vasës "feja e shqiptarit është shqiptaria". Kur vijmë këtu, të gjithë ne shkrihem në identitetin e përbashkët të Vatrës dhe gjejmë prehe nga dallimet që mund t'i kemi gjithkund tjetër. Vetëm në Vatrë ne ndjehemi tamam shqiptarë pa asnjë përcaktor tjetër. Dhe, kur kësaj ia shtojmë faktin se themelues të

Vatrës ishin patriotët që edhe sot kanë mbetur të patejkaluar në përmasat e tyre, s'do mend se të shkelësh në hapat e tyre kjo është edhe privilegj, por edhe përgjegjësi.

Dhe, gjëja e tretë që dua ta vë në pah në këtë paraqitje është se jemi këtu për të promovuar një libër të komunitetit bektashian, që është moment i rëndësishëm për dy arsye: kështu – në ciklin e përfshirjes së komuniteteve të ndryshme fetare shqiptare – nuk i lëmë anash as vëllezërit tanë bektashinj, dhe, dyta, kështu po shfaqim respekt edhe për gjithë atë plejadë rilindësish bektashianë, që i ke edhe në Lidhjen e Prizrenit, edhe në Kongresin e Manastirit, edhe në Pavarësinë e Vlorës, por edhe më vonë në historinë tonë kombëtare. Zaten, pa kontributin e tyre, mozaiku i historisë dhe kulturës shqiptare do të ishte i paplotë. Në këtë mënyrë ne i falënderojmë ata për gjithçka që kanë bërë për ne dhe u dëshmojmë se le që nuk i harrojmë, por madje ata janë në epiqendër të vëmendjes sonë dhe me ata takohemi pikërisht kur vijmë te Vatra shqiptare.

Këto vitet e fundit, institucioni ynë shtetëror, i vetmi institut shkencor shqiptar në Maqedoni, ka qenë shumë i hapur për bashkëpunim me të gjitha komunitetet fetare, sikurse edhe me atë bektashi, me të cilin kohë më parë kemi prezantuar bashkë edhe rezultatet e fundit të ngadhnjimit të së drejtës së këtij komuniteti në Gjykatën ndërkombëtare.

Për më tepër, Instituti jonë po bën përpjekje që së shpejti të hapë edhe departamentin e Mirëkuptimit fetar, ku do të studiohet në mënyrë shkencore edhe historia e bektashizmit në Maqedoni.

Po e përfundoj fjalën time duke ju thënë se nëse shqiptarët kanë një Vatër në Amerikë, tash një vatër shqiptare e kanë edhe në Shkupin e Hasan Prishtinës, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Ne, në një mënyrë, jemi bërë atdheu i shqiptarëve të të gjitha komuniteteve fetare dhe, madje, edhe krahinore e të tjera. Në Shkup sot përthyen edhe Tirana e Prishtina, edhe Ulqini e Presheva, por edhe Manastiri e Korça. Shkupi sot nuk është periferi shqiptare, por është një bërthamë serioze shqiptare. Unë ju falënderoj për kujdesin uroj që gjithmonë të takohemi në ngjarje të këtilla", tha dr. Asani

Publicitet

## URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+Pr+1+Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

## SHPALLJE

TI Kolonijal LINDA Islam Afet Zeqiri f. Çellopek, Brvenicë, me adresë në f. Çellopek, Brvenicë, me NAS 5319790 dhe NUT 5028995105411 ka për qëllim të bëjë përcjelljen e ndërmarrjes personit Abdiram Afet Zeqiri nga f. Çellopek, Brvenicë. Thirren të gjithë kreditorët ti paraqesin kërkesat e tyre në afat prej 30 ditësh prej datës së shpalljes .

Në bazë të nenit 155- v, 156, 157, 158, 159, 160, të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-6685/2 të datës 22.06.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-1477 të datës 05.07.2018 U. D Drejtori i IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 2 (dy) teknologëve të diplomuar të radiologjisë për kohë të pacaktuar

- IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup ka nevojë për punësim të:
  - 2 (dy) teknologë të diplomuar të radiologjisë për kohë të pacaktuar.
- Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore -të jetë shtetas i RM, -të jetë i moshës së rritur, -të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe -të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin e dhe **kushtet e posaçme** në vijim:
  - arsim të mbaruar sipëror nga sfera e medicinës me së paku 180 kredi të arritura sipas SETK,
  - certifikatë për njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane) të nivelit A1.
  - provim të dhënë profesional
  - me dhe pa përvojë pune.
- Orari i punës është prej 40 orëve në javë dhe neto pagesë bazë:
  - Për kandidatin nën pikën 1.1 është 22.961,00 denarë.
- Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar që të parashtrajnë dokumentet në vijim
  - fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
  - biografi të shkurtë (CV)
  - Diplomë me sukses mesatar
  - certifikatë për njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) të nivelit A1.
  - dëshmi për provim të dhënë profesional (original ose kopje të vërtetuar në noter),
  - dëshmi për përvojë të punës (original ose kopje të vërtetuar në noter),
  - Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter),
  - Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter),
  - Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter).
- Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i vonuar, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për farmceut të diplomuar dhe teknolog radiologjik të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e plotë të nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohen deri në IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, ndërsa me mbishkrim për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup  
U. D Drejtor  
D-r Ivan Barbov

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА  
ОПШТИНА БРВЕНИЦА  
Ул. „Маршал Тито“, Бр.66  
Тел: 044/456-005  
Факс: 044/456-670



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMUNA E BËRVENICËS  
Rr. „Marshal Tito“, Nr.pn  
Tel: 044/456-005  
Fax: 044/456-670

E-mail: komuna.brvenices@gmail.com  
Web: www.Brvenica.gov.mk

Nr. 14-9  
04.07.2018  
Bërvenicë

### KOMUNA E BËRVENICËS Kryetari Komunës së Bërvenicës

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 kurse në lidhje me nenin 46 paragrafi 9 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik, („G. zyrtare e RM” nr. 199/2014 ), Kryetari i Komunës së Bërvenicës shpall:

### K O M U N I K A T Ë

#### për organizimin e anketimit publik dhe prezantim publik me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik për vendbanimin f.Bërvenicë jashtë v.b. - komuna e Bërvenicës

- Organizohet anketë publike dhe prezantim publik me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik, me nr tekn. 04-03/2018, përpunuar nga „Proinzhenering”-Tetovë, në PK.nr.695/1, PK.nr.695/2, PK.nr.696/1, PK.nr.696/2 dhe PK.nr.699, KK:Bërvenicë jashtë r.n., komuna e Bërvenicës, me destinim G3-Servise.
- Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar nga 09.07.2018 v. deri 13.07.2018 v., kurse prezantimi publik do të mbahet më datë 11.07.2018 v. nga 10-16 ora në zyrën e sektorit për urbanizëm në Komunën e Bërvenicës.
- Hapësira për të cilën do të organizohet prezantimi publik dhe anketa publike me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik, me sipërfaqe të përgjithshme të përfshirjes planore prej 8037,96 m2, në PK.nr.695/1, PK.nr.695/2, PK.nr.696/1, PK.nr.696/2 dhe PK.nr.699, KK:Bërvenicë jashtë r.n., komuna e Bërvenicës, me destinim G3-Servise, të rrethuara në anën lindore dhe perëndimore me Rrugë dheu.
- Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike qytetarët e interesuar mund ti marrin në hapsirat e Komunës së Bërvenicës - Zyra e Sektorit për urbanizëm.
- Në afatin e caktuar personat e interesuar juridik dhe fizik në rajonin konkret të përfshirë me dokumentacionin planor lokal urbanistik, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim në fletat anketuese përmes arkivit të komunës së Bërvenicës.

Kryetar  
Enver Pajaziti

Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 alineja 5 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) neni 27 paragrafi 1 alineja 6 nga Statuti i IPKÇF “MAJSKI CVET” Karposh – Shkup, Vendimit për publikimin e shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit nr. 11-253/2 të datës 04.06.2018, e sjellur nga Kryetari i Komën së Karposhit, Pëlqimit për mjetet e siguruar financiare nr. 18-7441/2 të datës 28.06.2018 nga Ministria e financave, Këshilli Drejtues i IPKÇF “MAJSKI CVET” Karposh - Shkup në mbledhjen e mbajtur më datë 06.07.2018, shpall:

### SHPALLJE PUBLIKE nr. 04/2018 Për zgjedhje të drejtorit të IPKÇF “MAJSKI CVET” Karposh - Shkup

- Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me Ligj, kandidatët duke të përmbushin edhe kushtet e caktuara me nenin 120 dhe 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) edhe atë:
  - të ketë mbaruar arsim të lartë (me 240 kredi të fituara sipas EKTS apo shkallë të mbaruar VII/1) dhe ti plotësojë kushtet e vërtetuara me nenin 136 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve, për edukatorë, për punëtor profesional, për bashkëpunëtorë profesional, person me Fakultet të mbaruar filologjik – program studimore mësimorë dhe studime specialistike për pedagog parashkollor, jurist, sociolog dhe ekonomist me arsim të lartë (me 240 kredi të fituara sipas EKTS apo shkallë të mbaruar VII/1) dhe minimum 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit,
  - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
  - të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psikikisht ;
  - ta njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
  - te mos i jetë shqiptuar masë për ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit;
  - të mos i jetë shqiptuar dënim aktgjykimimi plotfuqishëm me të cilën është i dënuar për veprë penale për dhunë në familje, marrjen e fëmijës së mitur, neglizhencë apo abuzim me fëmijë të mitur me marrëdhënie farefisnore, për veprë penale kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh sanksionin dhe nga i cili në pajtim me ligj është vërtetuar sjellje diskriminuese;
  - të dorëzojë program për punë katërvjeçare në institucion publik.
- Shpallja publike zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- Zgjedhja e kandidatit do të realizohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
- Emërimi i drejtorit bëhet për kohë prej 4 (katër) vjet

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Lutje/fletëparaqitje
- biografi të shkurtë
- diplomë/certifikatë për arsim të mbaruar përkatës;
- certifikatë shtetësie;
- vërtetim mjekësor se personi është i shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;
- vërtetim për përvojë pune
- vërtetim që nuk i është shqiptuar masë për ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit;
- vërtetim që nuk i është shqiptuar dënim aktgjykimimi plotfuqishëm me të cilën është i dënuar për veprë penale për dhunë në familje, marrjen e fëmijës së mitur, neglizhencë apo abuzim me fëmijë të mitur me marrëdhënie farefisnore, për veprë penale kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh sanksionin dhe nga i cili në pajtim me ligj është vërtetuar sjellje diskriminuese;
- licencë të vlefshme për drejtor;
- program për punë të institucionit për fëmijë;
- deklaratë për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetin cirilik

Lutjen së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në origjinal apo kopje të verifikuar në noter në objektin amë të IPKÇF “MAJSKI CVET” Karposh – Shkup, në rr. “Zhenevska” nr. 4 (Tafalixhe 2), me shenjë “për shpallje publike nr. 04/2018”.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe që nuk janë të kompletuara nuk do të merren parasysh.

KËSHILLI DREJTUES  
IPKÇF “MAJSKI CVET” Karposh - Shkup

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА  
ОПШТИНА БРВЕНИЦА  
Ул. „Маршал Тито“, Бр.66  
Тел: 044/456-005  
Факс: 044/456-670



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMUNA E BËRVENICËS  
Rr. „Marshal Tito“, Nr.pn  
Tel: 044/456-005  
Fax: 044/456-670

E-mail: komuna.brvenices@gmail.com  
Web: www.Brvenica.gov.mk

Nr. 14-98/2017  
04.07.2018  
Bërvenicë

### KOMUNA E BËRVENICËS Kryetari Komunës së Bërvenicës

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 kurse në lidhje me nenin 46 paragrafi 9 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik, („G. zyrtare e RM” nr. 199/2014 ), Kryetari i Komunës së Bërvenicës shpall:

### K O M U N I K A T Ë

#### për organizimin e anketës publike dhe prezantim publik me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik për vendbanimin f. Volkovijë v.q., „Rudina” - komuna e Bërvenicës

- Organizohet anketë publike dhe prezantim publik me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik, me nr tekn. 04-22/2017, përpunuar nga „Proinzhenering”-Tetovë, në pjesë të PK.nr.1915/4, pjesë të PK.nr.2598, PK.nr.1910, pjesë të PK.nr.1909 dhe pjesë të PK.nr.1908/1 KK:Volkovijë v.q., „Rudina”, komuna e Bërvenicës, me destinim A1-Strehim në shtëpi banimi.
- Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar nga 09.07.2018 v. deri 13.07.2018 v., kurse prezantimi publik do të mbahet më datë 11.07.2018 v. nga 10-16 ora në zyrën e sektorit për urbanizëm në Komunën e Bërvenicës.
- Hapësira për të cilën do të organizohet prezantimi publik dhe anketa publike me propozim të dokumentacionit planor lokal urbanistik, me sipërfaqe të përgjithshme të përfshirjes planore prej 88.545 m2, në pjesë të PK.nr.1915/4, pjesë të PK.nr.2598, PK.nr.1910, pjesë të PK.nr.1909 dhe pjesë të PK.nr.1908/1 KK:Volkovijë v.q., „Rudina”- komuna e Bërvenicës, me destinim A1-Strehim në shtëpi banimi, të rrethuara me rrugë të reja të projektuara dhe me rrugën Regionale R2233-Gostivar (Lidhja me A2)-Çegran-nyja Tetovë perëndim (lidhja me A2, Bërvenicë.
- Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike qytetarët e interesuar mund ti marrin në hapsirat e Komunës së Bërvenicës - Zyra e Sektorit për urbanizëm.
- Në afatin e caktuar personat e interesuar juridik dhe fizik në rajonin konkret të përfshirë me dokumentacionin planor lokal urbanistik, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim në fletat anketuese përmes arkivit të komunës së Bërvenicës.

Kryetar  
Enver Pajaziti

# VIRUSET E VERËS SULMOJNË EDHE NË PISHINA

Gjatë stinës së verës enteroviruset janë më se të zakonshme dhe janë rreth 70 lloje, por askush ndaj tyre nuk është imun. Më shpesh viktimat janë fëmijë të moshës 4-12 vjet

Enteroviruset në trup kalojnë përmes traktit të tretjes, infektjnë mukozën e fytyrës dhe traktin e tretjes. Ajo shumëfishohet në nyjat limfatike dhe më pas me anë të gjakut përhapet në organet, dhe shpesh sulmojnë sistemin nervor. Pasi fëmija është i infektuar, sëmundja prek mesatarisht gjysmën e fëmijëve të tjerë dhe 25 për qind e anëtarëve të familjes të rritur. Enteroviruset janë të pranishëm në pështymë, mukozën e hundës dhe legen, ndërsa sëmundja transmetohet kryesisht me anë të duarve të pista, nga personi në person përmes teshtitjes dhe kollitjes, kontakti i drejtpërdrejtë me sekrecio-

net e infektuar ose objekt i tillë si një gotë, telefon. Por, ne gjithashtu mund ta marrim edhe në pishinë nëse uji është i ndotur.

Enteroviruset janë një grup i madh virusesh që shkaktojnë forma të ndryshme të sëmundjes, nga krejtësisht të padëmshme në ato që mund të çojnë në invaliditet (polia virale) ose madje edhe vdekje, nëse ato janë infeksione shumë serioze që prekin zemrën, por ato janë shumë të rralla. Për fat të mirë, shumica e enterovirusesh shkaktojnë çrregullime afatshkurtra dhe kërcënuese për jetën që kalojnë brenda disa ditëve, paralajmërojnë ekspertët. Shumica e

enterovirusesh shkaktojnë forma të lehta të sëmundjes me simptoma jo specifike të temperaturës së ngritur që mund të ngjitet deri në 40°C, dhimbje koke, dobësi të përgjithshme, dhimbje fytyrës, muskuj dhe dhimbje abdominale, dhe nganjëherë vjellje dhe diarre që zgjasin rreth tre ditë.

Derisa enteroviruset e butë kalojnë shpejt, format e rënda zgjasin më shumë dhe kërkojnë kontrollin e mjekut. Trajtimi është kryesisht në heqjen e temperaturës së ngritur të trupit dhe në rimëkëmbjen e lëngjeve të humbura. Në rastin e një skuqjeje të lëkurës, është e nevojshme të jeni

të durueshëm, pasi zakonisht ato zvogëlohen pas tre-katër ditësh.

Trajtimi është i thjeshtë: nevojitet të ulni temperaturën e lartë të trupit, kur tejkalon 38.5 dhe të kompensoni lëngjet e humbura. Rekomandohet konsumim i orizit dhe jogurtit, por jo edhe pemë apo lëngje. Te fëmijët ulja e temperaturës kur tejkalon 38 gradë, bëhet me paracetamol dhe, nëse është e nevojshme, dush me ujë të vakët. Jini të kujdesshëm me foshnjat dhe fëmijët e vegjël: nëse temperatura nuk bie ose ka diarre të forta dhe të vjella, kontakto menjëherë mjekun, pasi trupi i fëmijës është i dehidratuar lehtë.



## Gërhitja shenjë e hershme e problemeve me kujtesë

Gërhitja me shumë zhurmë mund të jetë shenjë e hershme e demencës dhe problemeve me kujtesë, thonë shkencëtarët. Sipas një studimi, njerëzit me apnea të gjumit vuajnë nga gërhitja e rëndë. Kjo ka ndikim negativ për kujtesën dhe sjell ndryshime që çojnë në demencë. Gjysmë milioni banorë të Britanisë së Madhe vuan nga gjendja, e cila është e pranishme në moshën e mesme të njerëzit me mbipeshë dhe shkakton kurrjen e mureve të fytyrës gjatë gjumit, duke ndaluar frymëmarrjen. Shkencëtarët nga Universiteti i Sidneit tani sugjerojnë se kjo mund të tkurrë pjesët e trurit duke ulur nivelet e oksigjenit në gjak. Studimi gjeti se personat me apnea kishin të reduktuar trashësinë e kores së trurit në anën e djathtë dhe të majtë, të cilat janë qendrat e kujtesës të trurit dhe të lidhura me demencë. Këto ndryshime të trurit ishin të lidhura me performancë të dobët në një testin e kujtesës, ku njerëzve iu dhanë një listë prej 15 artikujve dhe u kërkua t'i kujtojnë pas 20 minutash. Aktualisht nuk ka kurë për demencën, derisa apnea e gjumit trajtohet me aparate me presion të ajrit, të cilat parandalojnë mbylljen e rrugëve të frymëmarrjes gjatë gjumit.

## Ilaçi kundër kancerit të gjirit, dyfishon rrezikun e kancerit të mitrës

Një ilaç kundër kancerit të gjirit, e marrë nga mijëra gra, dyfishon rrezikun e kancerit të mitrës. Sipas studimit të fundit irlandez, marrja e medikamentit Tamoxifen për 10 vjet në vend të standardes pesë, ngre rrezikun e grave për kancer të endometrialit nga 1.5 për qind në 3.5 për qind. Kanceri i endometriumit ndikon në gjendjen e shëndetit të mitrës. Hulumtimet e mëparshme theksojnë se Tamoxifen blen estrogjenin e hormoneve nga stimulimi i rritjes së kancerit të gjirit.

Ajo mund të jepet si një trajtim ose një terapi parandaluese në njerëzit me një histori familjare të fortë të sëmundjes. Megjithatë, droga parandalon estrogjenin në indin e gjirit, ajo vepron si hormoni në mitër, i cili ngre rrezikun e përdoruesit për kancerin e endometrit.



## Lëng vishnje për një gjumë më të gjatë



Stresi dhe burimet e nxehtësisë shkaktojnë pagjumësi dhe kur ajo përsëritet çdo natë shkaktohet lodhje, rënie e energjisë, dekoncentrim, marramendje, dhimbje koke. Për të përmirësuar cilësinë e gjumit, provoni zgjidhje alternative që përjashtojnë përdorimin

e sedativit. Studimet kanë treguar se vishnjat e tharta janë anti-pagjumësi. Vetëm dy gota lëngje të kësaj frute të shijshme do t'ju ndihmojnë të bini në gjumë më shpejt.

Në studim morën pjesë njerëz që vuajnë nga pagjumësia. Për

një periudhë prej dy javësh, ata pinë 500 ml lëng vishnje çdo ditë, dhe në dy javët e ardhshme një pije placebo, e ngjashme me këtë lëng.

Të gjithë të anketuarit thanë se flinin gjithnjë e më shumë. Rezultatet e studimit zbuluan se lëngu i vishnjës mund të zgjatë gjumin për një mesatare prej 84 minutash.

Shkencëtarët shpjegojnë se kjo është për shkak se ky fryt është një burim natyror i melatoninës, një hormon që ndikon në gjumë. Ajo përmban tryptophanin e aminoacideve dhe është gjithashtu përgjegjës për një gjumë cilësor.

## Zbulimi i rëndësishëm i shkencëtarëve mbi djersën

Zbulohet një nga pikat kyçe të procesit që shndërron molekulat pa aromë të trupit në substanca kimike që përhapen dhe duke u bërë kështu pak të këndshme gjatë nuhatjes. Bëhet fjalë për një proteinë, e cila ruan një rol transportues dhe përthithet nga bakteret, kryesisht të llojit stafilokok. Këto baktere që gjenden kudo në trupin tonë, kryesisht në zonën e sqetullave, thithin këto proteina gjatë procesit të djersitjes, që është në realitet pa asnjë aromë.

Dhe stafilokokët janë ata që



pas përthithjes e transformojnë aromën në të rëndë dhe mjaft të

pakëndshme. Koordinatori i studimit të kryer i cili është publikuar në

revistën shkencore eLife, thotë se zbulimi është i rëndësishëm pasi do të studiohet kështu një gjeneratë e re deodorantësh, më pak agresivë.

Deri më sot shpjegon ai, deodorantët që në përdorim janë si një bombë atomike për sqetullat, duke shkakuar vrasjen e baktereve që popullojnë zonën. Por sipas tij, jo të gjitha bakteret e shkaktojnë aromën e rëndë, madje është një numër shumë i vogël i tyre dhe për këtë do të vijojnë studimet e mëtejshme.

**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Ka shume mundësi qe te mos tregoheni shume besnike sot ndaj atij qe keni ne krah. Një person mjaft joshës do mundohet t'ju beje për vete dhe ju do bini shpejt pre e bukurisë se tij. Beqaret nuk duhet te nxiten për asgjë edhe nëse mundësitë për takime do jene te shumta. Ne planin financiar tregohuni realiste dhe shpenzoni aq sa ua mban xhepi.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Nen ndikimin e madh te Venusit jeta juaj ne çift do jete e bukur dhe mjaft emocionuese sot. Do ndiheni si kurrë me pare dhe do dëshironi qe dite te mos ketë një fund. Beqaret duhet te shohin mire rreth e rrotull vetes sepse atje do e gjejnë personin ideal. Hëna do ju nxite te shpenzoni pa menduar sot dhe situata financiare do jete delikate. Beni kujdes!

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Bashkëpunimi ne çift do jete shume i ngrohte gjate kësaj dite dhe çdo gjë do e zgjidhni me mirëkuptim. Ne mbrëmje atmosfera do ngrohet mjaft dhe ju do ndiheni për mrekulli. Beqareve do ju behet një propozim i mrekullueshëm nga një person i shenjës se Demit. Mendojeni seriozisht. Ne planin financiar bëjini mire llogarite para se te kryeni shpenzime.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Ju qe jeni ne një lidhje ju presin surpriza te njëpasnjëshme dhe te mrekullueshme gjate gjithë ditës. Do ju duket shpesh vetja si ne ëndërr dhe nuk do e besoni qe është partneri ai qe ka menduar për çdo detaj. Beqaret do jene te parrezistueshem dhe nuk kane sesi te mos tërheqin vështrimet e te gjithëve. Financat nuk do jene te këqija, por impulsiviteti i tepruar mund te sjelle tronditje.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Dite shume e qete dhe pa asnjë te re kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Vazhdoni t'i merrni gjerat si t'iu vijnë dhe te dashuron si ta ndjeni. Beqaret nuk do e kenë aspak mendjen tek krijimi i një lidhje sepse diçka tjetër do i shqetësojë pa mase. Ne planin financiar duhet te tregoheni me te organizuar dhe te mos mendojnë vetëm për te sotmen.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Marrëdhënia ne çift do thellohet edhe me tepër gjate kësaj dite dhe ju do kaloni akoma me tepër kohe me atë qe keni ne krah. Emocionet do jene te papërshkrueshme. Ata qe janë ende vetëm do kenë mundësi për takime vërtet interesante. Shume shpejt beqaria do marre fund. Financat duhen menaxhuar me më tepër kujdes dhe maturi, përndryshe do ketë probleme..

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Ne dashuri nuk është momenti duhur për te ndërmarrë rreziqe te mëdha. Mundohuni te ruani qetësinë dhe te mos e tregoni me kritikant ndaj partnerit. Nëse jeni beqare do ëndërroni me shume sesa duhet dhe realiteti do ju duket mjaft i hidhur. Financat do jene me te vërtet shqetësuese. E mira do ishte te flisni me ndonjë specialist dhe te merrni masat e duhura.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Dite shume e animuar dhe e mbushur me emocione kjo e sotmja për gjithë te dashuruarit. Çdo gjë do shkoje ashtu si ju e kishit ëndërruar qe prej kohesh. Beqaret nuk do e kërkojnë me ngulm dashurinë, por një person i veçantë do doje te behet pjese e jetës suaj. Situata financiare do filloje te konsolidohet. Shpenzimet qe do kryeni do jene minimale.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Sot do e kuptoni me se miri atë qe keni ne krah dhe do dini çfarë te bëni qe t'ia plotësoni dëshirat me te zjarrta. Çdo gjë do shkoje për mrekulli. Beqaret do përballen me disa zgjedhje te vështira dhe do ngurrojnë te vendosin shpejt e shpejt. Ne planin financiar mund te kryeni edhe ndonjë investim sepse situata do jene mjaft e qëndrueshme.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Marrëdhënia ne çift do filloje dalëngadalë te përmirësohet, megjithatë ende nuk është koha për te marre vendime te rëndësishme. Tregohuni me te duruar. Beqaret duhet te përgatiten për romanca te këndshme dhe qe do ua ndryshojnë jetën. Financat do kenë probleme nëse shpenzoni pa u menduar. Tregohuni me te kujdesshëm qe edhe e ardhmja te jete e siguruar.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Dite shume normale dhe pa asgjë te veçantë kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Beni ato qe ndjeni pa menduar se çfarë mund te thonë te tjerët. Beqaret do kenë vetëm flirte dhe ndonjë takim, asgjë me tepër se kaq. Duhet te prisni ende për dashurinë e madhe. Për financat do jete dite shume e favorshme dhe e mire. Mund te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Dialogu dhe bashkëpunimi do rimojnë me ditë e sote. Çdo gjë do jete e mrekullueshme dhe partneri do ju krijojë kushtet e duhura qe ju te ndiheni si mbi re. Beqaret do jene joshës dhe sharmante. Mundësitë për te krijuar një lidhje do jene edhe me te mëdha sot. Financat nuk do jene te këqija, megjithatë sërish nuk duhet rrezikuar se tepërmi. Kujdes!

Mensur Mamuti	FITUESI I PARË I GARAVE TË TENISIT (FOTO)	VENDI KU I MBAJTJES SE TURNEU TË PARË (DHE TURNEU E MBAN EMIRIN E NJEJTE)	ISH KRYETARI I MALIT, MUSA	FESTIVAL ZVICËRAN I FILMAVE TË ANIM. QENI I NJOHUR I FILMAVE	F	NE KETE DATE					
SHKOPI PER FALJE TË NAMAZIT NË NATYRE											
MASIV MALOR NË BULLGARI PËRGËNJESHTRIM											
D											
A											
MAL NË SPANJË PËRSËRI											
AKTORJA KANADEZE, PEJXH											ITHTARËT E ANIMIZMIT
ROVENA DILO			TANTALI AKTORI ANGLEZ, LUIS								
FUTBOLLISTI URUGUAJIAN, DIEGO											
I BIRI I JUDËS (SIPAS BIBLËS)							ENERGJIA	KËNGËTARI, TERENS D'ARBI	BAKËR	ADEM JASHARI	ZVARRANIK I VOËGËL, LLOJ HARDHUCE
RUMANIA		METRI FRIKËSOHEM		TEKSTIL QË TREGTOHET ME METER	ITHTAR I SNOBIZMIT						
KOHA	NJERËZ ME LIDHJE TË AFERTA GJAKU SHKALLA						NUSJA	FUTBOLLISTI CANA			
KAMPIONATI I 4 TURNEVE TË TENISIT										FOSFORI SHENJA E NDALIMIT	
NOTON PËRSËRI									NDAJFOLJE PYETËSE	KËNGËTARJA QAZIMI	
AKIL KOCI			FLET ME ZË TË LARTE	NOTË MUZIKORE							TITANI
MËZAT, KA				PËREMËR VETOR	AZOTI			VIT	REOMIRI		
PËRFUNDIM I LUTJES											PESHK I MADH I UJËRAVE TË EMBLA

ZGJIDHJET: F, SUTRA, PIRIN, DEMANT, ANBOTO, SËRISH, ELEN, RD, TA, GODIN, ONANI, R, M, METRAZH, FISI, REJA, GRAN SLEM, P, RINOTON, SI, AK, BËRTEJ, DEM, TI, MOT, AMIN, KRAPI.

shumë i lehtë

			1			
6	3	9		7	8	
9	7		3	2	6	4
		4		3		9
	9				8	
8		2	6			
1	6		5	8	9	7
2	9	7		8		1
			2			

Sudoku

mesatar

		9				
		3	9			7
	2	6	8	1		
	5	1	3		4	9
		7	6			
	8	2	1	3	7	
		3	5	1		4
		2		3		
	6				5	

Shumë i lehtë: 485617392, 623945718, 917832654, 562483179, 394571286, 871296543, 146358927, 259764831, 738129465. Mesatar: 379125684, 816349257, 425678139, 751832496, 934756812, 682914375, 293561748, 547283961, 168497523.



## TANKE NË SHKOLLË QË "TË MOTIVOHEN" NXËNËSIT



Gjimnazi që njihet në të gjithë vendin për metodat e ashpra të mësimin, gati si kazermë ushtarake, sjell dy tanke për të motivuar nxënësit para provimeve të fundvitit. Kina ka famë për rreptësinë në shkollë, por edhe mes tyre ka një shkollë që është më e rrepta nga të gjitha. Kjo shkollë është në qytetin Hebei, provinca Handan.


"Shpresojmë që mësuesit

e nxënësit të pajisen me shpirtin luftarak, që të mos tremben nga sakrificat e vështirësitë, por të fitojnë me çdo kusht", tha drejtori i shkollës që kishte porositur dy tanket. Toni luftarak i drejtorit është sepse këto nuk janë provime dosido, por provime mature prej të cilave varet rruga e mëtejshme e nxënësve nëpër universitete. Dhe kjo shkollë

kërkon të dalë e para. Rreptësia e shkollës ka ngritur shqetësimet në të gjithë vendin. Shumë zyrtarë i kanë quajtur metodat si të lashta dhe se po i dëmton adoleshentët nëpërmjet stresit, në vend që të ndihmojë.

Por shkolla nuk ka ndërmend të lëshojë pe. Kur një nga nxënësit kreu vetëvrasje duke u hedhur nga ballkoni, përgjigjja e shkollës ishte të

vinte hekura në çdo ballkon. "Provimet e maturës nuk janë dosido, pasi prej tyre varet rruga e mëtejshme e nxënësve nëpër universitete. Dhe kjo shkollë kërkon të dalë e para", shprehet një mësues i shkollës në Hebei. Ndryshe, Kina njihet për rreptësinë që kanë në shkollë, por edhe mes tyre ka një shkollë që është më e rrepta nga të gjitha.



## Tumoret, zbulohet mekanizmi që shkakton metastaza në tru

Zhvillimi dhe rritja e metastazave në tru, që shkaktohen nga tumoret e mushkërive apo të gjirit, ndikohet nga prania e një faktori molekular që nuk ndodhet në qelizat tumorale, por në qelizat e shëndetshme të trurit. Ato cilësohen si barrierë mbrojtëse por, zbulimi i fundit nga mjekët e Spitalit të Torinos dhe atij të Madridit pas një studimi ka arritur në këtë konkluzion të rëndësishëm. Mjekët thonë se zbulimi i këtij studimi të publikuar në revistën "Nature Medicine", mund të ndihmojë në një trajtim më efektiv terapeutik. Metastazat e trurit janë një ndërlikim më i shpeshtë i tumoreve dhe përtej kirurgjisë, trajtimet me ilaçe nuk janë fort rezultateve. Mekanizmi molekular i zbuluar së fundi, mund të jetë baza e një trajtimi të ri në të ardhmen. Mjekët studiovan 100 mostra të metastazave të trurit. Në fund u zbulua se pacientët me përhapje më të lartë të qelizës së identifikuar si STAT3, kishin më pak shanse mbijetese.

## Mos e teproni me domate!

Acidi refluks i njohur ndryshe si urth, ndodh kur acidi i stomakut kthehet sërish në ezofag duke krijuar një ndjenjë djegësie. Ky acid mund të shfaqet kur ne konsumojmë ushqime me përmbajtje të lartë acidi, ushqime me shumë yndyrë apo ato pikante. Nëse përjetoni rregullisht urth më shumë se dy herë në javë, për disa javë mund të keni një sëmundje të quajtur gerd, që kërkon vëmendje mjekësore. Intoleranca ushqimore ndaj domateve mund të rezultojë nga sasi të vogla, deri në sasi të mëdha. Simptomat e intolerancës ndaj domates mund të ndryshojnë nga personi në person. Nëse konsumoni sasi të vogla domate-

sh, simptomat nuk mund të vihen re. Nëse vuani nga intoleranca ndaj specit, patates apo piperit mund të zbuloni se jeni intolerantë edhe ndaj domates. Domatet e konservuara shpesh janë të larta në natrium. 200 gramë domate të konservuara përmbajnë 564 miligramë natrium. Ndërsa një filxhan me domate të freskëta ka vetëm 9 miligramë. Një dietë e lartë në natrium rrit rrezikun e osteoporozës dhe komplikacionet kardiovaskulare. Shumica e amerikanëve kanë një dietë të lartë në natrium për shkak të produkteve të konservuara. Domatet po ashtu mund të ndihmojnë në krijimin e një diete të shëndetshme.



455 - Komandanti i ushtrisë romake, Aviti shpallet perandor i Perandorisë Perëndimore Romake.

711 - Berberët nën komandën e Tarik-ibn Ziyad okupojnë Spanjën Veriore.

1386 - Beteja e Sempah: Zvicranët mundin Leopoldin III të Austrisë.

1401 - Monarku mongol Timur Lenk shkatëron Bagdadin.

1536 - Lundruesi francez Zhak Kartier kthehet në San Malo nga Kanadaja.

1572 - 19 priftërinj katolik varen në Gokum.

1609 - Perandori Rudolf II lejon protestantët e Bohemisë lirinë e fesë.

1810 - Napoleoni përvetëson Mbretërinë e Holandës si pjesë të Perandorisë së parë franceze.

1816 - Argjentina shpall pavarësinë nga Spanja.

1917 - Anija luftarake britanike "Vanguard" eksplodon në Skapa Flou, vdesin 804 persona.

1971 - Henri Kisinxheri viziton Republikën Popullore të Kinës.

1982 - Margaret Taçer fillon mandatin e saj të dytë si kryeministër e Britanisë.

1997 - Majk Tajson dëbohet nga boksi për shkak të kafshimit të Holo-fillit në vesh.

Nike u themelua në vitin 1964 si "Blue Ribbon Sports" dhe fillimisht operoi si distributor për këpucarit Onitsuka Tiger (i njohur si Asics). Ajo u bë Nike zyrtarisht në vitin 1971.



Një qime e vetme mund të mbajë peshën e një molle të varur. Megjithatë, shkencëtarët nuk specifikojnë dimensionet e mollës.



Rreth 400 km/h është shpejtësia e një informate që shkon në tru, ndërsa 100 mijë reaksione kimike ndodhin çdo sekondë në trurin tonë.



### AZEMI DHE TREGIMI

E pyet Bali, Azemin.

- A do ta dëgjosh një tregim për dashurinë, qenin dhe nënën.

- Hajt, tregoma i përgjigjet Azemi.

- Ta ç... qeni, nanën.



Më vret fakti që nuk arrij kurrë të kërkoj asgjë. Por edhe më shumë fakti që të tjerët mendojnë se unë nuk kam nevojë për asgjë. (Antonio Curnetta)



KALENDARI HISTORIK 9 KORRIK



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS